Banka e Shqipërisë

NJË BOTË E RE E GUXIMSHME? E ARDHMJA E BANKINGUT NË VENDET EVROPIANE NË ZHVILLIM

RIKONCEPTIMI I PËRMASËS, STRUKTURËS, PRONËSISË, POLITIKAVE DHE INCENTIVAVE TË TIJ

Konferenca Vjetore e Bankës së Shqipërisë,
organizuar në bashkëpunim me Shkollën Ekonomike
dhe Shkencave Politike të Londrës (LSE),
11 tetor 2019

Përgjegjësia për informacionet dhe pikëpamjet e shprehura në këto prezantime, u takon tërësisht autorëve.

Nëse përdorni të dhëna të këtij botimi, jeni të lutur të citoni burimin.

Publikuar nga:

Banka e Shqipërisë, Sheshi "Skënderbej", Nr.1, Tiranë, Shqipëri
Tel.: + 355 4 2419301/2/3; + 355 4 2419401/2/3
Faks: + 355 4 2419408
E-mail: public@bankofalbania.org

Printuar në: 300 kopje
Printuar nga: Adel Co sh.p.k.
ISBN 978-9928-262-37-0

PËRMBAJTJA

PARATHËNIE 5

FJALËT E MIRËSEARDHJES DHE PËRSHËNDETËSE 7

FJALA E MIRËSEARDHJES 9
***Gent Sejko**, Guvernator, Banka e Shqipërisë*

FJALA E MIRËSEARDHJES 17
***Erik Berglof**, Drejtor, Instituti për Çështjet Globale, Shkolla Ekonomike dhe Shkencave Politike e Londrës*

FJALË PËRSHËNDETËSE 21
***Arben Ahmetaj**, Kryetar i Komisionit të Ekonomisë dhe Financave, Kuvendi Shqiptar*

FJALË PËRSHËNDETËSE 29
***Anila Denaj**, Ministër i Financave dhe Ekonomisë*

FJALË PËRSHËNDETËSE 33
***Sh.T.Z. Ilir Meta**, President i Republikës së Shqipërisë*

SESIONI I PARË:
FAKTE MBI SITUATËN E EKONOMISË SË EJL-SË: RISTRUKTURIMI, NDRYSHIMET TEKNOLOGJIKE DHE ZHVILLIMET RREGULLATORE DHE KONTEKSTI I POLITIKËS MONETARE 39
Moderatore: Natasha Ahmetaj, Zëvendësguvernatore e Dytë, Banka e Shqipërisë

NJË HENDEK I FINANCAVE TË GJELBËRA NË VENDET NË ZHVILLIM TË EVROPËS 41
***Ralph De Haas**, Drejtor i Kërkimit, Banka Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim*

SISTEMET BANKARE TË BE-SË DHE EJL-SË: BASHKËPUNIMI DHE SFIDAT E PËRBASHKËTA 49
***Davide Stroppa**, Ekspert i Lartë i bankave, Njësia e Tregjeve Bankare, Inovacionit dhe Produkteve, Autoriteti Bankar Evropian*

RAUNDI I TRETË I ZGJERIMIT TË EUROZONËS: A JANË GATI VENDET KANDIDATE? 53
***Milan Deskar-Škrbić**, Këshilltar, Departamenti i Modelimit, Banka Kombëtare e Kroacisë*

NDRYSHIMI I MODELIT TË BIZNESIT TË BANKAVE NË GRUPIN ISP 63
***Paola Angeletti**, Drejtoreshë e Divizionit Ndërkombëtar të Bankave Filiale, Intesa Sanpaolo SpA*

SISTEMI BANKAR SHQIPTAR: EVOLUCIONI DHE ZHVILLIMET E MUNDSHME **73**
***Silvio Pedrazzi**, Kryetar, Shoqata Shqiptare e Bankave*

SESIONI I DYTË:
SFIDAT DHE IMPLIKIMET E POLITIKAVE **85**
***Moderatore: Luljeta Minxhozi, Zëvendësguvernatore** e Parë, Banka e Shqipërisë*

NJË MJEDIS NË NDRYSHIM – IMPLIKIMET PËR EKONOMITË TONA DHE SISTEMIN FINANCIAR **87**
***Marianne Nessén**, Këshilltare e Lartë e Bordit Ekzekutiv, Sveriges Riksbank*

POLITIKA MAKROPRUDENCIALE DHE BASHKËPUNIMI NDËRKOMBËTAR: ZHVILLIMET MË TË REJA **95**
***Michael Wuerz**, Drejtor i Departamentit të Stabilitetit Financiar dhe Mbikëqyrjes Makroprudenciale, Banka Kombëtare e Austrisë*

MIQËSI ME PËRFITIME NË EPOKËN MODERNE TË BANKAVE: SFIDAT, RREZIQET DHE IMPLIKIMET E POLITIKËS **101**
***Ioannis Asimakopoulos**, Ekonomist i Lartë, Drejtor i Bankingut dhe Tregjeve të Kapitalit, Departamenti i Kërkimeve, Banka e Greqisë*

ROLI I FINANCËS JOBANKARE, HIGH-TECH DHE FIN-TECH NË BANKINGUN TREGTAR KONVENCIONAL **115**
***Peter Botoucharov**, Zëvendëspresident, Global Fixed Income, T. Rowe Price International Ltd*

TENDENCAT E REJA TË BANKINGUT. ÇFARË REZERVOHET PËR SHQIPËRINË? **121**
***Heinz Wiedner**, Nënkryetar i Bordit Mbikëqyrës, Banka Raiffeisen Shqipëri*

PANELI I GUVERNATORËVE:
SEKTORI FINANCIAR PËR RRITJE DHE STABILITET **129**
***Moderatore: Piroska Nagy-Mohacsi**, Drejtore e Programit, LSE Instituti për Çështje Globale*
***Erik Berglof**, Drejtor, LSE Instituti për Çështje Globale*
***Mario Blejer**, LSE dhe IDB; ish-Guvernator i Bankës Qendrore të Argjentinës*
***Ardo Hansson**, Ish-guvernator, Banka e Estonisë*
***Želimira Raspudić**, Zëvendësguvernatore, Banka Qendrore e Bosnje dhe Hercegovinës*
***Gent Sejko**, Guvernator, Banka e Shqipërisë*
***Dmytro Sologub**, Zëvendësguvernator, Banka Kombëtare e Ukrainës*

PARATHËNIE

Kam kënaqësinë t'ju prezantoj vëllimin e radhës të punimeve të Konferencës Vjetore të Bankës së Shqipërisë për vitin 2019, të cilën e organizuam së bashku me Institutin e Çështjeve Globale të Shkollës Ekonomike dhe Shkencave Politike të Londrës (LSE) për të dytin vit radhazi.

Konferenca e zhvilluar një vit më parë, më 11 tetor 2019, në Tiranë - tingëllon si një epokë tjetër, para goditjes nga pandemia COVID.

Megjithatë, konferenca jonë me temë "Një botë e re e guximshme: E ardhmja e bankingut në vendet evropiane në zhvillim" u fokusua mbi tendenca të ndryshme, të cilat më pas u amplifikuan gjatë pandemisë COVID. Ne diskutuam mbi ndryshime të konsiderueshme të pronësisë në sektorin bankar. Hulumtuam rolin që sektori jobankar mund të luajë në mbështetjen e transformimit të sektorit financiar dhe zhvillimit ekonomik. Kemi dëgjuar për ndryshime "revolucionare" si pasojë e digjitalizimit. Kemi konsideruar sfida në zhvillimin strategjik të tregjeve financiare në ekonomitë e vogla të hapura të vendeve të Ballkanit Perëndimor. Dhe ajo çfarë është bërë tashmë një traditë e konferencës sonë vjetore, ne kemi përfituar nga njohuritë unike të guvernatorëve dhe të ish-guvernatorëve të bankave qendrore, pjesë e diskutimeve në "Panelin e Guvernatorëve".

Kjo konferencë mblodhi së bashku akademikë të njohur, bankierë të nderuar qendrorë, politikëbërës dhe studiues të fushës së ekonomisë. Jam mirënjohës për ekspertët e huaj, të cilët erdhën në Tiranë dhe gjithashtu për specialistët tanë në Bankën e Shqipërisë dhe institucione të tjera për kontributet e tyre të larta, dëshmi e të cilave do të jetë ky libër.

Bankat qendrore tashmë po luftojnë krah për krah me qeveritë përkatëse në trajtimin dhe përballimin e kësaj pandemie, e cila ende vazhdon, si dhe të efekteve dhe pasojave të saj. Ne krenohemi me qëndrueshmërinë dhe inovacionin e institucioneve dhe shoqërive tona për të kapërcyer sfidat e jashtëzakonshme të pahasura më parë. Diskutimet të cilat përfshijnë akademikë dhe politikëbërës në takime të tilla të dedikuara, si Konferenca Vjetore e Bankës së Shqipërisë, na ndihmojnë të hartojmë alternativat më të mira të politikave për menaxhimin e krizave dhe të krijojmë një të ardhme më të mirë për botën post-COVID.

Gent Sejko
Guvernator
Tiranë, tetor 2020

Foto grupi e folësve në konferencë

FJALËT E MIRËSEARDHJES DHE PËRSHËNDETËSE

FJALA E MIRËSEARDHJES

*Gent Sejko**

I nderuar zoti President i Republikës,
E nderuar zonja Ministre dhe zoti Kryetar i Komisionit të Kuvendit,
Të nderuar përfaqësues të sistemit bankar, zonja dhe zotërinj, miq dhe të ftuar,

Kam kënaqësinë, si Guvernator i Bankës së Shqipërisë, t'ju uroj mirëseardhjen në konferencën tonë vjetore. Ashtu si dhe vitin e shkuar, konferenca e këtij viti organizohet në bashkëpunim me Shkollën e Londrës për Studime Ekonomike dhe Shkenca Politike (LSE), e më konkretisht me Institutin për Çështje Globale të këtij institucioni – i njohur ndërkombëtarisht për ekspertizën e tij në shkencat sociale.

Konferenca e këtij viti synon të trajtojë trendet më të fundit të zhvillimit të industrisë bankare në Shqipëri, në rajon dhe në botë, duke u fokusuar në sfidat dhe oportunitetet që kemi përpara.

Në mënyrë të natyrshme, këto çështje paraqesin interes të madh jo vetëm për aktorët e tregut bankar, por edhe për bankat qendrore e rregullatorët e tjerë të sistemit financiar. Ndarja e eksperiencës dhe diskutimi i hapur do të na ndihmojnë të identifikojmë qasje sa më optimale për adresimin e sfidave që na presin. Për këtë arsye,

* *Gent Sejko, Guvernator, Banka e Shqipërisë.*

kemi ftuar folës të nderuar, ekspertë nga institucione të njohura ndërkombëtare, si dhe aktorë e rregullatorë të tregut, nga vendi dhe rajoni.

Jam i sigurt se edhe konferenca e këtij viti do t'i përmbushë pritjet e pjesëmarrësve.

Të nderuar zonja dhe zotërinj,

Sistemi financiar dhe sektori bankar në zemër të tij, kanë një rol të pazëvendësueshëm në zhvillimin ekonomik dhe në rritjen e mirëqenies.

Ky sistem i ofron ekonomisë instrumente pagese, duke ndihmuar qarkullimin e lirë të produkteve e shërbimeve. Ai ofron instrumente kursimi e krediti për familjet dhe bizneset, duke nxitur zhvillimin dhe rritjen e mirëqenies. Po ashtu, sistemi financiar ndihmon familjet, bizneset dhe ekonominë në përballimin e goditjeve, nëpërmjet marrjes përsipër të rrezikut në bilancet e tij, si dhe nëpërmjet ofrimit të produkteve të sigurimit financiar të jetës, aktivitetit apo të sigurimit ndaj fatkeqësive natyrore.

Për këto arsye, eficienca, qëndrueshmëria dhe sofistikimi i sistemit financiar janë parakushte esenciale për një rritje të shpejtë, të qëndrueshme dhe gjithëpërfshirëse. Shkalla e zhvillimit të një ekonomie është e ndërlidhur dhe ndërvarur me shkallën e zhvillimit të sistemit të saj financiar. Ky konstatim është gjerësisht i ilustruar nga eksperienca shqiptare e tre dekadave të fundit.

Progresi i vendit në dekadën e parë të tranzicionit u kushtëzua – ndër të tjera – nga faza ende embrionale e zhvillimit të sektorit bankar e financiar. Në dekadën e dytë, zgjerimi i sektorit bankar dhe forcimi i konkurrencës në të, i hapën rrugë rritjes së kreditimit dhe përshpejtimit të ritmeve të rritjes ekonomike. Kjo ecuri u ndërpre nga kriza financiare globale, krizë e cila tronditi ekonominë shqiptare. Në ndryshim nga mjaft vende të rajonit, kriza nuk prodhoi recesion apo krizë të mirëfilltë financiare në Shqipëri. Megjithatë, pasojat indirekte të saj u ndien si në ekonominë shqiptare dhe në sistemin e saj financiar.

Si autoritet monetar, mbikëqyrës e rregullator i sektorit bankar, agjenda e punës së Bankës së Shqipërisë gjatë viteve të fundit është fokusuar në trajtimin e sfidave që trashëguam nga kriza. Më lejoni të bëj një përmbledhje të shkurtër të tyre.

Së pari, ngadalësimi i kërkesës agregate dhe dobësimi i kursit të këmbimit përkeqësuan gjendjen financiare të bizneseve dhe familjeve, duke sjellë një rritje të shpejtë të kredive me probleme dhe duke tkurrur ofertën e kredisë bankare. Ndër të tjera, rritja e kredive me probleme nxori në pah nevojën e përmirësimit të gjithanshëm të ambientit ligjor e rregullator, veçanërisht sa i takon ekzekutimit të kolateralit. Në këto rrethana, në bashkëpunim dhe me agjenci të tjera publike, Banka e Shqipërisë hartoi dhe zbatoi një program të detajuar masash, i cili adresoi në mënyrë të plotë mangësitë e konstatuara. Ky aksion i hapi rrugë reduktimit të shpejtë të raportit të kredive me probleme, përmirësimit të ofertës së kredisë dhe krijoi premisa për përshpejtimin gradual të ritmit të rritjes së saj.

Së dyti, shtrëngimi i normave rregullatore të aktivitetit bankar në Bashkimin Evropian, solli një reduktim të ekspozimit të bankave të huaja ndaj ekonomive rajonale e shqiptare. Ky efekt, i njohur si *deleverage*, nënvizoi faktin se integrimi në rritje i sektorit bankar na ekspozon ndaj politikave monetare dhe normave rregullatore të vendeve të origjinës. Në përgjigje të tij, Banka e Shqipërisë ka punuar për harmonizimin e kuadrit të brendshëm mbikëqyrës e rregullator me standardet e Bashkimit Evropian. Në këtë drejtim, kemi vënë në zbatim një strategji të re makroprudenciale, e cila është modeluar sipas asaj të Sistemit Evropian të Bankave Qendrore. Po ashtu, kemi rishikuar plotësisht kuadrin mbikëqyrës e rregullator, duke synuar adresimin më të mirë të elementeve të rrezikut të sektorit bankar: rrezikut operacional, rrezikut të tregut, rrezikut të kreditit dhe rrezikut të likuiditetit. Së fundi, jemi bërë pjesë aktive e forumit ndërkombëtar për adresimin e këtij fenomeni – i ashtuquajturi Iniciativa e Vjenës, si dhe kemi forcuar komunikimin me agjencitë partnere rregullatore të vendeve të origjinës.

Së treti, ne kemi shpenzuar mjaft kohë dhe energji për administrimin e procesit të konsolidimit të sektorit bankar. Ky proces, i cili tashmë mund të quhet i përfunduar, ka sjellë reduktimin në 12 të numrit të

bankave në sistem. Ai ka krijuar premisa për një sektor bankar më të motivuar në kredidhënie, më inovativ në produkte e më konkurrues në kosto.

Në një nivel më të përgjithshëm, Banka e Shqipërisë ka punuar për përmirësimin e arkitekturës rregullatore të sistemit financiar në Shqipëri dhe për forcimin e rrjetave të sigurisë financiare. Së bashku me agjencitë e tjera publike, kemi ngritur Grupin Këshillimor të Stabilitetit Financiar, kemi përmirësuar bazën ligjore të funksionimit të Agjencisë së Sigurimit të Depozitave, kemi miratuar Ligjin për Ndërhyrjen e Jashtëzakonshme, kemi krijuar kuadrin nënligjor e rregullator, si dhe kemi ngritur strukturat e nevojshme për funksionimin e tyre.

Paralelisht me to, kemi përvetësuar një kuadër modern të hartimit dhe zbatimit të politikës monetare, si dhe kemi ruajtur në mënyrë konsekuente një qëndrim stimulues të saj. Stimuli monetar i ka mundësuar Shqipërisë një ambient financiar transparent, me norma të ulëta e të qëndrueshme interesi, me likuiditet të bollshëm dhe me luhatje të moderuara të kursit të këmbimit. Ai ka nxitur rritjen e konsumit dhe investimeve private, ka reduktuar çmimin e kredisë, si dhe ka lehtësuar kostot e shërbimit të borxhit për të gjitha segmentet e ekonomisë.

Duke reflektuar këto aksione, ekonomia shqiptare ka bërë progres të dukshëm drejt rritjes së qëndrueshme dhe afatgjatë. Ky progres është karakterizuar nga përshpejtimi gradual i ritmeve të rritjes, nga zgjerimi i punësimit dhe rënia e papunësisë, si dhe nga shëndoshja e bilanceve të sektorit privat. Në veçanti, sektori bankar shfaqet likuid, i kapitalizuar dhe me tregues të mirë rentabiliteti. Kapitali rregullator luhatet rreth nivelit 18%, dukshëm mbi minimumin e detyrueshëm, ndërsa raporti i kredive me probleme ka rënë në 11%, kundrejt nivelit maksimal prej gati 25% të shënuar në vitin 2014.

Të nderuar zonja dhe zotërinj,

Objektivi final i punës së Bankës së Shqipërisë ka qenë dhe do të mbetet nxitja e zhvillimit të qëndrueshëm të vendit. Filozofia jonë e punës bazohet në katër shtylla kryesore: profesionalizëm, përgjegjshmëri, llogaridhënie dhe transparencë.

Kjo filozofi u testua dhe u pasurua me disa mësime të vlefshme gjatë dekadës së fundit:

- Së pari, autoritetet monetare, mbikëqyrëse e rregullatore, duhet të kenë një qëndrim proaktiv ndaj stabilitetit monetar dhe financiar të vendit. Kjo kërkon rritjen e kapaciteteve institucionale, si dhe adoptimin e një përqasjeje kundërciklike, si në politikën monetare dhe në atë makroprudenciale. Gjithashtu, ajo kërkon identifikimin e vazhdueshëm të sfidave aktuale dhe potenciale dhe adresimin në kohë të tyre.

- Së dyti, rritja ekonomike afatgjatë duhet ankoruar në reforma strukturore të vazhdueshme. Autoritetet publike e kanë të pamundur – e ndoshta të paarritshme – të parashikojnë apo të shmangin plotësisht goditjet. Megjithatë, autoritetet publike dhe sektori privat mund të minimizojnë efektet e këtyre goditjeve, nëpërmjet reformave strukturore, të cilat synojnë krijimin e strukturave sa më produktive dhe elastike, si dhe nëpërmjet ruajtjes së qëndrueshmërisë së bilanceve financiare. Autoritetet publike dhe sektori privat duhet të jenë të ndërgjegjshëm se përfitimet afatgjata të reformave i tejkalojnë kostot afatshkurtra të tyre.

- Së treti, integrimi financiar ofron një kanal shtesë ekspozimi ndaj goditjeve të huaja, qofshin këto kriza financiare ndërkombëtare apo luhatje të kuadrit rregullator. Në tërësinë e tij, integrimi financiar ka qenë dhe do të mbetet një faktor pozitiv zhvillimi. Ai sjell në Shqipëri kapital financiar dhe ekspertizë menaxheriale, duke pasur një zinxhir efektesh pozitive në ekonominë shqiptare dhe duke pararendur integrimin ekonomik e politik të vendit. Megjithatë, ky integrim bën të domosdoshëm forcimin e bashkëpunimit dhe shkëmbimit të informacionit me partnerët dhe institucionet homologe ndërkombëtare.

- Së fundi, stabiliteti monetar e financiar i vendit nuk mund të jetë përgjegjësi e vetme e bankës qendrore, sado primar të jetë roli i saj në të. Ai kërkon kontributin dhe bashkëpunimin e të gjitha autoriteteve shtetërore.

Të nderuar pjesëmarrës,

Ekonomia shqiptare ka premisa solide për vijimin dhe përshpejtimin e ritmeve të rritjes. Forcimi i stabilitetit financiar, paralelisht me ndjekjen e politikave të kujdesshme monetare, ofron një garanci shtesë për qëndrueshmërinë e saj.

Megjithatë, më lejoni të theksoj se sfidat që kemi përpara nuk janë të pakta.

Në një perspektivë të gjerë, industria financiare, në rajon e në botë, është në presionin e katër rrymave të fuqishme:

- Zhvillimit të vrullshëm të teknologjisë së informacionit, i cili i ka hapur rrugë inovacionit financiar dhe ka sfiduar modelet klasike të bankingut. Instrumentet e reja të pagesave e të kreditit, aktorët e rinj të tregut financiar dhe modelet e reja të biznesit, si bankingu dhe pagesat digjitale apo elektronike, rritin shkallën e penetrimit të shërbimeve financiare. Megjithatë, në të njëjtën kohë, ato sfidojnë jo vetëm aktorët klasikë të sektorit financiar, por dhe rregullatorët e këtij sistemi.
- Globalizimit, i cili ka zgjeruar fushën e veprimit të aktorëve dhe rregullatorëve të tregut. Ky fenomen i ekspozon ndjeshëm vendet në zhvillim ndaj luhatjeve të kuadrit rregullator apo luhatjeve të oreksit për rrezik në vendet e zhvilluara.
- Procesit të rirregullimit që po kalon sektori financiar evropian e botëror. Ky proces synon të rrisë sigurinë e sektorit bankar, të ulë probabilitetin e krizave sistemike dhe të rrisë aftësitë e autoriteteve për administrimin e tyre. Megjithatë, ai imponon kosto shtesë për sektorin bankar dhe e vendos atë në pozita më pak të favorshme kundrejt pjesëmarrësve të tjerë të tregut.
- Normave tejet të ulëta të interesit, që karakterizojnë segmente të tëra të tregut financiar botëror. Këto norma pasqyrojnë politikat monetare stimuluese të ndjekura nga bankat e mëdha qendrore, rënien e produktivitetit global dhe zhvillimet e pafavorshme demografike në vendet e zhvilluara. Megjithatë, ato dëmtojnë bilancet e segmenteve të gjera të tregut financiar, si sektori bankar, fondet e pensionit dhe kompanitë e sigurimit.

Në një këndvështrim më të afërt, Shqipëria ka nevojë për rritjen e gjithanshme të shkallës së kulturës financiare. Ndër të tjera, kjo ndihmon shëndoshjen e financave personale dhe të biznesit, si dhe reduktimin e rreziqeve financiare, si për shembull ekspozimin e panevojshëm ndaj luhatjeve të kursit të këmbimit. Banka e Shqipërisë ka qenë dhe do të mbetet në pararojë të edukimit financiar.

Po ashtu, Shqipëria ka nevojë për zhvillimin e mëtejshëm të sistemit të pagesave dhe për përmirësimin e aksesit në financë të segmenteve të ndryshme të shoqërisë, si bizneset e vogla dhe të mesme apo sektori rural. Banka e Shqipërisë ka ushtruar me përgjegjësi detyrat e veta në fushën e zhvillimit të sistemit të pagesave. Në këtë drejtim:

- kemi ngritur në vitin 2015 Komitetin Kombëtar të Sistemit të Pagesave, i cili synon koordinimin e punës së të gjitha agjencive publike dhe sektorit privat;
- kemi hartuar projektligjin "Për shërbimet e pagesave", i cili adopton direktivën përkatëse të Bashkimit Evropian dhe i hap rrugën zhvillimit të produkteve të reja të pagesave; si dhe,
- kemi përmirësuar infrastrukturën teknologjike të kryerjes së pagesave, duke ulur kostot e tyre.

Megjithatë, puna jonë nuk mund të quhet e përfunduar.

Së fundi, Shqipëria duhet t'i kushtojë vëmendje zhvillimit të segmenteve të tjera të tregut financiar, si tregu i kapitalit apo fondet e pensionit dhe të investimit. Rëndësi primare në këtë kontekst ka harmonizimi i kujdesshëm i kuadrit ligjor e rregullator, për të shmangur lindjen e vatrave të rrezikut sistemik apo mundësitë e arbitrazhit rregullator.

Të nderuar zonja e zotërinj,

Agjenda e punës që kemi përpara është komplekse dhe ambicioze. Përmbushja me sukses e saj do t'i mundësojë vendit një rritje të shpejtë e të qëndrueshme, si dhe do të shënojë një hap përpara në rrugën tonë të integrimit drejt Bashkimit Evropian.

Në emër të institucionit që unë drejtoj, më lejoni të shpreh gatishmërinë tonë për t'u ngritur në lartësinë e këtyre sfidave. Po ashtu, më lejoni të shpreh bindjen se konferenca e sotme do të japë një ndihmesë jo të vogël në gjetjen e zgjidhjeve optimale.

Ju falënderoj për vëmendjen dhe i uroj konferencës punime të mbara!

FJALË E MIRËSEARDHJES

*Erik BERGLOF**

Është gjithmonë kënaqësi për mua të rikthehem në Tiranë. Disa vite më parë, kam pasur mundësinë të përfshihesha e të ndiqja zhvillimet në Shqipëri.

Sigurisht, jemi të nderuar nga prania e Shkëlqesisë së Tij, Presidentit Meta, si dhe e Ministres aktuale dhe të Ministrit të mëparshëm të Financave dhe Ekonomisë. Gjithashtu, kemi kënaqësinë e bashkëpunimit me Bankën e Shqipërisë për organizimin e kësaj konference. Tashmë për mua është shndërruar në traditë që të vij një herë në vit në Tiranë dhe të përforcoj e përditësoj interesin që kam për Shqipërinë. Në të njëjtën kohë, kjo më shërben edhe si një mundësi për t'u takuar me miq e përfaqësues nga organizma të tjera ndërkombëtare, në kuadrin e një konteksti të mrekullueshëm që mbart në vetvete shumë ekspertizë.

Fakti që e vizitoj Shqipërinë një herë në vit nuk do të thotë që nuk mendoj për këtë vend gjatë pjesës tjetër të vitit. Duke parë çfarë ndodh në Shqipëri pak a shumë gjatë vitit të fundit, mund të shqetësohesh për zhvillimet politike në vend dhe mendoj se kjo është diçka normale për dikë që është përpjekur të raportojë dhe të mbështesë ndryshimet e mëdha që kanë ndodhur në Shqipëri

* *Erik BERGLOF, Drejtor, Instituti për Çështjet Globale, Shkolla Ekonomike dhe Shkencave Politike e Londrës.*

gjatë dekadës së fundit. Procesi i anëtarësimit në BE është me një rëndësi kritike dhe shpresoj shumë që këto kohë të vështira në aspektin politik do të kapërcehen me sukses. Ky vend ka shumë potencial.

Gjatë diskutimeve për temën e konferencës, donim të gjenim një temë që të ishte ndryshe nga ato të viteve të mëparshme. Vitin e kaluar u fol për çështje globale dhe për mënyrën e të menduarit sipas këndvështrimit të Shqipërisë në lidhje me këto çështje. Këtë vit donim të provonim një temë që të prekë nga afër dhe të trajtojë çështje që kanë të bëjnë me realitetin vendor dhe që ka opsione për politikat për Shqipërinë. Duke qenë i përfshirë në procesin e forcimit të sistemit bankar gjatë krizës financiare - dhe duke mbajtur parasysh rolin e bankës qendrore të Shqipërisë në atë kohë për mbështetjen e Nismës së Vjenës, në përpjekje për administrimin e ndikimit të krizës financiare globale në sistemet bankare në vendet evropiane në zhvillim - duke qenë i përfshirë personalisht në atë përpjekje të suksesshme, mendoj se është shqetësuese të shohësh banka të huaja që largohen nga rajoni. Ne punuam shumë që t'i mbanim të angazhuara gjatë krizës dhe, ndonëse e dinim se do të ndodhte disi, kur i sheh të largohen, ndien dhimbje. Prandaj, është një gjë e mirë të shohësh se situata është stabilizuar dhe tani ka kohë për reflektim, për të menduar për atë që ka ndodhur - dhe për të ardhmen.

Largimi i bankave të huaja nuk ka ndodhur vetëm në Shqipëri apo në Ballkanin Perëndimor. Kjo dukuri ka ndodhur në të gjithë Evropën Lindore dhe aktualisht është një tendencë globale. Por, në shumë aspekte, Evropa Lindore ishte përpara pjesës tjetër të botës në lidhje me integrimin ndërkufitar të sistemit bankar.

Ne kemi nxjerrë disa mësime nga kjo përvojë dhe po përpiqemi të shohim se si do të jetë e ardhmja e bankingut ndërkufitar. Ne e dimë se në një vend mund operojnë banka të huaja, por pa pasur ndonjë rol domethënës në flukset e kapitalit. Në Amerikën Latine, për shembull, bankat e huaja janë shumë të rëndësishme, por praktikisht ato vetëm sa ndihmojnë në ndërmjetësimin e kursimeve vendase. Padyshim që ky është një rol shumë i rëndësishëm dhe ne nuk duhet ta minimizojmë këtë rol - bankat e huaja kanë luajtur një rol madhor për modernizimin e sistemeve bankare në vendet e Amerikës Latine,

ashtu si edhe në vendet e Evropës Qendrore dhe Lindore, si dhe në ato të Ballkanit Perëndimor.

Nga ana tjetër, një çështje që do të duhet të trajtojmë gjatë ditës së sotme është nëse bankat kanë ndonjë rol në sigurimin e flukseve të sigurta dhe të qëndrueshme të kapitalit, më pak të luhatshme se në rastin e tregjeve financiare ku flukset e kapitalit nuk ndërmjetësohen nga bankat, dhe në veçanti, jo në mënyrën se si bankat kanë ndërmjetësuar në vendet e Evropës Qendrore dhe Lindore. Ne e dimë se në krizën globale jemi ankuar për tërheqjen e fondeve nga bankat. Por edhe çdo formë tjetër e flukseve të kapitalit ishte shumë më tepër e luhatshme dhe është tërhequr shumë më shpejt.

Është fakt tashmë se kemi banka profesionale që operojnë në të gjithë rajonin. Ne mund të shohim edhe se si ato mund të luajnë një rol për të siguruar investime në Shqipëri dhe në pjesën tjetër të Ballkanit Perëndimor. Ne duam flukse kapitali drejt rajonit për të pasur norma rritjeje më të larta në të ardhmen. Sigurisht, duam të përdorim edhe kursimet vendase, por është e rëndësishme të reflektohet mbi rolin e bankave për sigurimin e flukseve të qëndrueshme të kapitalit. Mbi të gjitha, na nevojitet që bankat të luajnë një rol kryesor për financimin e rritjes ekonomike në të ardhmen e parashikueshme në Shqipëri. Më tej, ato do të luajnë një rol të rëndësishëm për ndërtimin e një sistemi financiar që do të mbështesë tranzicionin e Shqipërisë drejt një ekonomie me të ardhura të larta.

Këto janë, në opinionin tim, disa prej çështjeve për të cilat mund të flasim sot dhe jam i bindur se do të kemi diskutime të frytshme gjatë sesioneve në vazhdim!

Faleminderit!

FJALË PËRSHËNDETËSE

*Arben Ahmetaj**

I nderuar President,
I nderuar Guvernator,
E nderuar Ministre,
I dashur Erik,
Të nderuar pjesëmarrës,

Është gjithnjë kënaqësi t'i drejtohesh kësaj Konference Vjetore të Bankës, që besoj është një nga konferencat më të rëndësishme ekonomike dhe financiare në Shqipëri.

Kjo është hera e disatë që diskutojmë së bashku në të njëjtin format dhe jo pa qëllim, e aspak rastësisht, iu ktheva një moment gjithë diskutimeve që kemi bërë vitin e kaluar.

Vitin e kaluar, diskutonim se si Shqipëria e kishte kapërcyer rrezikun e një skenari grek për ekonominë dhe përmes një pune shumë të kujdesshme në favor të konsolidimit fiskal, të cilës edhe Guvernatori iu referua në fjalën e tij, ishte shtruar rruga për një rritje ekonomike të qëndrueshme në nivelet 4%, të nxitur nga konsumi dhe investimet, dhe t'u shoqëruar me një rritje serioze të punësimit.

* *Arben Ahmetaj, Kryetar i Komisionit të Ekonomisë dhe Financave, Kuvendi Shqiptar.*

Atëherë diskutonim se si ju, sektori bankar, do duhet t'i përgjigjeshit ritmit të rritjes së ekonomisë apo thirrjes së qeverisë për një angazhim akoma më të madh për rritjen e kreditimit dhe pjesëmarrjen në investime të qenësishme.

Atëherë diskutonim edhe se si, për një ekonomi si e jona por jo vetëm, edhe si e të gjithë rajonit, vija ndarëse mes suksesit dhe dështimit mbetet akoma tejet e brishtë dhe gjithnjë kërcënuese pa garancitë e vazhdimit të reformave.

Sot, një vit më pas, mund të kemi një tjetër reflektim, por në këndvështrimin tim sfidat janë po ato dhe sërish në këndvështrimin tim, sfidat janë akoma më afër kërcënimit.

Shqipëria ka shënuar një përshpejtim të ritmit të rritjes ekonomike në 5 vitet e fundit, ndërkohë që në gjysmën e parë të vitit 2019 (në nivelet rreth 2.3%), ajo është realisht më pak krahasuar me pritshmëritë tona dhe jo vetëm, edhe me pritshmëritë e institucioneve ndërkombëtare. Këtu do të doja ta provokoja pak debatin në vijim, besoj edhe specialistët këtu do ta prekin, për të konsideruar faktorët që impaktojnë një performancë pak më të ulët të ekonomisë dhe për të na dhënë mësime, atyre prej nesh që administrojnë dhe atyre prej nesh që marrin vendime, qoftë në qeveri, qoftë në legjislativ, në mënyrë që të rritet dhe përshpejtohet agjenda e reformave.

Papunësia edhe në vitin 2019 ka vijuar trendin zbritës, duke arritur në një nivel të ulët historik prej 11.5% dhe pjesëmarrja në forcat e punës mbetet më e larta në rajon. Nga ana tjetër, sërish në funksion të debatit, do të na duhet ta vlerësojmë apo më mirë ta rivlerësojmë, nëse kemi arritur ende dot të bëjmë gjënë e duhur me zhvillimin e aftësive dhe rritjen e produktivitetit.

Këtu ka një provokim të dytë, praktikisht produktiviteti i faktorëve në Shqipëri është akoma më i ulëti në rajon. A është kjo arsyeja pse eksporti është ngadalësuar këtë vit, krahasuar me vitin e kaluar apo edhe vitet e fundit. Po t'i referohemi që nga viti 2014, praktikisht eksporti kërceu edhe me dy shifra. Këto janë pyetje që ky auditor dhe kjo audiencë ka mundësi t'i asimiliojë dhe të nxjerrë mbrapsht mësime për të gjithë ne që marrim vendime apo hartojmë politika.

Më vjen mirë që në aspektin financiar, një sërë masash të ndërmarra vitet e fundit kanë prodhuar rezultate të prekshme në ekonomi, si ulja e nivelit të kredive të këqija, dhe ajo që pashë Guvernator, në atë analizë që po i bëja arsyeve të rënies, është ripagesa. Ripagesa ka brenda edhe ekzekutimin e kolateraleve. Dikur, kur ne nisëm reformën në sistemin financiar, iu referuam drejtpërsëdrejti edhe problematikës pse ndodhin gjithë këto fenomene, përfshirë rritjen e kredive të këqija, dhe një nga bankierët e vjetër të huaj në vendin tonë, gjithmonë përmendte reformën në drejtësi. Besoj që është një debat që do duhet ta diskutojmë gjatë ditës, por edhe në vazhdim, se si ka funksionuar reforma në sistemin financiar që e bëmë së bashku me FMN-në, me Bankën Botërore dhe me Bankën e Shqipërisë dhe të nxjerrim konkluzione. Arsyeja pse duhet të nxjerrim konkluzione dhe duhet besoj ta kthejmë në traditë Guvernator, të paktën në aspektin ekonomik, pasi në aspektin politik unë nuk jam aq "*senior*" sa përfaqësues të tjerë këtu në sallë, si Presidenti i Republikës. Por do duhet të kthehemi dhe të kuptojmë ku kemi bërë gabime dhe nuk e kemi bërë traditë. Ndërtimi i traditës do duhet të na detyrojë t'i kthehemi historisë, pse na ndodhën kreditë e këqija, pse e humbëm konsolidimin fiskal, çfarë masash fiskale morëm për të përshpejtuar rritjen dhe a na funksionuan, në mënyrë që të mos bëjmë dy, tre apo katër herë të njëjtin gabim.

Pastaj të gjithë, pa përjashtim, mos më thoni jo, kemi nevojë të domosdoshme për të mësuar që borxhi i lartë është i keq. Borxhi i lartë, është i keq. Në diskutime tryezash, përtej këtyre tryezave të ndriçuara në aspektin financiar dhe ekonomik, vazhdon akoma fatkeqësisht diskutimi "të rrisim pak borxhin".

Kryeministri ka pasur dhe ka presion, unë kam pasur presion, ministrja sot besoj sërish ka presion për të rritur borxhin, por ulja e borxhit do duhet të rikthehet në domosdoshmëri dhe e kam thënë edhe më herët në aktivitete publike, jo vetëm domosdoshmëri, por edhe objektiv patriotik. Dhe që ta besojmë, do të duhet të edukohemi dhe mirëedukohemi akoma më tepër se çfarë dëmi i bën borxhi ekonomisë, financave publike dhe mbi të gjitha, qytetarit.

Sigurisht që ky nuk është një debat vetëm shqiptar. Sot qeveritë, bankat qendrore dhe aktorët e tjerë në çdo ekonomi, janë "duke bërë sërish llogaritë e tyre".

Në një vlerësim të fundit, FMN-ja parashikon që në vitin 2019 rreth 90% e ekonomive në botë do të shënojnë ritme më të ulëta të rritjes ekonomike, pranë nivelit më të ulët të kësaj dekade.

Në ekonomitë e zhvilluara, SHBA, Japoni dhe kryesisht Eurozonë, ka një zbutje të dinamizmit të aktivitetit ekonomik. Në Kinë, rritja po fillon të ulet gradualisht nga ritmi i shpejtë që shënoi për shumë e shumë vite, gati tri dekada.

Nga ana tjetër, lufta tregtare mes ekonomive të mëdha, ku politikanët në të gjithë botën i japin të drejtë vetes, ka ngritur pikëpyetje serioze që po dominojnë tashmë qasjet dhe politikat tregtare të vendeve, por edhe besimin dhe reagimin e tregjeve e aktorëve.

Përfundimi është i qartë. Të gjithë dalin të humbur nga një luftë tregtare. FMN-ja përllogarit se për ekonominë globale, efekti kumulativ i konflikteve tregtare mund të sjellë një humbje prej gati 700 miliardë dollarësh deri në vitin 2020, ose rreth 0.8% e PBB-së globale.

E njëjta pamje duket se po vizatohet edhe në rajonin tonë, sipas Bankës Botërore, e cila së fundmi i ka rivlerësuar parashikimet e saj të fillimvitit për shkak të pasigurive të shtuara. Vitin e kaluar kemi folur për mitigimin e të gjitha rreziqeve.

Atëherë si do të rikonceptohej agjenda e reformave, si riformulohen prioritetet, si ridizenjohen politikat dhe koordinohen veprimet mes të gjithë aktorëve ekonomikë, financiarë dhe politikë, për t'iu përgjigjur sfidave të kësaj dekade për Shqipërinë e pastaj për vendet e rajonit? Mos harroni që ka një kërcënim për ne dhe vendet e rajonit, por unë po fokusohem tek Shqipëria, është ulja e ritmit të rritjes së popullsisë, që do të duhet të gjithë politikëbërësit dhe shkencëtarët apo ekspertët e fushës, ta faktorizojnë në të gjithë faktorët e rritjes, nëse e përshpejtojnë, e ngadalësojnë apo edhe e shkatërrojnë nëse doni.

Ndërkohë, po ndalem tek debati i rritjes ekonomike. Flitet shpesh për sektorin e energjisë dhe impaktin që ai ka në ekonominë e vendit. Është e vërtetë, patjetër. Ne, në sektorin energjetik dhe për

një porcion jo të vogël të rritjes ekonomike, i dedikohemi energjisë, motit, Zotit. Megjthatë, për ta provokuar auditorin, do t'ju sillja tri shifra. Në vitin 2011, goditja negative nga energjia ka qenë -1%. Në vitin 2017, goditja nga energjia ka qenë -1.3%. Çfarë do të thotë kjo? Pse në vitin 2011, rritja reale, megjithë goditjen energjetike ishte 2.55% dhe në vitin 2017, megjithë goditjen më të madhe të 10 viteve të fundit nga sektori energjetik, rritja shkoi 3.82%? Kjo ka nevojë për analizë. Unë nuk do të pranoja të nxirrja konkluzion, por për të njëjtën goditje, rritja ekonomike ndryshon. Ka një faktor të panegociueshëm, reforma. Në vitin 2017, e gjithë agjenda e reformave në "*full speed*" provokoi pozitivisht të gjitha fondamentet ekonomike, që i kemi diskutuar në vazhdimësi.

Këtu dua të nënvizoj që sektori energjetik ka nevojë të domosdoshme për vazhdimin e reformës, në mënyrë që të konsolidojë të gjithë ato arritje të viteve të fundit.

Ky vend, kjo ekonomi, këto institucione, kjo shoqëri, nuk e ka luksin për asnjë sekondë të ndalojë reformat. Nuk e ka. Përtej çfarë diskutohet në podiumet politike për reforma të vazhduara apo të pavazhduara, ditën që reformat në terrenin ekonomik (pastaj patjetër në gjithë terrenet e tjera) ndalojnë, aty premisat, jo thjesht për ngadalësim, por për gropë ekonomike janë shumë herë më të mëdha.

Dua të citoj ish-Kryeministrin grek Tsipras, në një shprehje brilante në këndvështrimin tim, përsa i përket reformave: "Reformat për një ekonomi janë si t'i japësh biçikletës. Në momentin që ndalon së pedaluari, ti rrëzohesh".

Po i referohem sërish një studimi të FMN-së për rëndësinë e reformave. Implementimi i reformave strukturore në financat publike, *external finances*, tregti, tregun e punës dhe qeverisje, mund të rrisë prodhimin kombëtar me rreth 7% në një periudhe 6-vjeçare dhe me 1 pikë përqindje normën vjetore të PBB/frymë. Sfida të cilat janë në tryezë për ne, për të gjithë ata që administrojnë, për të gjithë ata që bëjnë politika, për të gjithë ata që janë në legjislativ.

Reformat e duhura, në kohën e duhur mund ta dyfishojnë shpejtësinë me të cilën ekonomitë në zhvillim, mund të arrijnë konvergjencën

me ekonomitë e zhvilluara. Pakënaqësia e qytetarëve është mungesa e konvergjencës, pakënaqësitë e qytetarëve në të gjithë rajonin dhe botë kanë të bëjnë me atë që ti e sheh, nuk e ke, do ta arrish dhe gjen instrumente të tjera për ta arritur, ndërkohë që arritja është nëpërmjet konvergjencës ekonomike, pra zvogëlimit të hendekut, e cila bëhet vetëm me reformat e duhura dhe të sinkronizuara.

Unë mendoj se konsolidimi fiskal është shumë i rëndësishëm. Nuk mund të relaksohemi. Pa arritur nivele të përballueshme të borxhit, - nuk po i referohem asaj që ne e morëm 74% e po e çojmë 65%, nuk po i referohem kësaj, - edhe 65% është akoma shumë për ekonominë tonë.

Reforma në drejtësi është e patjetërsueshme. Nuk kam nevojë fare ta debatoj, do t'i ndërrojë faqen drejtësisë, por do ta ndihmojë shumë zhvillimin ekonomik, zhvillimin shoqëror patjetër, institucional patjetër, por mbi të gjitha atë ekonomik.

Formalizimi i ekonomisë, ndonëse tingëllon i dhimbshëm, është i domosdoshëm. Nuk ka rishpërndarje nëse nuk ka formalizim, e diskutojmë si të doni. Pa formalizim, nuk ka rishpërndarje të shëndetshme, sepse ndodh një shpërndarje e madhe në "hapësirë gri", ku deformohen politikat fiskale, politikat financiare, politikat monetare. Nuk kanë impakt nëse informaliteti është në nivele të tilla që të bllokojë eficiencën e politikave.

Më vjen mirë që Banka Botërore e ka ritheksuar edhe në raportin e fundit se investimet për zhvillimin e kapaciteteve njerëzore janë në linjë me zhvillimet ekonomiko/teknologjike botërore. . Eriku këtu iu referua si sfidë, pa të cilën nuk do të mund të rrisim produktivitetin, pa të cilën nuk jemi konkurrues, pa të cilën nuk ia dalim dot të mbajmë ritmet e qëndrueshme të rritjes, atë që e quajmë *sustainable growth*. Pa rritje të qëndrueshme do të shihnim atë që shohim shpesh, oshilacionet në konsum.

Disa elemente, përpara se ta mbyll, përsa i përket sistemit bankar. Kam vënë re kudo ku kam qenë këtu apo në botë, që në përgjithësi janë paksa vetëvlerësues komunitetet financiare bankare për veten e tyre (po i referohem nivelit të dytë, jo autoritetit qendror), madje përtej

tryezave mendojnë se pa ata nuk ka zhvillim. E vërtetë është. Pa ju nuk ka zhvillim. Por dy sfida të vogla do t'jua parashtroj në vijim.

Në gusht të vitit 2012, kredia për ekonominë ishte 552 miliardë lekë; rritja ekonomike ishte diçka mbi 1%. Në gusht të vitit 2019, kredia është 561 miliardë lekë, pra në 7 vite, vetëm rritje 8.7 miliardë lekë (apo 1.6%). Përtej mureve, i gjithë sistemi bankar nuk duhet të jetë shumë krenar për këtë shifër. Ndërkohë që ritmet e rritjes ekonomike shkuan në 4.06%.

Në raport me vendet e rajonit, kreditimi është i sheshtë. Kreditimi për korporatat jofinanciare në vitin 2004, 61%. Në vitin 2012, 15.5%. Po pse në vitin 2018 është vetëm 3%? Çfarë ka ndodhur? Ka pasur mungesë reformash? Jo, përkundrazi, BERZH (Erik ka qenë vetë *Chief Economist*), Banka Botërore, FMN, e ka cilësuar kohën më të mirë të reformave, periudhën 2013-2018. Cila është arsyeja? Provokim për ju.

Pjesa tjetër është shumë interesante. Po shikoja shifrat e rritjes së kredisë, nuk po i referohem aktiveve të bankave me kapital shqiptar. Njëra prej tyre, dhe janë të dhëna publike, nuk po zbuloj asnjë sekret, është interesante të shohësh që bankat me kapital shqiptar e kanë rritur kreditimin në masë të konsiderueshme. Bankat me kapital të huaj, (po i referohem, meqenëse pronësia është dhe një nga elementet e temës dhe titullit të konferencës së sotme), e kanë marrë "me nge". Pyetje e kam, mos u përgjigjni sot se nuk besoj është ky auditori, por bankat me kapital shqiptar janë më pak të ndërgjegjshme për rrezikun? Bankat me kapital të huaj, janë më të sofistikuara në përllogaritjen e rrezikut në Shqipëri? Pyetje e kam, nuk e di, thjesht po ju them shifra.

Rritja e kreditimit 2015-2019: BKT -16%, Credins +19,5%, Banka Raiffeisen -28.9%, Intesa San Paolo +1%.

Po ju sjell nëse doni edhe kreditimin nga 2010-2019: BKT, e ka ritmin e kreditimit 78.7%. Credins, 195,5%. Raiffeisen -7.4% dhe Intesa San Paolo -9%.

Po si është e mundur, çfarë ka ndodhur, tani që ulen kreditë e këqija, tani që bëhen reforma, nuk ka kreditim?! Bankat me kapital shqiptar

japin, bankat me kapital të huaj janë pak më të sofistikuara tek rreziku. Besoj që shumica prej jush që jeni bankierë, do të na mësoni.

Së fundmi Guvernator, gjithashtu një provokim sa i përket kriptomonedhave. Ka ardhur besoj momenti që autoriteti rregullator, por edhe ligjbërësit të mendojnë seriozisht sepse kriptomonedhat, më shumë se një bekim, mund të kthehen edhe në një mallkim, sidomos për ekonomi dhe sisteme si tonat. Besoj se duhet futur në agjendën e diskutimit mes jush, qeverisë dhe ligjvënësit.

Faleminderit për ftesën! Ju uroj punime të mbara!

FJALË PËRSHËNDETËSE

*Anila Denaj**

I nderuar z. President,
I nderuar z. Guvernator,
I nderuar z. Kryetar i Komisionit të Ekonomisë,
Të nderuar bashkëpunëtorë të London School of Economics,
Të nderuar pjesëmarrës,

Është kënaqësi e veçantë për mua të përshëndes Konferencën Vjetore të Bankës së Shqipërisë, ku të theksojmë të gjitha shqetësimet e ngritura deri tani për rolet e institucioneve dhe se si këto të gërshetohen për të sjellë një prosperitet për të gjithë.

Roli i institucioneve të konsoliduara në Shqipëri mbetet imperativ në mbarëvajtjen e politikave qeveritare, por jo vetëm. Banka e Shqipërisë ndër vite ka dëshmuar stabilitetin dhe përqasjen e duhur institucionale kundrejt angazhimit për një ekonomi të qëndrueshme dhe në zgjerim të vazhdueshëm dhe për këtë Ju përgëzoj.

Në dekadat e fundit, Shqipëria është transformuar ekonomikisht, duke i hapur rrugën një tregu me potenciale dhe mundësi jo vetëm në terma të burimeve natyrore, por edhe të kapitalit njerëzor. Rritja ekonomike e qëndrueshme dhe konsolidimi i kuadrit makrofiskal, në

* *Anila Denaj, Ministër i Financave dhe Ekonomisë.*

vitet e fundit, i kanë shërbyer uljes së papunësisë dhe përthithjes së investitorëve të huaj.

Po a është kjo e mjaftueshme? Sigurisht që jo. Rritja ekonomike do një vëmendje si në aspekt shifrash, ashtu edhe strukturash dhe sigurisht ulje të ndikimit të përqendrimit në sektorë të veçantë, si ai i energjisë, i cili në terma të 6-mujorit të parë ka pasur një ndikim më pak, me gati 1 pikë përqindje, por fokus duhet të kemi në strukturën e ndikimit në rritjen ekonomike dhe mbi të gjitha në potencialet ekonomike që ka vendi ynë në disa sektorë, siç është ai i bujqësisë, turizmit dhe në këtë aspekt kuptohet që zhvillimet infrastrukturore janë të rëndësishme, po jo vetëm. Rritja e konkurrueshmërisë së biznesit të mesëm në Shqipëri është po aq e rëndësishme, formalizimi i ekonomisë është po aq i rëndësishëm dhe aksesi në financë për të gjithë treguesit që u thanë pak më lart vjen si një element i domosdoshëm për ta bërë këtë rritje të qëndrueshme në terma afatmesëm.

Perspektiva ekonomike mbetet pozitive me një nivel mesatar inflacioni në nivelet e 2% dhe me një politikë monetare stimuluese, e cila ka krijuar një ambient financiar të karakterizuar nga norma të ulëta interesi, duke nxitur kreditimin, edhe pse me ritme të ulëta dhe në diskutimet e sotme besoj se do të jepen përgjigjen për pyetjet që do të ngrihen. Megjithatë janë për t'u përgëzuar dhe vlerësuar disa nga treguesit pozitivë të realizuar në sektorin bankar, mbi të gjitha ai i lidhur me mjaftueshmërinë e kapitalit që sot është në nivelin e 18.5%, apo ulja e kredive të këqija në treguesin e 11.2%. Të dhënat e Bankës së Shqipërisë tregojnë një rritje të moderuar të treguesit të rritjes vjetore prej 6.8 % për tremujorin e dytë të vitit dhe shpresojmë që të shikojmë se si mund të nxiten më tej të gjitha elementet që mund ta nxisin këtë.

Banka Botërore ka vlerësuar miratimin e ligjit mbi falimentin dhe rolin e Bankës së Shqipërisë në përmirësimin e kuadrit rregullator. Me një angazhim të përbashkët edhe të MFE-së, do t'i jepet zgjidhje e mëtejshme problemit të kredive të këqija, duke eleminuar një ngërç shumëvjeçar, në mënyrë përfundimtare shpresoj. Aksesi në financë për bizneset e vogla dhe të mesme është imperativ. Qeveria shqiptare është angazhuar në shumë forma për të ndihmuar që ky akses të jetë produktiv dhe eficient edhe me skema të cilat nxisin kreditimin

nëpërmjet stimulimit të një elementi që është jo pak i rëndësishëm, ai i kolateralit, duke i dhënë një stimul për të eliminuar këtë ngërç në momentet e analizave financiare kur shikohet dhe vlerësohet risku në këtë aspekt. Megjithatë, shohim që në shumë nga këto iniciativa efektiviteti i tyre është ende për t'u analizuar dhe parë më tej, drejt rritjes së mëtejshme të nxitjes së aksesit në finanacë.

Në linjë me pritshmëritë për të mundësuar një rritje ekonomike në intervalin 3-4% dhe të qëndrueshme në nivel afatmesëm, Qeveria Shqiptare dhe Ministria e Financave dhe Ekonomisë është në pozitat e vijimit të reformave dhe angazhimit drejt përmirësimit të kuadrit ligjor dhe institucional në sektorë të ndryshëm.

Në bashkëpunim me IFC-në po finalizojmë Ligjin e Unifikuar të Investimeve. Në bashkëpunim me Bankën e Shqipërisë dhe Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare synojmë përmirësimin e kuadrit ligjor financiar për sistemet e pagesave apo për sipërmarrjet e investimeve kolektive. Miratuam në korrik ndryshimet në Ligjin "Për koncesionet dhe partneritetin publik privat". Kemi përfunduar konsultimin publik për ligjin "Për faturën dhe sistemin e monitorimit të qarkullimit", duke synuar një ndikim më të lartë në formalizim të ekonomisë.

Zbatimi i reformave të administrimit fiskal si pjesë e reformave më të gjera strukturore do të ndihmojë rritjen e aftësisë konkurruese, rritjen e produktivitetit dhe nxitjen e inovacionit, duke siguruar kushte të barabarta konkurrence ndërmjet lojtarëve në treg.

Në kryesimin tonë në Marrëveshjen e Tregtisë së Lirë për Evropën Qendrore, gjatë vitit 2019, jemi përpjekur të nxisim dialogun për një treg të përbashkët rajonal, për avancimin në rajon të tregtisë elektronike dhe për promovimin në hartën e investitorëve të një rajoni me potenciale ende të paeksploruara plotësisht.

Të gjitha këto janë nisma në vijim të qëllimit për një qeverisje afatgjatë dhe për një kuadër ligjor dhe institucional të qëndrueshëm. Vetëm përmes reformave dhe reformave të integruara me të gjithë aktorët, është e rëndësishme të shikojmë përpara drejt një rritjeje ekonomike të qëndrueshme dhe afatgjatë.

Institucionet qendrore do të jenë në mbështetje të vazhdueshme për avancimin e sektorit financiar, ndoshta në të ardhmen edhe përmes paketave ligjore, të cilat ofrojnë mundësi të reja eksplorimi dhe zhvillimi të institucioneve bankare dhe jobankare në vend.

Në vijim, kam bindjen që kontributet tuaja dhe eksperiencat e vyera në diskutime sot do të sjellin shumë detyra edhe për ne në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë, e jemi të lumtur t'i mirëpresim ato.

Suksese dhe ju faleminderit!

FJALË PËRSHËNDETËSE

*Sh.T.Z. Ilir Meta**

Është kënaqësi për mua që të përshëndes këtë konferencë vjetore kaq të rëndësishme mes Bankës së Shqipërisë me prestigjiozen London School of Economics.

Fokusi i kësaj konference në 'Perspektivën e Ndërmjetësimit Financiar' thekson rëndësinë që sistemi financiar ka për zhvillimin ekonomik të vendeve të rajonit dhe për procesin integrues të tyre në shoqërinë evropiane.

Modeli tradicional i ndërmjetësimit financiar i bazuar në kanalizimin e mjeteve financiare në funksion të zhvillimit dhe rritjes ekonomike është mbështetur edhe nga përvoja shumëvjeçare e disa prej bankave të vendeve të Eurozonës.

Bankat qendrore dhe autoritetet mbikëqyrëse po përballen me një mjedis sfidues për hartimin e politikave jo vetëm në vendet në zhvillim, por dhe në ekonomitë e vetë vendeve më të zhvilluara.

Në nivel makroekonomik trendet e mëdha globale si: situata ekonomike dhe financiare – ndryshimet demografike dhe sociale

* *Sh.T.Z. Ilir Meta, President i Republikës së Shqipërisë.*

– zhvendosjet e fuqisë ekonomike globale – urbanizimi i shpejtë – ndryshimet klimatike dhe mungesa e burimeve të mjaftueshme – si dhe përparimi teknologjik – janë të lidhura me sektorin bankar, por në mënyrë më të veçantë dhe shumë influencuese janë edhe ndryshimet demografike dhe sociale – krijimi i kërkesave të reja konsumatore – pritshmëritë e grupeve të interesit – si dhe risitë teknologjike – të cilat sjellin ndryshime të mëdha, që nga marrëdhëniet e klientëve deri në modelin e biznesit.

Situata makroekonomike dhe financiare globale, ajo e Eurozonës, si dhe në veçanti e vendeve partnere ka një ndikim të rëndësishëm në ekonomitë e rajonit tonë.

Përmes marrëdhënieve tregtare dhe financiare si dhe emigracionit, ekonomia jonë është e lidhur ngushtë me ekonominë e Eurozonës dhe ndikohet nga zhvillimet ekonomike dhe financiare të këtyre vendeve.

Investimet e vendeve evropiane në ekonominë shqiptare kanë qenë një prej faktorëve më të rëndësishëm të zhvillimit ekonomik në mënyrë të drejtpërdrejtë apo edhe përmes ndikimit në aktivitetin financiar.

Goditjet e ndryshme me natyrë ekonomike dhe financiare apo ndryshimet rregullatore dhe institucionale të nxitura nga këto goditje me origjinë në Eurozonë kanë dhënë ndikim të ndjeshëm, jo vetëm në nivelin e çmimeve, kursin e këmbimit apo natyrën dhe masën e ndërmjetësimit financiar, por edhe në strukturën, madhësinë dhe formën e biznesit dhe të sistemit bankar.

Eksperienca e vendit tonë ka treguar se sa e vështirë ka qenë ruajtja e ritmeve të rritjes ekonomike e përjetuar në vitet para krizës globale financiare.

Ulja e ritmeve të rritjes është reflektuar edhe në tregues të tjerë makroekonomikë sikurse në realizim të inflacionit nën objektivin e Bankës së Shqipërisë apo edhe në rënie të ritmit të kredidhënies drejt sektorit privat të ekonomisë.

Kundrejt këtyre prirjeve, politika e Bankës së Shqipërisë ka realizuar zbutjen e efekteve negative të tyre.

Zbatimi i politikës monetare konvencionale të Bankës së Shqipërisë ka mundësuar ndërhyrjet e duhura në kohën dhe në masën e nevojshme pa cenuar parimet bazë themeltare ku mbështetet administrimi i mirë i politikës monetare dhe i regjimit të kursit të këmbimit.

Në tërësi, kuadri i politikave të ndjekura nga Banka e Shqipërisë në drejtim të rritjes së rezervave valutore, të zbutjes së ndikimit negativ të kursit të këmbimit në normën e inflacionit, të hartimit të një kuadri rregullator në funksion të nxitjes së kreditimit të ekonomisë në monedhën vendase janë elemente të rëndësishme të një pakete politikash që promovojnë stabilitetin makroekonomik e financiar dhe duhen mbështetur.

Megjithatë, mbetet shqetësim fakti që bankat në Shqipëri kanë efektivitet shumë të ulët në ekonomi. Ato japin kredi një përqindje shumë më të ulët nga depozitat që disponojnë.

Duke iu referuar vlerësimit të kryer nga Banka Qendrore Evropiane vërehet se gjatë 10 viteve të fundit, Shqipëria ka raportin më të ulët të kredisë ndaj depozitave dhe raportin më të ulët të aktiveve të sistemit bankar ndaj PBB-së.

Sipas Bankës Qendrore Evropiane, një nga arsyet pse bankat kanë frenuar kreditimin në Shqipëri lidhet me dobësitë në sundimin e ligjit. Për këtë arsye, një kthim në shinat e ligjshmërisë dhe forcimit të shtetit të së drejtës, të funksionimit të plotë, të shpejtë e të besueshëm të gjyqësorit, si edhe lufta konkrete ndaj korrupsionit do sillte një ndikim tejet pozitiv, në fuqizimin e kontributit të sistemit bankar, për rritjen ekonomike më të lartë të vendit.

Sistemi financiar shqiptar ka pësuar ndryshime të rëndësishme në terma të sipërmarrjes aksionere.

Ristrukturimi i sistemit financiar në ekonomitë evropiane është shoqëruar me ristrukturimin e filialeve të këtyre bankave edhe në ekonomitë e rajonit tonë.

Po kështu, ndryshimet në kuadrin rregullator të Eurozonës kanë nxitur bankat e pranishme në Shqipëri dhe në rajon të rishikojnë pozicionet e tyre në rajonin e Ballkanit Perëndimor dhe në vendet e Evropës Juglindore.

Këto ndryshime kanë sjellë një konsolidim më të madh të sistemit financiar në Shqipëri, si dhe përfshirjes së aktorëve të rinj në tregun financiar.

Bankat kanë përmbushur tradicionalisht një numër funksionesh thelbësore në sistemet ekonomike, duke përfshirë shndërrimin e depozitave të klientëve në financim afatgjatë për korporatat dhe individët, si ndërmjetëse në mekanizmat e transferimit të parave, përfshirë sistemet e pagesave; si ndërmjetëse dhe krijuese e tregut në tregjet e letrave me vlerë; dhe si mbështetëse e politikave publike për qeveritë, duke zgjeruar huadhënien për sektorët e favorizuar ose për të nxitur rritjen.

Depozitat e siguruara dhe qasja në fondet e bankës qendrore kanë mundësuar që bankat të kenë një akses më të madh në likuiditete dhe me kosto të ulët.

Duke u ndalur te rëndësia e teknologjisë, dua të theksoj se risitë teknologjike prezantojnë një dimension të rëndësishëm të perspektivës së ndërmjetësimit financiar.

Sfidat dhe vështirësitë me të cilat është përballur industria financiare në nivel global kanë nxitur promovimin e këtyre risive teknologjike në funksion të ofrimit të produkteve dhe shërbimeve financiare.

Mjetet e krijuara nga këto risi teknologjike po krijojnë çdo ditë mundësi të reja në formën e produkteve dhe shërbimeve inovatore në tregjet financiare.

Zonja dhe zotërinj,

Bankat tradicionale duhet të përditësojnë fokusin e tyre strategjik për t'u përshtatur sa më mirë me zhvillimet e kohës.

Markat dhe reputacioni i tyre mbeten potencialisht të fuqishme dhe ofruesit e shërbimeve bankare alternative ende vuajnë nga mungesa e besimit.

Bankat duhet të zgjerojnë produktet inovatore, të cilat kanë potencialin të nxisin produktivitetin dhe eficiencën në ndërmjetësimin financiar.

Shërbimet dhe produktet e mundësuara nga këto risi teknologjike kanë kapacitetin të prekin shtresa të popullsisë, të cilat nuk janë ndjerë ende partnerë të aftë për bankat tradicionale, ose nuk e kanë demonstruar fleksibilitetin e nevojshëm për të përfituar nga shërbimet financiare të banking-ut tradicional.

Një vlerësim gjithëpërfshirës i potencialeve dhe rreziqeve që shoqërojnë risitë financiare ndihmon në hartimin e kornizave rregullatore të këtyre aktiviteteve në funksion të rritjes së qëndrueshme ekonomike, të mbrojtjes së konsumatorëve dhe të ruajtjes së ekuilibrave financiarë e makroekonomikë të vendit.

Bashkekzistenca e risive financiare me industrinë ekzistuese bankare duhet të sjellë zhvillim dhe zgjerim të mundësive të reja si për aktorët ekzistues të industrisë financiare, ashtu edhe për sipërmarrjet e sektorit real.

Është e nevojshme që këto zhvillime të përkrahen dhe të mbështeten veçanërisht në ekonomi të vogla në zhvillim, sepse mund të rrisin përfshirjen financiare.

Një përfshirje më e madhe financiare shoqërohet me potenciale të reja edhe për rritjen aq të dëshiruar ekonomike dhe rrjedhimisht edhe për sipërmarrjet tradicionale të biznesit në këtë industri.

Përvetësimi i këtyre mundësive të reja nën kujdesin dhe mbikëqyrjen e autoriteteve financiare i shërben vetë stabilitetit financiar të vendit.

Së fundmi, dua t'ju falënderoj për këtë ftesë dhe të inkurajoj Bankën e Shqipërisë dhe LSE për kontributin tejet pozitiv nëpërmjet adresimit të këtyre çështjeve në një nivel akademik dhe institucional, i uroj kësaj konference punime të mbara! Po kështu, në kuadër edhe të

provokimeve të lëshuara nga z. Ahmetaj edhe sa më shumë ide të reja për një rritje ekonomike më të lartë dhe më të qëndrueshme.

SESIONI I PARË:

FAKTE MBI SITUATËN E EKONOMISË SË EJL-SË: RISTRUKTURIMI, NDRYSHIMET TEKNOLOGJIKE DHE ZHVILLIMET RREGULLATORE DHE KONTEKSTI I POLITIKËS MONETARE

Industria bankare po përballet me një kontekst, i cili ndryshon në mënyrë të shpejtë. Ndryshimet teknologjike po dëmtojnë modelet ekzistuese të biznesit bankar. Rregulloret e mbikëqyrjes dhe stabilitetit financiar dhe pengesa të tjera të mundshme ndaj tregtisë globale po kërcënojnë se paraqesin pengesa të tjera për flukset financiare. Grupet bankare në Evropë, të cilat zotërojnë pjesën më të madhe të sektorëve bankarë në rajonin e EJL-së, po largohen nga rajoni. Pjesëtarët e rinj të tregut vijnë nga Evropa Qendrore dhe më gjerë. Ndërkohë, rajoni i EJL-së është bërë pjesë e një "cikli financiar mini-euro", ku vendimet e politikës monetare të EJL-së ndikojnë drejtpërdrejt në kushtet financiare në rajon.

Në këtë sesion diskutohen pyetjet e mëposhtme:

- *Si po ndryshojnë modelet e biznesit të bankave në vendet evropiane në zhvillim, në rajonin e EJL-së dhe veçanërisht në Shqipëri?*
- *Cilat janë implikimet e mundshme të tërheqjes së vazhdueshme të grupeve financiare të BE-së nga rajoni i EJL-së mbi stabilitetin financiar, mbikëqyrjen e bankave dhe zhvillimin e tregut financiar në këtë rajon?*
- *A mundet që financimi nga institucionet jobankare të plotësojë boshllëkun që largimi i grupeve bankare evropiane po krijon në financimin e zhvillimit të qëndrueshëm? Cili është roli i Fintech dhe Bigtech në lidhje me financimin në të ardhmen në këtë rajon?*
- *Cilat janë rreziqet për stabilitetin makroekonomik dhe financiar dhe për zhvillimin ekonomik?*

Moderatore: Natasha AHMETAJ, Zëvendësguvernatore e Dytë, Banka e Shqipërisë

NJË HENDEK I FINANCAVE TË GJELBËRA NË VENDET NË ZHVILLIM TË EVROPËS

*Ralph De Haas**

Së pari, faleminderit që më ftuat të marr pjesë në këtë Konferencë! Është kënaqësi të rikthehem në Tiranë.

Sot dëshiroj të flas, jo vetëm për bankat, por gjithashtu për forma të tjera të financave që po bëhen gjithnjë e më shumë të rëndësishme - ose duhet të bëhen të rëndësishme - në këtë pjesë të botës. Në fund të prezantimit do të kemi gjithashtu pak fokus të gjelbër, pasi mendoj se kjo është diçka që nuk është diskutuar dhe që do të marrë vëmendje kryesore në dekadat e ardhshme.

Më lejoni të filloj duke ju treguar këtë grafik.

* *Ralph De Haas, Drejtor i Kërkimit, Banka Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim*

Mendoj se ndoshta e keni parë më mijëra herë këtë grafik. Unë e shoh çdo gjashtë muaj kur del një publikim i ri i Vienna CESEE Monitor (Monitori i vendeve të EJL-së, Vjenë) dhe jam kurioz të mësoj se çfarë po ndodh në rajon. Mund të përqendrohemi tek vija e kuqe, që është borxhi i jashtëm nga bankat në vendet e Evropës Lindore Qendrore dhe Juglindore (ELQJL-së). Ju e njihni tashmë faktin e tendencës së levës financiare që ne kemi parë për shumë vite. Por, siç e përmendi dhe Eric këtë mëngjes, duket se në këtë grafik ka edhe lajme të mira. Kur e analizoja atë, pata një surprizë të këndshme, pasi në dy vitet e fundit, problemet duket se kanë arritur në pikën e fundit dhe ka disi një stabilizim. Ajo çfarë unë e gjej në veçanti interesante është zhvillimi në raportin "hua ndaj depozitave". Në vitin 2006, raporti mesatar hua ndaj depozita ishte rreth 100%, në varësi se si përcaktohen saktësisht depozitat. Më pas ky numër u rrit për disa vite, ndërsa bankat vijuan të marrin hua gjithnjë e më shumë nga jashtë. Më pas, ndodhi një proces i zgjatur i levës financiare, dhe sot praktikisht jemi kthyer pas, pikërisht aty ku ishim 13 vite më parë: një raport hua ndaj depozitave në rreth 100%. Mesatarisht, bankat në rajonin e EQLJL-së, financojnë përsëri pjesën më të madhe të kredive të tyre nëpërmjet depozitave.

Kjo do të thotë se sistemet bankare në këtë rajon janë bërë më të vogla; por në të njëjtën kohë struktura funksionale e këtyre bankave gjithashtu është bërë më e qëndrueshme dhe me më pak rrezik. Kështu që ka pak vijë ngjyrë argjendi kur shohim këta grafikë.

Çfarë ka ndodhur në pjesë të tjera të botës? Nëse shohim tregjet e tjera në zhvillim dhe ekonomitë në zhvillim, panorama është mjaft e ndryshme. Me të vërtetë më pëlqen grafiku në vijim.

Grafiku tregon kreditë për bizneset si përqindje e PBB-së. Që nga koha e krizës financiare globale, raporti midis kredisë për biznese ndaj PBB-së në vendet e pasura dhe ekonomitë e zhvilluara ka qenë rreth 90-95%. Ky raport nuk ka ndryshuar shumë me kalimin e kohës. Por, në shumë tregje në zhvillim tendenca ka qenë shumë e ndryshme. Ato me të vërtetë u rritën me shpejtësi dhe borxhi i bizneseve si përqindje ndaj PBB-së sot është në nivele të ngjashme me atë në vendet e pasura të botës. Megjithatë, më lejoni gjithashtu të vë në dukje tri gjëra që nuk mund t'i shihni në këtë grafik. Së pari, një pjesë e konsiderueshme e borxhit në tregjet në zhvillim është në monedhë të huaj, gjë e cila me shumë vështirësi mund të haset në ekonomitë e zhvilluara. Së dyti, pjesë e konsiderueshme e këtij borxhi është shumë afatshkurtër. Është e vështirë të ndërtohet kurba e *yield*-it (normës së interesit) për huamarrjen më afatgjatë, dhe e di se janë bërë përpjekje këtu në Shqipëri për të ndërtuar një kurbë të tillë. Së treti, borxhi i bizneseve në tregjet në zhvillim, gjithashtu po përqendrohet gjithnjë e më shumë në disa biznese të mëdha. Kështu që rreziku i përqendrimit gjithashtu është më i madh se ajo çfarë shohim zakonisht në ekonomitë e zhvilluara.

Pra, ka pasur një proces rritjeje për sa i përket sasisë së financimit të bankave ndaj korporatave në shumë vende në zhvillim. Por, lidhur me cilësinë e këtij borxhi, mendoj se këto rreziqe janë shumë më të larta se sa zbulon kjo pamje.



Kështu që, shtrohet pyetja: "A janë bankat opsioni më i mirë për të financuar rritjen ekonomike? Ka një debat të kahershëm akademik për këtë, por mendoj se shumë nga ne do të binin dakord, duke parë pas, 30 vite më parë ose që prej rënies së Murit të Berlinit, se bankat kanë bërë një punë mjaft të mirë në drejtim të rritjes ekonomike në pjesën e Evropës në zhvillim. Ato kanë ndikuar mjaft, duke ndihmuar bizneset të financojnë dhe zbatojnë teknologji të reja dhe t'ia dalin në lidhje me rritjen e produktivitetit. Mendoj se kjo është një histori shumë pozitive, histori që ne e kemi parë edhe në vende të tjera dhe diçka që duhet përshëndetur.



Nëse shohim para, çfarë vërejmë është se shumë vende në pjesën e Evropës në zhvillim janë vende me të ardhura mesatare. E dimë se kur një vend i afrohet statusit me të ardhura mesatare, atëherë sistemi financiar duhet të ndryshojë. Do të ketë nevojë për një strukturë

të ndryshme, do të ketë nevojë për t'u theksuar më shumë kapitali, qoftë ai publik dhe ai privat. Roli relativ i bankave po reduktohet në ato vende që shmangin me sukses grackën e të ardhurave mesatare.

Kur vendet i afrohen statusit "me të ardhura mesatare", nuk është më e mjaftueshme për bizneset të adoptohen apo të blejnë teknologji të huaja. Në vend të kësaj, bizneset do të kenë gjithnjë e më shumë nevojë që të zhvillojnë edhe teknologjitë e tyre. Bizneset shqiptare, për shembull, me të vërtetë duhet të bëhen më novatore dhe të kryejnë punë kërkimore dhe zhvilluese (R&D) për të zhvilluar teknologji të reja. Megjithatë, të dhënat për gjurmimin e bankave, të cilat financojnë të tilla inovacione janë mjaft të përziera. Në punën e fundit kërkimore, unë dhe kolegu im Cagatay Bircan, përdorëm të dhëna shumë të grimcuara për bizneset dhe kredidhënien e bankave në Rusi. Ajo çfarë gjetëm është se kur ka më shumë kredi bankare të disponueshme, bizneset rriten më shpejt, ato bëhen më produktive dhe prezantojnë më shumë teknologji të reja duke punuar së bashku me kompani të huaja. Kjo është pikërisht ajo për çka po flisja më parë. Por, nga ana tjetër, gjetëm vetëm të dhëna të kufizuara që kredidhënia bankare gjithashtu mund të ndihmojë bizneset të kryejnë punë kërkimore dhe zhvilluese, dhe të prezantojnë teknologji të reja "ndërkufitare". Për këtë, bizneset mund të kenë nevojë të aksesojnë lloje të ndryshme financimi, në veçanti kapital.

Burim: Bircan, C. and R. De Haas (2015). The limits of lending? Banks and technology adoption across Russia, *Review of Financial Studies*, forthcoming.

Së dyti, do të argumentoja, se bankat nuk kanë një gjurmim të mirë në financimin e rritjes së gjelbër ekonomike. Kjo sepse rritja

e gjelbër ekonomike, si pjesë e të cilës ndërmarrjet zgjerohen, por bëhen njëherazi më efektive për sa i përket energjisë, ka tendencë të zhvillohet rreth inovacionit. Edhe tregjet e aksioneve dhe ato të kapitalit kanë tendencë të kenë një gjurmim më të mirë në financimin e investimeve inovative sesa bankat.

Kështu që, në të vërtetë ka dy arsye për të cilat - madje dhe në një konferencë për të ardhmen e bankingut - duhet parë përtej bankingut dhe duhet menduar rreth rolit të tregjeve të kapitalit. Së pari, tregjet e zhvilluara dhe likuide të kapitalit mund të ndihmojnë vendet të financojnë më shumë punë kërkimore dhe zhvilluese dhe inovacionin, për të shmangur edhe grackën e të ardhurave mesatare.



Së dyti, tregjet e kapitalit mund të ndihmojnë gjithashtu për ta bërë rritjen ekonomike më të gjelbër.

Sigurisht, nuk po tregoj ndonjë gjë të re kur them se tregjet e kapitalit publik dhe privat në pjesën e Evropës në zhvillim janë ende të vogla. Ende ka shumë punë për të bërë për ta ndryshuar atë dhe për të ndërtuar një kulturë vendore të kapitalit. Çdo ofertë Publike Fillestare (IPO) në Shqipëri do të ishte një hap i madh në krijimin e një kulture të tillë të kapitalit. Një nga arsyet që vazhdoj të diskutoj për këtë çështje, është sepse ka një evidencë empirike të qartë që bizneset në tregjet në zhvillim menjëherë pasi mundësojnë aksesin në kapitalin privat, gradualisht nisin të bëhen më produktive dhe më shumë fitimprurëse. Për më tepër, fillojnë të punësojnë më shumë njerëz. Si rrjedhim, disponueshmëria e kapitalit privat mund të jetë e rëndësishme jo vetëm për rritjen ekonomike, por gjithashtu dhe për rritjen e punësimit.

Financimi i kapitalit mund të lehtësojë gjithashtu tranzicionin e gjelbër



Efekte të fuqishme por të kundërta të tregjeve të kapitalit dhe të aksioneve në ndotje:

1. Çlirimet e CO_2-mën me zhvillimin e tregut të kredisë dhe ulen me zhvillimin e tregut të aksioneve
2. Efekti kredi - treg drejtohet nga rishpërndarja ndërsektoriale
3. Efekti treg – bursë drejtohet nga një përmirësim në efektivitetin brenda sektorit të energjisë

Burimi: De Haas, R. and A. Popov (2019), Finance and Carbon Emissions, CEPR Discussion Paper DP 14012.

E fundit, më lejoni të theksoj se në vendet në zhvillim të Evropës, struktura e prodhimit e shumë kompanive ka tendencë të jetë relativisht joefektive, për sa i përket energjisë: ende ka një hendek të madh lidhur me emetimin e gazit të efektit serë për njësi të vlerës së shtuar, krahasuar me Evropën Perëndimore. Për të reduktuar atë hendek dhe për ta bërë prodhimin më të gjelbër, ne do të na duhet jo vetëm më shumë kredidhënie bankare, por gjithashtu më shumë financim të kapitalit. Puna ime kërkimore ka treguar se të pasurit akses në kapital i ndihmon kompanitë të pastrojnë strukturën e tyre të produktit shumë më shpejt sesa kompanitë në vende ku pjesa më

e madhe e financimit vjen nga bankat. Një nga arsyet për këtë është se shumë banka po përpiqen të jenë mjaft konservatore: ato nuk ndjehen shumë rehat me financimin e kompanive dhe industrive relativisht inovative dhe të gjelbëra.

Megjithatë, më lejoni të theksoj dhe një herë se mendoj që bankat, kanë qenë "një motor konvergjence" mbresëlënës në këtë rajon gjatë 30 viteve të shkuara. Duke ecur më tej, nëse duam të ruajmë një rritje ekonomike të qëndrueshme, dhe në qoftë se duam të sigurojmë se vendet nuk do të bien në kurthin e të ardhurave mesatare, atëherë duhet rregulluar struktura e sistemit financiar. Do të nevojitet një rol më i madh si i tregjeve të kapitalit publik dhe atij privat. Por dhe atëherë, bankat do të vijojnë të luajnë rol të rëndësishëm në financimin e bizneseve. Me të vërtetë, një nga arsyet se përse kapitali privat është kaq i dobishëm qëndron në faktin që aktualisht i lejon shumë kompanive të kenë akses në kredi bankare dhe në financim.



Krijimi i tregjeve publike dhe private të kapitalit, sigurisht nuk është i lehtë. Do të ishte me interes të shihet se si do të zhvillohet Bursa e Shqipërisë. Gjithashtu, ka alternativa dhe elemente plotësuese. Dikush, për shembull, mund të mendojë për një segment të tregut shqiptar në një shkëmbim rajonal apo platforma rajonale të porosive, të tilla si SEE Link. Të gjitha këto opsione mund të eksplorohen për të siguruar se një kulturë e vërtetë e kapitalit po integrohet në sistemin financiar këtu në Shqipëri.

Faleminderit shumë për vëmendjen tuaj!

SISTEMET BANKARE TË BE-SË DHE EJL-SË: BASHKËPUNIMI DHE SFIDAT E PËRBASHKËTA

*Davide STROPPA**

Kur Autoriteti Bankar Evropian (EBA) u kontaktua për të ndjekur këtë konferencë dhe diskutimet e panelit, ne menduam: Çfarë kontributi mund të ofrojë EBA në këtë konferencë? Atëherë analizuam dy perspektiva.

E para, është puna që po bën EBA në lidhje me bashkëpunimin me autoritetet e vendeve të treta, dhe në veçanti me rajonin e EJL-së.

E dyta, janë sfidat që mund të shohim për bankat në Bashkimin Evropian, pasi kjo përvojë mund të ofrojë disa perspektiva dhe informacione rreth asaj si bankat po kryejnë veprimtarinë e tyre në një botë të re sfiduese.

Si fillim, po parashtroj një përmbledhje të shkurtër lidhur me punën e EBA-s me vendet e EJL-së. EBA ka qenë e angazhuar në diskutime të shumta lidhur me konvergjencën në fushën e mbikëqyrjes që prej themelimit të Iniciativës së Vjenës. EBA ka bërë përpjekje të konsiderueshme në këtë fushë, së pari duke vlerësuar ekuivalencën për dispozitat e besimit për autoritete mbikëqyrëse të vendeve joanëtare të BE-së, gjë që i mundëson një numri autoritetesh jo-evropiane që të marrin pjesë në kolegjet mbikëqyrëse të BE-së. Së dyti,

* *Davide STROPPA, Ekspert i Lartë i bankave, Njësia e Tregjeve Bankare, Inovacionit dhe e Produkteve, Autoriteti Bankar Evropian.*

ajo ka krijuar një Memorandum Mirëkuptimi specifik midis EBA-s dhe vendeve të Evropës Juglindore (EJL-së), i cili është zhvilluar në bashkëpunim të ngushtë me përfaqësuesit e Bankës Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim (BERZH). Ky Memorandum Mirëkuptimi nuk është një marrëveshje detyruese midis EBA-s dhe autoriteteve mbikëqyrëse të EJL-së, por krijon një kuadër bashkëpunimi dhe shkëmbimi informacioni, për të forcuar mbikëqyrjen dhe rregullin bankar të bankave që ushtrojnë veprimtarinë e tyre në vendet e BE-së dhe EJL-së. Ai ka për objektiv shkëmbimin e informacionit dhe bashkëpunimin, me qëllim krijimin e një forumi për të diskutuar një sërë çështjesh, të tilla si:

- konvergjenca me standardet dhe praktikat mbikëqyrëse, për të ndihmuar autoritetet e EJL-së në përpjekjet tyre për të rregulluar standardet rregullatore dhe mbikëqyrëse me ato që zbatohen në BE;
- funksionimin e kolegjeve mbikëqyrëse, ku EBA ka nxitur pjesëmarrjen e vendeve të EJL-së;
- shkëmbimin e informacioneve për rreziqet kryesore dhe dobësitë nga një këndvështrim makroprudencial;
- krijimin e bashkëpunimit lidhur me punën për vlerësimet e ekuivalencës.

Disa nga pikat që dua të trajtoj lidhen me punën që EBA ka bërë për analizimin e sfidave më të fundit për mbikëqyrësit dhe sektorin bankar, të cilat mund të ofrojnë gjithashtu informacion për sektorin bankar në rajon.

E para është ndikimi i FinTech. EBA ka bërë shumë punë për monitorimin e zhvillimeve të FinTech në Bashkimin Evropian. Ndikimi i parë në mënyrë të qartë ka qenë mbi modelet e veprimtarisë. Në lidhje me strategjitë digjitale, kemi parë se ndonjëherë rreziku vjen nga fakti se punonjësit për zbatimin e saj ose nuk janë të aftë të reagojnë si duhet ndaj ndryshimeve dhe mbesin mjaft pasivë, ose kthehen në kryesues agresivë dhe ndryshojnë modelin e veprimtarisë pa një vizon të qartë strategjik apo një objektiv strategjik të qartë në mendje.

Ndikimi i dytë është mbi aftësitë e zbatimit. Një kulturë e brendshme e orientuar drejt një mjedisi më të prirur nga ana teknologjike është

diçka që punonjësve do t'u duhet gjithnjë e më shumë, me qëllim që të avancojnë me strategjitë e inovacionit. Kështu që, kalimi nga një lloj tradicional aftësish në ato më digjitale është në mënyrë të qartë një sfidë.

Një ndikim tjetër lidhet me aksesin në grupin e talenteve në lidhje me ekspertizën e TI-së dhe talentet teknologjike, i cili po kthehet në një burim mjaft të pakët për institucionet, për sa i përket zhvilluesve nga lart-poshtë. Më pas është konkurrenca në rritje, e cila mund të ndikojë fitimin e punonjësve.

E fundit, ka gjithashtu disa ndikime në lidhje me qeverisjen e bankave. I pari është vetë organizimi. Ndonjëherë grupet e punës, të përbërë nga përfaqësues nga departamente të ndryshme ose grupe të ndara, janë përgjegjës për veprimtaritë e inovacionit dhe shpesh tentohet të jenë nën sektorin më të gjerë që merret me zhvillimin e veprimtarisë. Këtu, një nga sfidat që kemi parë shpesh është zhvillimi i një riorganizimi të qartë, i cili mund të adoptohet dhe të mbështesë modelin e veprimtarisë. Së dyti, në lidhje me kulturën dhe burimet, kur ka një ndikim mbi modelin e veprimtarisë, në institucion - kultura e brendshme dhe mendësia e stafit - janë elemente kryesore. Në punën tonë, kemi intervistuar nëpërmjet pyetësorëve një numër mbikëqyrësish. Ajo çfarë ka rezultuar është se kultura e brendshme e bankave dhe mendësia e tyre aktuale shiheshin nga vetë bankat si pengesë për zbatimin e strategjive inovative.

Planifikimi financiar dhe buxhetimi është një ndikim i tretë në lidhje me institucionin. Pse? Sepse disa herë, sfidat e reja kanalizohen në një buxhet të vetëm nën shpenzimet e përgjithshme për inovacionin, dhe mund të mos ketë qartësi në lidhje me mënyrën si projekti do t'i shpërndajë përfitimet. Kjo atëherë krijon vështirësi në shpërndarjen e duhur të buxhetit.

E fundit, një çështje tjetër ku EBA është angazhuar shumë, veçanërisht dy vitet e fundit, është veprimtaria e saj në lidhje me luftën kundër pastrimit të parave dhe luftën kundër financimit të terrorizmit, me qëllim sigurimin e integritetit, transparencës dhe funksionimin e tregut financiar.

Krimi financiar dhe pastrimi i parave ndikon objektivat tanë në dy mënyra E para, ata minojnë integritetin e tregut financiar. E dyta, EBA ka gjithashtu detyrimin ligjor, të forcojë zbatimin e vazhdueshëm të ligjeve kundër pastrimit të parave dhe kundër financimit të terrorizmit. Lidhur me këtë, EBA gjatë tri viteve të fundit ka kontribuar në zhvillimin e udhëzimeve dhe opinioneve, për të ofruar bazën për zbatimin e vazhdueshëm të rregullave kundër pastrimit të parave në të gjithë be-në.

Një sfidë tjetër është kalimi drejt zbatimit efektiv të këtyre rregullave nga këndvështrimi mbikëqyrës, duke i zhvendosur kështu veprimet kundër pastrimit të parave në mbikëqyrjen prudenciale. Kjo nënkupton forcimin e bashkëpunimit të mbikëqyrësve kundër pastrimit të parave dhe atyre prudencialë, si brenda vendit dhe në nivel ndërkombëtar, dhe më pas integrimin e veprimeve kundër pastrimit të parave në mbikëqyrjen prudenciale.

Kjo do të kërkojë vetëndërgjegjësim, që do të thotë të kuptuarin e sfidave dhe rreziqeve nga lufta kundër pastrimit të parave, rregullimin e veprimtarisë mbikëqyrëse dhe gjithashtu sigurimin se fokusi në veprimtaritë kundër pastrimit të parave drejtohet ndaj atyre modeleve të veprimtarisë që janë më të ekspozuara. E fundit, lufta kundër pastrimit të parave duhet integruar në tërësinë e instrumenteve prudenciale standarde.

Këto dy sfida madhore - ndikimi nga FinTech dhe ndikimi nga veprimet kundër pastrimit të parave - janë diçka që ne mendojmë se po prekin fushën e bankingut të BE-së dhe që mund të ofrojnë një perspektivë që mund të jetë ndihmuese gjithashtu jashtë BE-së. Sigurisht, unë ofrova një panoramë në vija të përgjithshme, dhe jam i sigurt se panelistët e tjerë do të ofrojnë më shumë detaje informuese për këto çështje.

Shumë faleminderit!

RAUNDI I TRETË I ZGJERIMIT TË EUROZONËS: A JANË GATI VENDET KANDIDATE?

*Milan DESKAR-ŠKRBIĆ**

Mirëmëngjesi të gjithëve!

Faleminderit që më ftuat në Tiranë! Është hera ime e parë këtu dhe e shijova me të vërtetë dje. Kam kaluar një mbrëmje të bukur në qytet, i cili është me të vërtetë plot jetë.

Do të doja gjithashtu të falënderoja kolegët e Departamentit të Kërkimeve të Bankës së Shqipërisë që më dhanë të dhënat për Shqipërinë. Kam përfshirë Shqipërinë në materialin tonë, e cila nuk ishte pjesë e versionit origjinal. Kisha frikë që materiali im nuk do të përshtatej sepse tema dukej pak e çuditshme kur shihni temën e panelit. Por pas diskutimit të djeshëm u inkurajova. Titulli i materialit është "Raundi i tretë i zgjerimit të Eurozonës", por është kryesisht mbi transmetimin e goditjeve nga vendet e Eurozonës në vendet e këtij rajoni. Do të përqendrohem te Kroacia, Bullgaria dhe Rumania, por gjithashtu kam përfshirë Shqipërinë dhe disa vende të tjera të EQL-së. Besoj që mund të jetë interesante për këtë konferencë sepse është gjithashtu e rëndësishme për bankat vendase. Në materialin tonë ne tregojmë që goditjet e jashtme, goditjet e Eurozonës, kanë ndikime të rëndësishme për vende jashtë Eurozonës. Pra duhet të jemi të vetëdijshëm që, megjithëse Shqipëria është gjeografikisht larg

* *Milan DESKAR-ŠKRBIĆ, Këshilltar, Departamenti i Modelimit, Banka Kombëtare e Kroacisë.*

nga Gjermania dhe Evropa Qendrore, kur flasim për lidhje tregtare dhe financiare, është shumë afër.

Pas krijimit të euros në vitin 1999 dhe pasi Greqia u fut në Eurozonë në vitin 2001, raundi i parë i zgjerimit mbaroi.

Raundi i dytë i zgjerimit filloi me Sllovenine në vitin 2007 dhe përfundoi me Lituaninë në vitin 2015. Tani, në përvjetorin e 20-të të euros ose ditëlindjen e 20-të të euros, kemi filluar të flasim për një zgjerim të mundshëm të tretë.



Vitet e fundit, Bullgaria, Kroacia dhe Rumania kanë theksuar gatishmërinë për t'u futur në Mekanizmin e Kursit të Këmbimit (MKK

II) dhe për të përdorur euron në një të ardhme të afërt. Bullgaria dërgoi një letër me kërkesën për t'u bashkuar me MKK-në në vitin 2018, Kroacia e ndoqi në korrik 2019, dhe Rumania krijoi organin zyrtar për përdorimin e euros në vendin e tyre dhe gjithashtu publikoi një strategji për adoptimin e euros. Aktualisht, mund të gjendet vetëm në rumanisht, por po presim të shohim versionin anglez. Këto vende pa diskutim po përgatiten për t'u futur në Eurozonë së shpejti. Në Kroaci, qëllimi ynë është të futemi në Eurozonë rreth viteve 2024-2025. Bullgaria dhe Rumania kanë ambicie të ngjashme. Mund të duket shumë larg, por nuk është kështu. Kanë kaluar vetëm pesë vite dhe pesë vjet në makroekonomi nuk janë aspak një kohë e gjatë.

Çfarë është interesante në këtë material është që kemi tre vende kandidate për Eurozonën dhe ato kanë histori monetare dhe të kursit të këmbimit plotësisht të ndryshme.

Siç e dini, Bullgaria ka një bord monedhe; pastaj kemi Kroacinë e cila ka një regjim të luhatshëm të administruar të kursit të këmbimit dhe më në fund kemi Rumaninë, që është vendi i vetëm në materialin tonë me një regjim inflacioni të shënjestruar. Rumania ka gjithashtu një regjim të luhatshëm të administruar të kursit të këmbimit.

Vendet kandidate të zonës euro – tri histori monetare



Aktualisht, nëse shohim klasifikimin e FMN-së, Rumania është akoma në një regjim të luhatshëm të kursit të këmbimit. Por banka qendrore rumune, në faqen web e përcakton kuadrin e kursit të këmbimit

të saj si luhatje e administruar. Mund të shohim që në të kaluarën, veçanërisht gjatë krizës së vitit 2009 dhe 2012, monedha rumune u zhvleftësua shumë. Në këto terma, mund të themi se në shembullin tonë, Rumania është akoma me regjim të luhatshëm. Jo më vonë se në vitet e fundit, ne mund të shohim stabilitetin e leut të Rumanisë. Në përgjithësi, mund të themi se Rumania është akoma me regjim të luhatshëm. Kjo është sigurisht interesante sepse kur flasim për ndikimet e tërthorta të goditjeve të jashtme, një nga pyetjet kryesore është nëse regjimi i kursit të këmbimit mund të ndikojë transmetimin dhe nëse kursi i luhatshëm i këmbimit mund të veprojë si amortizues.

Pyetja kryesore për kandidatët e rinj është "Cila është kostoja kur hiqni dorë nga politika juaj monetare?" Pra, nëse e shohim nën këndvështrimin praktik, atëherë mund të thoni "Dakord, ne nuk përdorim normën bazë të interesit si instrument të politikës, nuk mund ta ndryshojmë shumë kursin e këmbimit sepse kemi një nivel shumë të lartë euroizimi në vend". Mund të themi që ne nuk përdorim mjetet standarde të politikës monetare. Nën një farë këndvështrimi, po hoqëm dorë nga politika monetare, ne nuk humbim gati asgjë. Siç tha Guvernatori Vujčić, duke cituar Bob Dylan-in: "Kur nuk ke asgjë, atëherë nuk ke asgjë për të humbur." Por kjo është më tepër se një këndvështrim politik. Unë po flas më tepër nga një këndvështrim akademik. Nëse shohim literaturën empirike, përgjigjja e pyetjes "Cila është kostoja kur heq dorë nga politika monetare?" varet nga tre faktorë.

E para është koherenca e goditjeve ekonomike. Nëse goditjet në vendet tuaja, Kroaci, Bullgari, Rumani, janë të ngjashme me goditjet në Eurozonë, kjo do të thotë që cikli i biznesit ka gjithashtu një korrelacion të fortë me Eurozonën. Për më tepër, do të thotë se ka disa flukse kapitale apo edhe migracion të punës midis këtyre vendeve. Pra, nëse goditjet tuaja janë koherente, kjo është shenja e parë që një politikë monetare e përbashkët mund të jetë e përshtatshme për ju.

E dyta është sigurisht rëndësia e goditjeve të përbashkëta, ose ndikimi i goditjeve të rëndësishme për BQE-në mbi ekonominë tuaj. Në këtë material ne studiojmë goditje që janë të rëndësishme për politikën e BQE-së, dhe i quajmë "goditje të përbashkëta", sepse këto goditje ndikojnë si mbi Eurozonën, ashtu edhe mbi vendet tona në të njëjtën kohë. Nuk është e domosdoshme që origjina e këtyre

goditjeve të jetë në Eurozonë. Për shembull, BQE-ja reagon si ndaj goditjeve të çmimit të naftës dhe ndaj një ngadalësimi në Gjermani. Të gjitha goditjet janë marrë në kontekst, por ato kanë ndikuar si mbi Eurozonën, ashtu edhe mbi vendet tona. Nëse këto goditje janë të rëndësishme si për Eurozonën dhe për vendet tona, do të thotë që një politikë monetare e përbashkët mund të jetë e përshtatshme.

Dhe e fundit. Nëse efektet e politikës monetare të BQE-së mbi vendet tona janë që tani të ngjashme me efektet mbi Eurozonën, kjo do të thotë që pas hyrjes në Eurozonë këto efekte do të bëhen akoma më të ngjashme. Në këtë rast mund të themi gjithashtu që politika monetare e përbashkët do të ishte e përshtatshme.

Në këtë material ne ofrojmë një kornizë të re analitike që na lejon të krahasojmë drejtpërdrejt rëndësinë e goditjeve të Eurozonës me peshën që goditjet e Eurozonës kanë në vendet tona kandidate.

Nuk do ta shpjegoj metodologjinë në detaje, sepse kjo nuk është një konferencë shkencore, dhe jemi pak me vonesë. Prandaj do të kaloj menjëherë te rezultatet. Çfarë mund të shohim këtu?



Mora shembullin e Bullgarisë sepse ka vetëm dy goditje të brendshme. Pra marrin PBB-në e vendit dhe inflacionin dhe llogarisim kontributin e goditjeve të brendshme ose idiosinkratike dhe kontributin e goditjeve të Eurozonës. Në këtë grafik, goditjet e Eurozonës janë: e kuqe, vjollcë dhe e verdhë; ndërsa goditjet e brendshme janë në gri.

Në vështrim të parë, mund të shihni që, për shembull, në Bullgari, goditjet e Eurozonës luajnë një rol dominues, që do të thotë që PBB-ja bullgare përcaktohet kryesisht nga goditjet e jashtme. Gjithashtu kemi rezultate të ngjashme për Rumaninë dhe Kroacinë. Dhe mund të shihni një trend të ngjashëm edhe për Shqipërinë.

Çfarë duhet të bëjmë më pas?

Kemi llogaritur pjesën e këtyre goditjeve të Eurozonës ndaj kontributit total. Siç mund ta shihni në grafik, kemi mbledhur goditjen e politikës monetare ZE, goditjen ZE KA, goditjen ZE AK. Numërojmë këto dhe pastaj i ndajmë me kontributin total dhe kemi pjesën e goditjeve të Eurozonës ndaj kontributit total.





$$y_{jt}^{k} = \frac{|y_{jt}^{k}|}{\sum_{l=1}^{n} |y_{jt}^{l}|} \qquad \sum_{k=1}^{5} y_{jt}^{k}$$

Kur llogarisim këtë pjesë kemi panoramën si më sipër për vendet tona kandidate.

E para, mund të shihni diçka shumë të rëndësishme për të tre vendet: pjesa e goditjeve të Eurozonës në PBB dhe inflacion luhatet ndërmjet 50% dhe 70%, që është domethënëse. E dyta që mund të shihet është që pjesa e goditjeve të Eurozonës në Rumani qëndron më poshtë se për Kroacinë dhe Bullgarinë. Pyetja jonë ishte: "Mund ta shpjegojmë këtë ndryshim nëpërmjet kursit të këmbimit?", - siç thashë - ka një ndryshim në kursin e këmbimit dhe regjimin e politikës monetare në Rumani në krahasim me Bullgarinë dhe Kroacinë.

Për t'iu përgjigjur kësaj pyetjeje, kemi përfshirë gjithashtu disa vende me regjim të luhatshëm të rajonit EQL dhe Shqipërinë.

Në këtë grafik, vendet me regjim të luhatshëm këmbimi janë me të kuqe dhe ato fiks janë me blu, dhe mund të shihni që shumica e vendeve me regjim të luhatshëm janë me të vërtetë poshtë vijës blu.



Kjo do të thotë që kursi i këmbimit ndikon mbi transmetimin e goditjeve të jashtme; ose mund të përfundojmë që kursi i luhatshëm i këmbimit mund të shërbejë pjesërisht si zbutës në këtë rajon, për sa i përket përhapjes. Sidoqoftë, gjëja më e rëndësishme është që pjesa e goditjeve të Eurozonës është mjaft e lartë në të gjitha vendet. Nëse shohim Shqipërinë, që është prezantuar në grafik me vijë të kuqe të trashë, pjesa e goditjeve të Eurozonës në PBB-në shqiptare

lëviz rreth 55%. Për inflacionin, gjithashtu lëviz rreth 55%. Pra, në Shqipëri, si dhe në Republikën Çeke, Suedi, Mbretërinë e Bashkuar dhe të gjitha vendet e tjera me regjim të luhatshëm, keni akoma një rol të theksuar të goditjeve të jashtme. Një kurs i luhatshëm i këmbimit mund të veprojë si zbutës i goditjeve, por pjesa e goditjeve të jashtme është prapë shumë e lartë, gjë që është me të vërtetë e rëndësishme.

Po flisnim dje në Bankën e Shqipërisë për perspektivat e Eurozonës dhe ato nuk duken shumë të mira. Prandaj, duhet të jemi të vetëdijshëm që kur gjërat shkojnë keq aty, ato mund të përhapen me lehtësi në këtë rajon. Dje folëm gjithashtu për disa kanale transmetimi. Kanali tregtar - partnerët tregtarë kryesorë janë Gjermania, Greqia, Italia, të gjitha vende anëtare të Eurozonës. Vështrova gjithashtu strukturën e sistemit bankar; dy banka nga Eurozona janë ndërmjet pesë bankave më të mëdha në vend. Pra, ka disa lidhje financiare. Gjithashtu, si Nadeem Iliahi i FMN-së tha dje, një rol të rëndësishëm e kanë dërgesat e emigrantëve. Ka shumë lidhje, ka shumë kanale, nëpërmjet të cilave goditjet e Eurozonës mund të ndikojnë vendet tona.

Gjëja e fundit që bëmë në material ishte të shihnim si goditjet e politikës monetare të BQE-së ndikonin vendet tona.

Një goditje të politikës monetare, e kemi përcaktuar me shenjë negative, do të thotë lehtësim i politikës monetare. Këtu morëm një normë hije. Nuk përdorëm një normë REPO të BQE-së. Morëm



normën hije, sepse norma hije përfshin si masat konvencionale dhe ato jokonvencionale. Në pjesën më të madhe të kampionit tonë BQE-ja ka përdorur masa jokonvencionale.

Çfarë mund të shihni këtu, nëse krahasoni Eurozonën, në figurën e parë, me Bullgarinë, Kroacinë, e Rumaninë mund të shihni që ndikimet janë me të vërtetë të ngjashme. Pra, goditjet e politikës monetare lehtësuese çuan në një rritje afatshkurtër të PBB-së dhe me efekt të përhershëm mbi inflacionin e Eurozonës. Kemi rezultate të ngjashme për të gjitha vendet e tjera. Rezultati i vetëm i veçantë, për inflacionin, është Rumania. Mund të shihni që ky ndikim ishte shumë i ndryshëm, por kemi pasur disa probleme me të dhënat, sepse, Rumania ka përjetuar hiperinflacion në pjesë të kampionit, dhe normat e inflacionit janë shumë të luhatshme në Rumani. Por mund të thuhet që ndikimet e goditjeve të politikës monetare të BQE-së janë me të vërtetë të ngjashme në të gjitha vendet.

Ne gjithashtu bëmë disa teste statistikisht domethënëse mbi këto ndryshime.



Në fillim, duken të ngjashme, por gjithashtu kontrolluam nëse janë statistikisht të ndryshme. Dhe mund të themi që nuk janë statistikisht të ndryshme. Kjo do të thotë që goditjet e BQE-së kanë ndikime të ngjashme mbi PBB-në dhe inflacionin si në Eurozonë, ashtu edhe në vendet tona kandidate.

Bëra gjithashtu llogaritjet për Shqipërinë. Së pari, siç e përmenda më parë, faleminderit Bankës së Shqipërisë që më dha të dhënat, sepse është me të vërtetë e vështirë të gjesh të dhëna mbi PBB-në dhe inflacionin në Shqipëri. Rezultatet janë të ngjashme.



Çfarë mund të shohim këtu është që për shembull, goditja e politikës monetare ka një ndikim pozitiv mbi PBB-në shqiptare që është statistikisht i rëndësishëm. Ka pasur gjithashtu një ndikim pozitiv mbi inflacionin. Është interesante, sepse dje diskutuam presionet e mbiçmimit mbi lekun shqiptar. Mund të shohim që politika monetare lehtësuese në Eurozonë ka çuar në mbiçmimin e lekut shqiptar. Është një rezultat i rëndësishëm. Gjithashtu, mund të shohim që goditjet KA dhe AK gjithashtu kanë ndikime pozitive mbi PBB-në në Shqipëri, dhe janë statistikisht të rëndësishme. Pra, mund të themi, që megjithëse disa njerëz mendojnë që Shqipëria është shumë larg nga Eurozona, ne tashmë mund të shohim që goditjet e Eurozonës kanë ndikime shumë të rëndësishme mbi ekonominë shqiptare dhe ekonomi të tjera.

Shumë faleminderit!

NDRYSHIMI I MODELIT TË BIZNESIT TË BANKAVE NË GRUPIN ISP

*Paola ANGELETTI**

Së pari, faleminderit që më keni ftuar në këtë aktivitet shumë interesant dhe të rëndësishëm këtu në Tiranë. Me të vërtetë falënderoj Bankën e Shqipërisë që organizon këtë konferencë dhe më mundësoi të jem pjesë e këtij sesioni.

Deri tani kam dëgjuar mendime shumë interesante. Ndërsa unë, le të themi, që do të sjell një këndvështrim ndryshe, atë të një grupi bankar ndërkombëtar, që aktualisht është duke menduar për modelin e veprimtarisë së tij, çdo ditë, çdo kohë që strategjia rivlerësohet dhe testohet. Dëshiroj t'i vendos gjërat në kontekst dhe do t'ju ofroj një

* *Paola ANGELETTI, Drejtoreshë e Divizionit Ndërkombëtar të Bankave Filiale, Intesa Sanpaolo SpA.*

informacion bazë se si Intesa Sanpaolo është aktive në rajon dhe më pas do të zhvendosem tek strategjia.

Dua t'ju tregoj disa shifra që tregojnë se cili është Grupi Intesa San Paolo dhe se çfarë bën Divizioni Ndërkombëtar i Intesa Sanpaolo brenda të gjithë grupit.

Ne jemi krenarë për raportet tona të qëndrueshme të kapitalit, të cilat paraqiten këtu, në lidhje me gjysmën e parë të vitit krahasuar me një vit me parë. Divizioni Ndërkombëtar i Bankave Filiale, Intesa Sanpaolo SpA përfaqëson një pjesë relativisht të vogël të aktiveve, 6% të grupit, si dhe përqindje më të lartë të të ardhurave operacionale dhe të ardhurave neto të të gjithë grupit.



Intesa Sanpaolo është krenare që nuk mendon vetëm për fitimet, që sigurisht janë pjesë e rëndësishme e veprimtarisë sonë, por gjithashtu dhe për përgjegjësinë e përbashkët sociale në të gjitha vendet ku ne ushtrojmë veprimtarinë tonë.

Sigurisht vendi ynë i origjinës është Italia, por në të gjitha vendet ku ushtrojmë aktivitet, ne kujdesemi edhe për zhvillimin e një mjedisi të shëndetshëm, ku institucionet financiare të ngjashme me ne të mund të ushtrojnë aktivitetin e tyre.

Vetëm për t'ju dhënë një ide se ku jemi shtrirë dhe ushtrojmë aktivitetin tonë. Ne ushtrojmë aktivitetin tonë kryesisht në Evropën



Lindore dhe Qendrore dhe në Egjipt. Gjithashtu, kemi disa projekte që po zhvillohen në Kinë. Kështu pra, është një situatë mjaft e ndryshme. Ne kemi banka që janë në vendin e parë apo të dytë në disa vende, për shembull, banka jonë në Kroaci është në vendin e dytë. Vetëm disa minuta më parë dëgjuam për Kroacinë. Ne jemi në vend të parë në Serbi dhe në Sllovaki, ku zëmë një pjesë shumë të rëndësishme të tregut. Kemi banka më të vogla në vendet e tjera. Kjo ishte një përmbledhje e pranisë sonë në EJL dhe në rajon.

Cila është përqasja jonë?

Ne kemi një eksperiencë të gjatë, nëse ju kujtohet. Unë jam bërë Drejtoreshë e Divizionit Ndërkombëtar vetëm së fundmi, por ne kemi qenë të pranishëm në vende të ndryshme madje dhe para vitit 2000.

Banka e fundit që i është bashkuar grupit tonë është banka në Moldavi, dy ose tri vite më parë. Por, numri i vendeve ku jemi të pranishëm, siç tregohet në grafik, është një listë mjaft e gjatë, dhe ne jemi një investitor afatgjatë në secilin vend.

Kjo shtrirje sigurisht sjell çështje të rëndësishme lidhur me atë se si e përcaktojmë dhe hartojmë strategjinë tonë. Duke ditur se mjedisi rreth nesh ndryshon me shpejtësi - dhe dëgjuam nga panelistët se cilat janë karakteristikat e mjedisit - kjo ndikon sektorin ndërkombëtar.

Ka një numër tendencash ekzogjene që ne duhet t'i analizojmë.

Le të fillojmë me çështjen e përputhshmërisë. Kjo është vetëm një fjalë, por përfshin një botë shumë të ndërlikuar me të cilën po përballen institucionet financiare. Ne kemi mbikëqyrës në secilin vend ku ushtrojmë veprimtari, një pjesë sigurisht është BQE-ja, por duke nisur nga kjo na duhet të jemi në përputhje me të gjitha rregulloret e hartuara nga mbikëqyrësit e secilit vend ku jemi të pranishëm. Janë rregullore, jo vetëm për sektorin bankar, por dhe për tregun e kapitalit, për sigurimet shoqërore, për të gjitha autoritetet që rregullojnë veprimtarinë e një grupi financiar siç është dhe grupi jonë.

Sigurisht, ekziston edhe një tendencë tjetër, u përmend tashmë, digjitalizimi. Ai çon në nevojën për të rimenduar me të vërtetë më thellë strategjinë e shpërndarjes së një institucioni financiar. Ne jemi një grup i përfshirë në bankingun tregtar, investime bankare, sigurime, administrim të aktiveve, por digjitalizimi ndikon të gjitha veprimtaritë tona, dhe do t'i rikthehem kësaj çështjeje pak më poshtë në prezantim.

Ky evoluim mund të sjellë edhe kërcënime, siç dhe u përmend, por gjithashtu dhe mundësi. Në qoftë se ky evoluim administrohet dhe kuptohet në mënyrën e duhur, por edhe paraprihet, ai me të vërtetë

përfaqëson për një grup si i yni, një mundësi për t'u shërbyer më mirë klientëve tanë.

E fundit, por jo më e pakta, ne po jetojmë në një mjedis me norma të ulëta interesi. Marzhi i normave neto të interesit nuk mund të shkojë më tej, si baza jonë e vetme për fitimin dhe remunerimin e kapitalit. Kështu që, ne duhet të rishikojmë modelin e aktivitetit për t'ia dalë mbanë në këtë mjedis të ri dhe në fakt në të gjitha vendet ku ushtrojmë veprimtarinë tonë. Nuk është diçka që prek vetëm vendet e Eurozonës, por edhe vende në rajonet fqinje, ku normat e interesit kanë tendencë të konvergojnë me ato në vendet e Eurozonës.



Grafiku i mësipërm tregon sa i ndërlikuar është sistemi dhe të gjitha çështjet që duhet të merren parasysh kur hartohet strategjia e aktivitetit. U përpoqa të shpjegoj se çfarë mendojmë në lidhje me modelin tonë të aktivitetit.

Tani ajo çfarë na duhet të bëjmë është të zhvillojmë një model të aktivitetit që trajton në mënyrën më të mirë të mundshme nevojat specifike për çdo segment të klientëve tanë. Kjo do të thotë që të evoluojmë dhe përditësojmë vazhdimisht mënyrën e të shërbyerit të klientëve tanë, dhe gjithashtu - ashtu si dhe u tha këtu - të zhvillojmë një strategji digjitale, me qëllim që të mos varemi vetëm në rrjetin fizik, por të mbështetemi edhe në rrjetet tona digjitale.

Kjo nuk është diçka që ne mund ta bëjmë, por që duhet ta bëjmë. Nuk mendoj se ndonjë institucion financiar do të mund të mbijetojë, në qoftë se nuk ka një strategji digjitale në planet e tij. Një çështje tjetër që është me të vërtetë tejet e rëndësishme për një institucion si i yni, është ajo e Evropës si një e tërë. Jo vetëm ky rajon, por Evropa si një e tërë është relativisht e vogël nëse e krahasojmë me fitimet që vijnë nga Shtetet e Bashkuara apo nga Kina. Kështu që, çdo monedhë e vetme euro që ne investojmë duhet përdorur me qëllim që të kemi fitime nga të gjitha rrjetet tona në të gjitha vendet ku veprojmë. Kjo do të thotë se duhet të punojmë me qëllim që të kemi një konvergjencë operacionale, në mënyrë që modelet e aktivitetit, që sigurisht janë specifike në secilin vend, të funksionojnë në mënyrën më të ngjashme të mundshme midis tyre, me qëllim që me të vërtetë të jenë në një pozicion që të përfitojnë nga të gjitha investimet që ne bëjmë në nivel grupi.

Kjo është marrë parasysh kur hartuam strategjinë tonë, e cila u publikua në fillim të vitit të kaluar. Planet tona të veprimtarisë shtrihen nga 2018 deri në 2021. Strategjia për divizionin ndërkombëtar përqendrohet në tri shtylla kryesore, si më poshtë, duke u përpjekur që me të vërtetë të zhvillojë një konvergjencë të platformave operuese. Sigurisht, kjo përfshin revolucion të sistemeve të TI-së, që është një punë e madhe. Është një punë shumë e vështirë. Nuk ndodh brenda natës. Duhen vite për çdo investim. Por është diçka që nevojitet me qëllim që të jemi në një pozitë për të konkurruar globalisht. Elementi i dytë është evoluimi i modelit të shërbimit, forcimi i modelit të shërbimit që

merr parasysh si aktivitetin që kryhet drejtpërsëdrejti me klientin, ashtu dhe aktivitetin korporatë.



Në aktivitetin që kryhet drejtpërsëdrejti me klientin, ne po përpiqemi të punojmë sa më shumë që të jetë e mundur me qëllim që të forcojmë rrjetin tonë të degëve, si në terma të vendndodhjes dhe të optimizimit, në lidhje me proceset që karakterizojnë aktivitetin tonë brenda degëve me qëllim që klientët të shërbehen në mënyrën më të mirë të mundshme.

Atëherë ne po zhvillojmë një Model të Shërbimit të Këshillimit për Administrimin e Pasurisë që të mund të jetë në përputhje me të gjitha rregullat, por gjithashtu i hartuar me qëllim që t'i shërbejë sa më mirë klientëve tanë. Ne po koordinojmë veprimtarinë për bankingun korporatë, pra kemi bankierë të lartë që po ndjekin rajonin, në mënyrë të tillë që kompanitë shumëkombëshe të mund të gjejnë partnerin e tyre brenda bankës dhe brenda grupit. Ata mund të shkojnë në të gjitha bankat që ne kemi në vendet e tjera.

Nga ana digjitale, do të thoja *Digical*, sepse kjo është fjala që ne përdorim brenda grupit dhe do ta shpjegoj këtë në vijim.

Këto janë disa nga përfitimet organizative të vëna në dukje që vijnë nga konvergjenca e platformave tona vepruese. Kjo përfshin jo

vetëm konvergjencën e të vepruarit, por gjithashtu një rimendim të rëndësishëm të drejtuesve të të gjitha proceseve kudo brenda grupit. Kjo u përmend gjithashtu dhe më parë në një prezantim tjetër. Me të vërtetë fakti që koordinimi i proceseve brenda bankave të divizionit është shumë i rëndësishëm me qëllim që të trajtojë, për shembull, rreziqet që vijnë nga kreditimi, në mënyrë koherente, duke marrë parasysh specifikat vendore, por në të njëjtën kohë, një oreks të shëndoshë për rrezik që ka nevojë të koordinohet në nivel grupi. Gjithashtu, duke pasur struktura organizative që janë të krahasueshme në çdo vend: drejtorë në administrimin e proceseve të burimeve njerëzore; duke vënë standarde dhe rritur profesionalizmin në secilin vend specifik.



Harta tregon se çfarë do të thotë të kesh konvergjencë në operacionet dhe modelin e veprimtarisë. Ne po zhvillojmë një projekt në nivel grupi. Ne e quajmë *AGDM* - Adaptim i Modelit të Shpërndarjes së Grupit - i cili nuk do të thotë se çdo bankë është e njëjtë në çdo vend. Kjo do të ishte çmenduri. Kjo do të thotë kritere të përcaktuara nëpërmjet të cilave ne strukturojmë rrjetet tona të përbashkëta në të gjithë Eurozonën dhe në rajon. Kjo bëhet nëpërmjet forcimit të kanaleve, jo vetëm të degës, por dhe të ATM-ve. Kjo do të rrisë në mënyrë progresive kohën në dispozicion të njerëzve tanë në degë për t'u shërbyer klientëve dhe për të folur me klientët, sepse transaksioni do të kryhet gradualisht nga kanalet online dhe drejt ATM-ve. Kjo gjithashtu na mundëson të kuptojmë më mirë klientët tanë dhe të jemi në gjendje të bëjmë segmentim më të mirë të klientëve me qëllim që të trajtojmë nevojat specifike të tyre.



Mendoj se është gjithashtu e rëndësishme të theksohet evoluimi digjital. Siç e vura në dukje më lart, ne brenda grupit e quajmë "Digical". Përse? Është kombinimi midis "digjitalizimit" dhe "përmirësimit fizik". Kështu që i vendosëm së bashku në një term të vetëm. Ne donim që kanalet tona të drejtpërdrejta të bëhen të disponueshme për klientët tanë. Kjo është kryesisht për veprimtarinë e drejtpërdrejtë të ofrimit të produkteve tek klientët. Ato janë hartuar në mënyrë të tillë që klientët të përjetojnë atë që në botë quhet "përvojë e njëjtë", një përvojë e lehtë, jo vetëm për transaksione dhe veprime, por edhe për të përfituar produktet e bankave tona.

Më pas kemi kanalin e dytë që është portali publik, të cilin mund ta përdorin jo vetëm klientët tanë, por gjithashtu dhe klientë të rinj, klientë të mundshëm në të ardhmen. Tingëllon pak keq, por kjo do të thotë se nuk mundemi thjesht t'i shërbejmë çdo klienti, për aq kohë sa ne nuk e njohim klientin, kështu që ne hulumtojmë për të me qëllim që të vazhdojmë me të gjitha procedurat e nevojshme që kërkohen nga standardi: "të njohësh veprimtarinë e klientit tënd", gjithashtu online, jo vetëm fizikisht".

Shtylla e tretë është të zhvillojmë - dhe kjo është diçka që ne jemi duke e bërë - një Digical për veprimtarinë. Jo vetëm në mënyrë private, për investimet e nevojshme në veprimtarinë e ofrimit të drejtpërdrejtë të produkteve tona për bankingun digjital, por gjithashtu për kompanitë dhe bizneset e vogla, të cilat kanë nevojë të kenë një bankë që të mund t'i ndërlidhë në mënyrë digjitale.

Gjëja e fundit e cila ofron shpjegim të emrit të projektit tonë "Digical" është dega digjitale. Njerëzit tanë që punojnë në degë kanë nevojë të kenë të gjitha instrumentet me qëllim që t'i shërbejnë sa më mirë klientit, pasi ai të vijë në degë. Gjëja e rëndësishme është nëse klienti sheh diçka – për shembull - online, dhe dëshiron të pyesë për një kredi, dhe pastaj bën disa zgjedhje online, por më pas ai ka nevojë për këshilla. Ai shkon tek dega. Ai nuk do që të shpenzojë kohë për të rinisur gjithçka nga fillimi. Pra, pasi shkon në degë, drejtuesi i degës ka mundësi të shohë se çfarë ka simuluar tashmë klienti. Pra ai nuk fillon sërish nga e para. Ai fillon pikërisht në pikën në të cilën klienti ndaloi dhe kishte nevojë për ndihmën e tij.

Kështu që, kanalet duhet të jenë të integruara, në mënyrë që sistemi i degëve dhe kanalet online të funksionojnë së bashku për të ofruar shërbimin më të mirë për klientët.

U përpoqa të bëj një sintezë të nismave tona, po para se t'ju falënderoj të gjithëve, dua të them dhe një koment të fundit: Siç mund ta kuptoni, me qëllim që të arrijmë atë çfarë duam dhe ne po evoluojmë, duhen shumë investime, dhe secili vend ku ne ushtrojmë veprimtarinë tonë, nuk mund t'i përballojë të gjitha investimet për të zhvilluar këto lloj instrumentesh. Pra, është me të vërtetë e rëndësishme që ne të jemi në gjendje të zhvillojmë një qendër të ekselencës në secilin vend, por secili vend zhvillon aftësinë që të mund ta vendosë në dispozicion të të gjitha vendeve të tjera. Përndryshe, një grup si i yni nuk do të mund të mbështesë investimet e nevojshme për të administruar inovacionet që ne presim t'u ofrojmë klientëve tanë.

Faleminderit!

SISTEMI BANKAR SHQIPTAR: EVOLUCIONI DHE ZHVILLIMET E MUNDSHME

*Silvio PEDRAZZI**

Mirëdita!

Ndërsa prezantuesit e nderuar sollën përvojën e tyre ndërkombëtare, unë do të përqendrohem në atë vendore. Me krenari pohoj se kam më shumë se gjashtë vite që punoj në Shqipëri, kështu që, kam pasur mundësi të vëzhgoj evoluimin e sistemit bankar dhe të kuptoj sa shumë është bërë - në rrethana jo aq të lehta - në rrugën drejt integrimit me praktikat më të mira evropiane. Dëshiroj të falënderoj në veçanti Bankën e Shqipërisë që, me profesionalizëm të lartë, na udhëhoqi në këtë udhëtim që pasqyron ndryshime të mëdha; Shqipëria ka nevojë për këtë dhe le të shpresojmë se ne do ia dalim dhe do ta përfundojmë atë sa më shpejt që të jetë e mundur.

Thënë këtë, po prezantoj disa skema dhe grafikë. Ato përmbajnë informacione tashmë mjaft të njohura për Shqipërinë, por mendoj se është e rëndësishme të rifreskojmë ndërgjegjësimin, veçanërisht për shpërndarjen demografike, gjithashtu në krahasim me vendet e tjera fqinje. Mendoj se jo vetëm për sistemin bankar apo për grupet bankare, por gjithashtu për të gjithë investitorët e huaj, kjo është një pikë e mirë nisjeje me qëllim që të mendojmë për potencialin e Shqipërisë dhe më gjerë, të rajonit të Ballkanit.

* *Silvio PEDRAZZI, Kryetar, Shoqata Shqiptare e Bankave.*

Nuk do të komentoj çdo *slide*, por do të përpiqem të përmbledh konceptet kryesore.

Shohim se ekonomia shqiptare po rritet më shpejt vitet e fundit, edhe pse ka një ngadalësim të konsiderueshëm në vitin 2019, ndoshta për shkak të rrethanave kushtëzuese (më pak reshje shiu, siç u përmend nga ish-ministri, me ndikim të lartë në PBB), por në përgjithësi tendenca është mjaft pozitive. Për më tepër, shumë sektorë ekonomikë ende nuk janë zhvilluar ashtu si duhet, duke pasur më shumë potencial që duhet shfrytëzuar: turizmi; energjetika, bujqësia, shërbimet, janë shembuj të mirë.

Kjo do të thotë se mundësitë për rritje aktualisht janë më të larta se rreziqet nga poshtë, por Shqipëria ashtu si shumë vende fqinje, duhet të përballet me një problem aktual: madhësinë e vlerës absolute. Në fakt, madhësia ka rëndësi: Ajo ka rëndësi për vetë vendin, ka rëndësi për një grup bankar ndërkombëtar, ka rëndësi për një bankë të vetme, qoftë me kapital të huaj apo me kapital vendas, dhe gjithashtu ka rëndësi për të gjithë investitorët.

Me të vërtetë besoj se një nga faktorët kryesorë në procesin e vendimmarrjes së investitorëve, sigurisht në industrinë bankare, është madhësia e ekonomisë, përderisa një aktivitet i përshtatshëm kërkon një përmasë minimale kufi. Mospasja e një përmase të rëndësishme, e një marrëdhënieje midis investimeve, fitimit, si dhe kapitalin e duhur, mund të çojë në territor negativ. Kjo përshtypje, ndoshta është çelësi i leximit për të shpjeguar se çfarë ka ndodhur së fundmi, pothuajse papritur, në sistemin bankar shqiptar.

Një pikë tjetër që dëshiroj të risjell nga prezantimet e mëparshme i referohet rëndësisë mbi rritjen e ngadaltë dhe jo të kënaqshme të portofolit të kredisë në Shqipëri. Në qoftë se, nga njëra anë, është e vërtetë se stoku total nuk po rritet aq shpejt, nga ana tjetër, ne nuk duhet të harrojmë rënien e theksuar në stokun e kredive me probleme. Gjashtë vite më parë, raporti i kredive me probleme ishte shumë më i lartë - sipas të dhënave zyrtare, me gjasë të nënvlerësuara - ishte rreth 25%, por sot ky nivel ka zbritur në rreth 11%. Kjo do të thotë se, 15%-20% e të gjithë portofolit të kredisë ose është rikuperuar ose është fshirë nga bilanci; kështu që, në qoftë se, normalizojmë të dhënat, duke u përqendruar vetëm në kreditë e mira, mund të shohim se rritja reale duket plotësisht e ndryshme.

Sot, cilësia e portofolit të kredive është shumë më e mirë, duke iu mundësuar bankave që të shohin pozitivisht dhe të ndjekin strategji më agresive të kredidhënies.

Gjithashtu, ka një tendencë tjetër e cila vlen të përmendet: ashtu si në vendet e tjera, dinamikat e rëndësishme në tregjet me pakicë dhe të korporatave ndryshojnë në mënyrë të konsiderueshme. Ndërsa tregu me pakicë shfaq një kërkesë të fortë si për kredinë hipotekare dhe atë konsumatore, duket se ka një rënie në atë të korporatave. Ky nuk është një lajm i mirë për tërë ekonominë, pasi mund të sinjalizojë një mungesë të besueshmërisë në investimet e ardhshme nga ana e sipërmarrësve dhe duket se shteti po ndërmerr iniciativa nëpërmjet projekteve infrastrukturore shumë interesante.

Sistemi bankar po i sheh me interes këto projekte, por dhe një herë më duhet t'i kthehem çështjes së madhësisë.

Aftësia për të financuar projekte të mëdha kërkon nga banka ekspertizë dhe aftësinë e duhur. Një aftësi e tillë vjen kryesisht nga kapitali rregullator dhe kufiri i kreditimit individual për klientë të vetëm dhe grup klientësh të lidhur; për më tepër, kufiri i përqendrimit gjithashtu është i rëndësishëm. Këto janë kufizime konkrete në lidhje me aftësinë për të shenjëstruar, pikërisht në momentin në të cilin vendi ka nevojë për këto investime të mëdha infrastrukturore.

Disa nga këto mendime nuk janë përfshirë në prezantim, por mendoj se janë plotësisht të lidhura me çështjet që po diskutojmë sot.





Mendoj se pjesa e parë e prezantimit mund të quhet e mbyllur dhe shpresoj që do të arrini të nxirrni disa përfundime interesante. Edhe një herë ju ftoj t'i kushtoni vëmendje të veçantë krahasimit të të dhënave makro të raportuara nga vendet e tjera; konteksti shoqëror

gjithashtu është i rëndësishëm, dhe sinjalizon përmirësim dhe hapësirë për rritje të mëtejshme.

Le të vazhdojmë me pjesën e dytë, ndoshta më interesantja, duke u përpjekur të analizojmë ngjarjet e fundit në sistemin bankar dhe zhvillimet e mundshme të mëtejshme.

Çfarë ka ndodhur papritur në tetëmbëdhjetë muajt e fundit, si pasojë e procesit të gjatë të maturimit?

Ne patëm gjashtë marrëveshje në vend. Njëra ishte përthithja e një prej bankave greke nga Banka ABI, me kapital amerikan. Ajo u pasua me përthithjen e 100% të aksionerëve nga grupi bankar OTP në Hungari të ish-Bankës Société Générale, nga një bankë evropiane tek një tjetër po evropiane. Një bankë greke u përthith nga grupi industrial dhe financiar më i madh në Shqipëri, Balfin. Kështu pra, nga kapital evropian në kapital shqiptar. Banka Veneto u përthith nga Banka Intesa San Paolo, pra Evropë me Evropë. Banka Tregtare Ndërkombëtare u përthith nga Banka Union, me kapital vendas me BERZh si aksioner në minorancë. Së fundmi, në qershor të këtij viti, Banka e Kreditit të Shqipërisë vendosi të likuidojë veprimet e saj dhe Banka e Shqipërisë revokoi licencën e saj.

Kështu pra, gjashtë banka u zhdukën në një periudhë të shkurtër kohe.

Ne, si Shoqatë e Bankave, ende mund të hasim vështirësi për të bërë një vlerësim. Jam i sigurt se Banka e Shqipërisë ka shifra më të sakta - se çfarë ka ndodhur.

Si dhe ku janë transferuar aktivet, kreditë dhe depozitat, gjithashtu duke pasur parasysh një ngjarje tjetër, ndikimi i së cilës do të jetë i dukshëm vetëm pas 1 janarit 2019?

E kam fjalën për ndarjen e veprimeve të Kosovës nga librat e bankës më të madhe shqiptare (me kapital turk); në fakt një ngjarje e tillë ndryshon shpërndarjen dhe peshën relative të pjesës së tregut midis bankave.

Gjithashtu, është e rëndësishme të vihen në dukje disa procese që ndodhin brenda kompanive që vendosin të shkrihen, të përthithin, blejnë apo të shesin. Normalisht, në periudhën tranzitore deri në përfundim, mund të shohim veprime që kanë për qëllim pastrimin e portofolit ose të optimizojnë shpërndarjen e aktiveve, përkundrejt ndikimit të peshës së tregut: një shembull është Banka Intesa San Paolo me Banka Veneto, që nënkuptoi shitjen e të gjithë portofolit të kredive me probleme të kësaj të fundit.

Situata aktuale, bazuar në të dhënat e muajit mars 2019, është që sot kemi gjashtë banka me kapital evropian, pesë banka të huaja jo të BE-së dhe tri banka shqiptare.

Më parë raporti ishte nëntë, pesë dhe dy. Në këtë grafik u përpoqa të përmblidhja lëvizjen gjatë tri viteve të fundit në peshën e tregut, duke e ndarë sistemin bankar në grupe: banka evropiane, banka të huaja joevropiane dhe banka shqiptare.

Është e konfirmuar, siç u përmend dhe në një nga prezantimet sot në mëngjes, se bankat vendase kanë rritur konsiderueshëm peshën e tyre në treg, si në totalin e aktiveve, kredive dhe në atë të depozitave. Por ende nuk mund të pohoj se kjo është një tendencë e konsoliduar, se kjo do të zgjasë dhe në të ardhmen. Sipas mendimit tim, vetëm me shifrat përfundimtare të 2019-ës, ne mund të arrijmë në një konfirmim ose jo të tendencave të evidentuara.

Duke u zhvendosur tek skema tjetër - dhe kjo është një punë e vështirë, nuk pretendoj se është absolutisht e saktë - mund të shihni në anën e majtë lart, bankat evropiane që kanë ardhur në rënie gjatë horizontit kohor trevjeçar prej 14% të totalit të aktiveve. Pjesa më e madhe, rreth 9%-10% i referohet bankave evropiane greke, që ndryshuan pronësi, ndërsa bankat e tjera joevropiane ishin të

interesuara në dhënien e ofertave. Humbja në peshën e tregut për bankat evropiane ishte 9%. Dy bankat greke kishin 9%, pra është thjesht një zhvendosje. Në të kundërt, depozitat regjistruan -13%, prej të cilës rreth 9% është ndikimi i dy bankave greke.

Ju mund të arrini pak a shumë në të njëjtin përfundim për bankat me kapital joevropian dhe për bankat shqiptare, duke pasur parasysh se, sipas vlerësimit tonë, ndarja e përmendur e operacioneve të Kosovës, përbën 3.5% të totalit të aktiveve, rreth 5% të totalit të kredive dhe 3.5% të totalit të depozitave.

Të gjitha këto shifra duhet të merren parasysh, dhe sipas mendimit tim, në qoftë se normalizojmë të dhënat, mund të shohim se dinamikat në sistemin bankar shqiptar janë shumë më interesante krahasuar me ato çfarë duken. Pra rritja është më dinamike, por për rrethana të ndryshme duket se jemi të ngadaltë në zhvillim. Dhe një

herë, vetëm kur të publikohen shifrat përfundimtare të vitit 2019, do të kemi mendime përfundimtare.

Le të shohim disa përfundime të përgjithshme dhe të parashikojmë sfidat kryesore me të cilat duhet të përballemi në të ardhmen e afërt.

- shpërndarja demografike, madhësia e ekonomisë, si dhe skenari makroekonomik mund të kufizojnë arritjen e ekonomive të rëndësishme të shkallës;
- revolucioni digjital dhe kuadrot rregullatore do të sjellin kosto shtesë për të gjitha bankat, pavarësisht origjinës së kapitalit;
- në këtë këndvështrim, të gjitha bankat, por veçanërisht ato vendase, duhet të ndjekin një cilësi më të lartë të aktiveve dhe të përmirësojnë kuadrin e administrimit të rrezikut me qëllim që të ruajnë nivele të përshtatshme të fitimit;
- madhësia e portofolit të kredive dhe niveli i tij i përqendrimit së bashku me strukturën aktuale të F/H (marzhi operacional i të cilave varet në mënyrë të konsiderueshme nga marzhi i interesave) kërkojnë lëvizje me qëllim që të shmangen ndikimet negative në rast të rënies së ekonomisë;
- portofolat e kredive sot janë më të shëndetshëm, por duhet të kemi parasysh se, që të përballemi me kosto shtesë rregullative dhe teknologjike, kostoja e rrezikut duhet mbajtur nën kontroll shumë të rreptë;
- duket se arsyet kryesore që sollën konsolidimin në sistemin bankar ishin shpërndarja demografike, kostot shtesë të pritshme të përmendura dhe revolucioni i vazhdueshëm digjital;
- bankat që lanë vendin ishin ato dy greke dhe bankat e vogla;

- nuk ndodhi ndarje midis bankave të mëdha, me qëllim që të krijohet një kampion i vërtetë, ishte thjesht nga niveli i ulët që ne pamë lëvizje;
- ende në skenarin aktual, bankat evropiane kryesojnë tregun, duke mbajtur, në përgjithësi një peshë të qëndrueshme në treg;
- bankat vendase kanë fituar peshë në treg dhe shfaqin zhvillim më të shpejtë krahasuar me të tjerat.

Prezantimi im, qëllimisht, nuk mori në konsideratë një tjetër dimension mjaft të rëndësishëm: fitimin e sistemit bankar. Me lejoni të bëj disa komente dhe të jap disa mendime.

Dëshiroj të theksoj se pesha e tregut nuk do të thotë domosdoshmërisht fitim, por nuk ka dyshim se bankat me fitim më të lartë janë ato evropiane dhe joevropiane, ndërsa ato vendase kanë mangësi nga ky këndvështrim. Kjo e ka një kuptim.

Duket qartë se bankat vendase po ndjekin një rritje në peshën e tregut dhe po tregojnë, në përgjithësi, oreks më të lartë për rrezik. Ish-ministri i Financave dhe Ekonomisë, këtë mëngjes, tha se bankat vendase japin më shumë kredi. Po, kjo është e vërtetë. Ato dëshirojnë të rriten, dhe për më tepër, ndonjëherë veprojnë duke ndjekur politika të ndryshme. Ju lutem, kini parasysh se bankat evropiane, kanë nivel më të ulët fleksibiliteti: ato janë të detyruara të dyfishojnë rregulloret, janë objekt i modeleve më të sofistikuara dhe më të zhvilluara të administrimit të rrezikut, i kërkesave shtesë në lidhje me raportimin, kërkesat e sistemeve, si dhe standardet e ndryshme.

Është një përqasje e ndryshme që, nën dritën e integrimit evropian, së shpejti dhe bankave vendase do t'u duhet të familjarizohen me të. Duket se ato ende nuk kanë arritur kohën kur do të fillojnë t'i ndiejnë këto kufizime shtesë.



Pra, çfarë mund të presim në fund?

Sipas mendimit tim, procesi i konsolidimit jo domosdoshmërisht duhet të konsiderohet i mbyllur. Ne mund të presim dhe disa zhvillime të tjera për shkak të nevojës për të ndryshuar modelin e veprimtarisë së industrisë. Revolucioni digjital do t'i ndryshojë rregullat e lojës, duke nënkuptuar investime të mëdha dhe bashkëveprim me FinTech. Këto bashkëveprime mund të arrihen në nivel shqiptar.

Për më tepër, balancimi i rreziqeve dhe mundësive, duke ditur dhe aftësinë e kufizuar të një banke të vetme shqiptare për të përballuar hua më të mëdha, ne mund të presim një rritje të mëtejshme në konkurrencën ekzistuese në tregun me pakicë.

Një nga rreziqet e poshtme të sistemit është një treg me norma tejet të ulëta interesi, që së bashku me ngadalësimin e dukshëm në ekonominë evropiane, e bën aktivitetin tonë edhe më të vështirë dhe le të shpresojmë që skenari makroekonomik nuk do të përkeqësohet më tej. Lajmi i mirë është se, ashtu siç e thashë në fillim, janë bërë përpjekje të mëdha, dhe rezultate mjaft të mira janë arritur nga sistemi bankar shqiptar në vitet e fundit. Kjo do të thotë se në rast rënieje materiale në mjedisin ekonomik, sistemi mund të konsiderohet mjaft i qëndrueshëm. Nga këndvështrimi i raporteve të mjaftueshmërisë së

likuiditetit dhe të kapitalit ne jemi në një pozicion shumë më të mirë se dy vite më parë, duke qenë këto parakushte për të përballuar një rënie të mundshme në cikël.

Le të shpresojmë se të gjitha zjarret rreth nesh do të shuhen, se Kina dhe SHBA-të do t'i zgjidhin mosmarrëveshjet e tyre, dhe se Brexit do të ndodhë qetë. Le të shpresojmë më të mirën për çdo gjë, por edhe nëse ndodh diçka negative jam mjaft i bindur se sistemi bankar shqiptar i ka të gjitha mjetet për ta përballuar.

Faleminderit shumë për vëmendjen tuaj!

SESIONI I DYTË:

SFIDAT DHE IMPLIKIMET E POLITIKAVE

Ky panel hulumton se si bankat në EJL dhe në veçanti në Shqipëri përballen me sfidat e reja që lindin si nga rregullatorët ashtu edhe nga subjektet financiare jobankare. Sesioni gjithashtu analizon sfidat e reja që këto tendenca paraqesin për autoritetet jo vetëm në drejtim të rregullimit dhe mbikëqyrjes, por edhe në drejtim të zbatimit të politikave, përfshirë efektivitetin e kanalit të transmisionit monetar dhe efikasitetin e përgjithshëm të pjesëmarrësve të tregut.

Seanca adreson pyetjet e mëposhtme:

- *Si e ndryshojnë tendencat e vazhdueshme modelin e biznesit të bankave dhe si duhet ato t'i përfshijnë / afrojnë tendencat inovative me produktet financiare dhe teknologjinë?*
- *Si mund të shfrytëzohet ndryshimi teknologjik në bankë dhe në financë për rritje dhe stabilitet financiar?*
- *A duhet që politikëbërësit të inkurajojnë financimin e institucioneve jobankare për të mbushur boshllëkun që po krijon largimi i mundshëm i grupeve bankare evropiane? Sipas mendimit tuaj, deri në çfarë mase mund të ketë rol FinTech në financimin e ardhshëm në këtë rajon?*
- *Cilat janë implikimet dhe opsionet e politikave për bankierët qendrorë, politikëbërësit dhe komunitetin bankar?*

Moderatore: Luljeta MINXHOZI, Zëvendësguvernatore e Parë, Banka e Shqipërisë

NJË MJEDIS NË NDRYSHIM – IMPLIKIMET PËR EKONOMITË TONA DHE SISTEMIN FINANCIAR

*Marianne NESSÉN**

Shumë faleminderit për ftesën për të marrë pjesë në këtë konferencë të nderuar! Faleminderit Guvernatorit të Bankës së Shqipërisë! Faleminderit Piroska dhe Erik për ftesën!

Jam shumë mirënhohëse që ndodhem sot këtu dhe marr pjesë në këtë diskutim shumë të rëndësishëm.

Unë jam makroekonomiste. Kur pashë sloganin "Një botë e re e guximshme", mendova: "Çfarë mund të thotë për këtë një ekonomist? Cilat janë tendencat sot?"

Dhe përgjigjet që do të jap sot, ju të gjithë i keni dëgjuar më parë. Por do t'i analizoj përsëri ato, pasi në ekonominë globale botërore po ndodhin ndryshime të thella. Ndryshime të thella po ndodhin prej një kohe tashmë të gjatë, por a do të vazhdojnë në të ardhmen e parashikueshme? Ndoshta për aq kohë sa do të jetojmë ato do të ndikojnë veprimtaritë tona të përditshme, në veçanti industrinë financiare dhe bankat.

Do të flas për mjedisin me norma të ulëta interesi, se çfarë do të thotë. Do të flas pak për teknologjitë e reja transformuese, ndonëse

* *Marianne NESSÉN, Këshilltare e Lartë e Bordit Ekzekutiv, Sveriges Riksbank.*

nuk është fushë ku unë jam eksperte, por do të flas pak dhe për to, dhe më pas, pjesën tjetër të diskutimit do e lë për bashkëpanelistët e këtij sesioni. Do të flas pak më shumë për rreziqet që vijnë nga ndryshimi i klimës dhe se çfarë po ndodh në sektorin financiar të mjedisit ndërkombëtar.

1. Le të fillojmë më normat e ulëta të interesit. Të shohim këtë grafik.



Të gjithë e kemi parë më parë. Këto janë normat e interesit (*yield*) për obligacionet 10-vjeçare në SHBA, Gjermani dhe Suedi. Ky është

një grafik i jashtëzakonshëm dhe i shkëlqyer. Kështu, për 25 vitet e kaluara, kemi pasur një tendencë rënëse në normat nominale të interesit. Kriza financiare globale dha këtë tendencë rënëse dhe rriti gjallërimin e tij. Kohët e fundit, këto norma interesi afatgjata me të vërtetë janë kthyer negative në Evropë, por jo në ShBA. Kjo ka çuar në një diskutim të madh, norma interesi negative.

Le të shohim normat reale të interesit. Të gjithë e dimë se normat reale negative të interesit nuk janë një gjë e re. Grafiku i mëposhtëm tregon normat e interesit në ShBA, Gjermani, Suedi dhe MB që në vitet '60.

Shumë prej nesh i mbajnë mend vitet '70. Nuk e di nëse e kujtoni që normat reale të interesit ishin negative. Mbajmë mend inflacionin e lartë. Në atë kohë normat reale të interesit ishin negative ose shumë të ulëta, por maskoheshin nga inflacioni i lartë. Kështu që, në terma nominalë, normat e interesit ishin pozitive. Përse kanë rënë normat reale të interesit? Ekziston një literaturë e gjerë për këtë, ndërkohë që shumë ekonomistë të shquar po e studiojnë këtë çështje.

Shpjegimet e zakonshme paraqesin si arsye shpërndarjen gjeografike, popullsitë në plakje të cilët kursejnë më shumë dhe si rrjedhim normat e interesit bien. Ka të bëjë me produktivitetin, i cili është bërë më i ngadaltë në vitet 2000, sesa më parë. Gjithashtu, ka një kërkesë për aktive të sigurta, të cilat ulin normat e interesit, veçanërisht në ShBA dhe Evropë. Këtu, dua të vë në dukje se këto shpjegime, përtej normave reale të ulëta të interesit dhe normave reale negative të interesit, janë faktorë me ndikim ngadalësues. Pra, me shumë gjasë, ne do të kemi këto norma të ulëta interesi për shumë vite të tjera. Pra, ne kemi norma reale të ulëta, kemi norma nominale të ulëta dhe madje kemi norma nominale negative.

Një mënyrë tjetër për të analizuar normat e interesit është ajo e analizës së kurbës së normës së interesit të përfituar (*yield*). Tri vijat tregojnë kurbën e normave të interesit të përfituar (*yield*) për obligacionet gjermane në tri raste të ndara. Kështu në vitin 2013, lart, 2018 në mes, dhe vetëm një javë më parë (tetor 2019) poshtë.



Nga grafiku lexohet se se ato kanë rënë, por gjithashtu shikoni dhe ato më të fundit, e tërë kurba e normës së interesit (*yield*) është poshtë zeros. Kështu, ky mjedis i normave të interesit krijon sfida për bankat – kjo është përmendur dhe sot. Kështu që ka shumë gjëra të ndryshme: niveli; normat negative, por edhe forma e kurbës së normës së interesit të përfituar (*yield*). Ajo çfarë shumë njerëz thonë sot, është se kjo situatë nuk do të ndryshojë për një periudhë të gjatë kohore.

Pra, është një mjedis shumë sfidues për bankat, dhe unë vij nga një vend, Suedia, ku kemi pasur një politikë me norma negative që prej vitit 2015. Ka pasur shumë debat publik për këtë gjë, dhe madje mund të thuhet se njerëzit nuk janë të kënaqur me normat negative të interesit, në veçanti, jo në sektorin financiar. Është pretenduar se kjo do të dëmtonte fitimin e bankës. Mund të argumentoj se kjo nuk mund të ndodhë në rastin e Suedisë. Bankat suedeze kanë qenë të afta ta përballojnë shumë mirë këtë situatë.



Mësimi që nxjerrim në këtë rast është se: në këtë lloj mjedisi, do të jetë edhe më e rëndësishme për bankat që të jenë me kosto efektive dhe të ulin kostot sa më shumë që të jetë e mundur. Dua ta ilustroj këtë që thashë. Grafiku i mëposhtëm tregon raportin e kostove ndaj të ardhurave për tri grupe bankash, pjesërisht të mbivendosura.

Të parat janë bankat suedeze – vija e poshtme, më pas nëse i shtoni dy banka atij grupi atëherë do të kemi atë që ne e quajmë banka të mëdha në Suedi. Dhe vija e sipërme janë bankat e tjera evropiane. Ka një kontrast midis raportit kosto/të ardhura në bankat suedeze dhe 15 bankave të mëdha në Evropë. Një ilustrim i rëndësishëm për bankat që të ruajnë kostot e tyre, të cilat vijnë në rritje. Këtu duket se ka hapësirë për praktika më efektive. Pra, ka sfida që vijnë nga një mjedis me norma të ulëta interesi.

2. Çështja tjetër që do të trajtoj janë ndryshimet transformuese teknologjike. Siç edhe e thashë, unë jam makroekonomiste. Nuk mund të bëj drejtësi për këtë çështje të rëndësishme. Por, po përdor këtë skemë si një lloj njoftimi për një artikull që u botua dje në Revistën Ekonomike të Bankës Qendrore të Suedisë.

Është një artikull për kredinë Fintech: platformat krediduese online në Suedi dhe më tej, shkruar nga dy ekonomistët tanë. Ata analizojnë platformat online të kredidhënies. Këto platforma janë përdorur më së shumti në MB, SHBA dhe në Kinë. Ato janë rritur dhe zhvilluar në këto vende, por po rriten edhe në Suedi. Autorët kryejnë një

vrojtim të këtyre tregjeve të ndryshme, dhe përpiqen të shpjegojnë se çfarë po ndodh. Kështu ky grafik i ndërlikuar i marrë nga artikulli është ilustrim i inovacioneve më të fundit teknologjike në fushën e platformave online të kreditimit. Ky ishte vetëm një shembull. Unë vij nga një vend ku mund të bësh pagesa të menjëhershme me anë të një pajisjeje që quhet "Swish". Besoj se "Swish" përdoret gjerësisht, dhe sot është gjithashtu dhe folje në gjuhën suedeze. Ne e quajmë "Swishah". Pra këto janë ndryshme teknologjike transformuese. Një fushë tjetër është paraja digjitale. Nuk do të flas shumë për të.

3. Kjo më sjell në çështjen e fundit e cila është "ndryshimi i klimës dhe ndikimi i saj në sektorin financiar".

Për një pjesë të industrisë financiare, ndryshimi i klimës ka qenë veprimtari e përditshme për dekada, për shembull në industrinë e sigurimeve. Ata u janë përshtatur rreziqeve të rritura të klimës për shumë vite. E reja është se rreziku i klimës po merr vëmendje edhe në fusha të tjera. Dua të shpjegoj se çfarë është NGSF. NGFS-ja është "Rrjeti për të bërë Sistemin Financiar të Gjelbër *(anglisht. "Network for Greening the Financial System")*. Ky rrjet është një grup bankierësh dhe mbikëqyrësish të bankave qendrore. Është një organ ndërkombëtar, një koalicion vullneti. Nuk është një organ që vendos standarde. Por është një grup bankash qendrore dhe autoritetesh mbikëqyrëse, të cilët janë bashkuar me qëllim që të nxisin një sistem financiar më të gjelbër. Është themeluar vetëm 18 muaj më parë, dhe po rritet nga dita në ditë. Sot, në përbërje të këtij rrjeti janë rreth 50 banka qendrore dhe autoritete mbikëqyrëse. Ka

një numër organizatash që janë vëzhguese në këtë rrjet si: FMN-ja, BIS-i, OECD-ja.

Përse u krijua ky organ?



Pika e parë me të zezë ka të bëjë me urgjencën e kësaj çështjeje dhe kompleksitetin e problemit me të cilin po përballemi: ndryshimi i klimës dhe rreziqet që sjell.

Dua të tërheq vëmendjen tuaj tek pika e dytë. Është një fjali shumë e shkurtër, por që i thotë të gjitha. Rreziqet e lidhura me klimën janë burim i rrezikut financiar. Pra është brenda mandatit të bankave qendrore dhe mbikëqyrësve që të sigurojnë se sistemi financiar është rezistent ndaj këtyre rreziqeve.

Kjo është arsyeja se përse shumë banka qendrore në botë kanë filluar të rishikojnë vlerësimin e stabilitetit financiar dhe të analizojnë efektin e rreziqeve të klimës në sektorin financiar. Në rreziqet e ardhshme klimatike, skenarët e klimës do të bëhen pjesë e ushtrimeve të stresit që bankat qendrore dhe autoritetet mbikëqyrëse kryejnë kur analizojnë bankat.

Pika e fundit këtu është: rreziqet e larta të lidhura me klimën nuk janë reflketuar si duhet në vlerësimet e aktiveve. Kjo pikë me të vërtetë i ka bërë rregullatorët dhe bankat qendrore që të punojnë në këtë drejtim. Një shembull padyshim janë aktivet standarde, lloje të ndryshme të aktiveve standarde.

Do ta mbyll me një skemë të fundit, e cila ka të bëjë me NGFS-në: "Rrjeti për të bërë Sistemin Financiar të Gjelbër".

Është një koalicion vullneti, pra nuk është një organ që përcakton standarde. Rrjeti miratoi gjashtë rekomandime, që NGFS-ja i publikoi në vitin 2018. Një tërësi rekomandimesh, ku në krye është "Bankat qendrore duhet të integrojnë rreziqet që lidhen me klimën në monitorimin e stabilitetit financiar dhe në mbikëqyrjen makro". Pjesa tjetër e këtyre hapësirave me ngjyrë blu kanë të bëjnë me atë që të jemi të sigurt se kjo do të ndodhë: ne kemi nevojë për të dhëna. Ne kemi nevojë për metoda". Gjithashtu ka një sugjerim, hapësira e dytë me ngjyrë blu: "Nëse përputhen me mandatet e tyre që faktorët mbështetës duhet të ndërfuten në administrimin e portofolave të bankave qendrore". Gjithashtu ka dhe rekomandime të tjera.

Për të përfunduar, ndryshime strukturore të thella dhe të vazhdueshme që ndikojnë politikëbërësit, që ndikojnë bankat, patjetër që ndikojnë dhe publikun në shkallë të gjerë. Ato janë sfida të mëdha, por njëkohësisht dhe mundësi të mëdha.

Faleminderit!

POLITIKA MAKROPRUDENCIALE DHE BASHKËPUNIMI NDËRKOMBËTAR: ZHVILLIMET MË TË REJA

*Michael WUERZ**

Ju falënderoj shumë për prezantimin e këndshëm që më bëtë! Ju falënderoj shumë për ftesën në Bankën e Shqipërisë dhe gjithashtu faleminderit Piroshka Nagy-Mohacsi! E njohim njëri-tjetrin nga krizat financiare globale dhe angazhimi për të arritur një kuadër të mirë shumëpalësh të menaxhimit të krizave në rajonin e EQLJZ-së. Nisma e Vjenës e themeluar në vitin 2008 mund të them se ishte me të vërtetë një nismë evropiane e mirë në këtë fushë. Herën e fundit që isha në Tiranë, ishim pjesë e një mjedisi makroekonomik dhe politik të ndryshëm nga ky i sotmi. Më kujtohet mjaft mirë se ishim në fazat e fundit të moderimit të madh, rritjes së lartë ekonomike, inflacionit të moderuar dhe pritjeve optimiste për të ardhmen.

Pas krizave globale financiare dhe recesionit të madh në 2008/2009, Evropa dhe Bashkimi Evropian kanë nxjerrë mësime të rëndësishme në lidhje me ruajtjen e stabilitetit financiar. Kemi arritur me të vërtetë shumë zhvillime pozitive, si krijimi i Unionit Bankar, por jo vetëm, edhe në fusha të tjera. Për këtë arsye, konferenca po zhvillohet në momentin e duhur për të diskutuar sfidat në fushën e bankingut në rajonin me rëndësi të madhe, ai i Evropës në zhvillim. Titulli i kësaj konference "Një botë e re e guximshme", më kujton pak Huxley-n, i cili më 1932 botoi romanin e tij të famshëm "Bota e Re e Guximshme".

* *Michael WUERZ, Drejtor i Departamentit të Stabilitetit Financiar dhe Mbikëqyrjes Makroprudenciale, Banka Kombëtare e Austrisë.*

Nën supozimet dhe rrethanat e tij specifike, ai përshkroi një shoqëri të nënshtruar në vitin 2540, e cila jetonte vetëm formalisht nën stabilitet, paqe dhe liri. Shoqëria ishte nën një lloj diktature dhe konsiderohej si Bota e re e Guximshme. Ndryshe nga tani, ne do të punojmë së bashku për të themeluar një sistem financiar të qëndrueshëm dhe të shëndoshë, i cili garanton demokraci dhe natyrisht lirinë individuale.

Në Bankën Kombëtare të Austrisë jam Përgjegjës i Sektorit të Stabilitetit Financiar dhe Mbikëqyrjes Makroprudenciale dhe qëllimi ynë kryesor është të kontribuojmë për stabilitetin financiar jo vetëm në vendin tonë, por edhe në stabilitetin financiar në të ashtuquajturat vende pritëse të bankave austriake. Gjithashtu, nisur nga fryma e Nismës së Vjenës, ku Shqipëria është anëtare aktive, ruajtja e stabilitetit financiar është me të vërtetë në interes të përbashkët si të vendit të origjinës, ashtu edhe të vendeve pritëse, pasi në një botë të bankingut ndërkufitar, rreziqet nuk kufizohen nga kufijtë kombëtarë. Kjo është një nga mësimet kryesore që kemi përftuar nga kriza globale financiare. Së pari, rreziqet e përhapjes mund të ilustrohen mjaft lehtë: Për shembull, ekspozimi i bankave të BE-15 ndaj EQLJZ-së arriti në gati 1000 miliardë euro, me gati një të katërtën e të gjitha pretendimeve nga bankat austriake. Ne gjithashtu shohim që shumë banka evropiane nga vende të ndryshme kanë investuar me një qëllim afatgjatë në këtë rajon dhe ato mbetën të përkushtuara ndaj këtij rajoni dhe përfituan nga ambienti pozitiv i vitit të kaluar.

Së dyti, grafiku në anën e djathtë paraqet një tregues tjetër për rrezikun e përhapjes, përkatësisht pronësinë e aktiveve të sektorit bankar në vendet e përzgjedhura në EQLJZ.



Statistikat bazohen në të dhënat e SNL-së. Pronësia e huaj në shumicën e vendeve të EQLJL-së është më e lartë se 50%. Ajo që është e rëndësishme nuk është vetëm pesha, por edhe përbërja e pronësisë së huaj. Në grafikun e anës së djathtë, shohim se pronësia e bankave nga Turqia dhe Rusia është në masë të konsiderueshme në të paktën disa vende të EQLJL-së, krahasuar gjithashtu me pronësinë nga euro zona. Kjo ka pasoja të qenësishme për bashkëpunimin shumëpalësh.

Siç është përmendur dhe më parë dhe siç u fol dhe sot, ekziston nevoja për bashkëpunim shumëpalësh me vendet joanëtare në BE. Ndonjëherë kjo kërkon kohë për t'u zbatuar dhe për t'i konsideruar seriozisht të gjitha çështjet. Mendoj se është një proces shumë i rëndësishëm.

Më kujtohet mirë kur 10-15 vite më parë, diskutuam raportin tonë të stabilitetit financiar në bankën qendrore dhe vumë re disa zhvillime në EQLJL. Atë periudhë e vetmja gjë që mund të bënim ishte t'i këshillonim bankat e interesuara dhe t'u shprehnim shqetësimet tona, pasi gjatë asaj kohe na mungonin instrumentet ligjore makroprudenciale për të adresuar rreziqet sistematike.

Tashmë me kuadrin aktual ligjor makroprudencial të BE-së, të ashtuquajturin Bordi Evropian i Rrezikut Sistemik (ESRB) dhe ekzistencën e mandateve kombëtare për mbikëqyrjen makroprudenciale, situata ka ndryshuar. Qëllimi natyrisht nuk është mbingarkimi i sektorit bankar, por qëllimi është forcimi i stabilitetit financiar në vendin e origjinës, por edhe në vendet pritëse. Kjo gjë tregon se ka hapësirë për përmirësim sa i përket bashkëpunimit ndërkombëtar (dypalësh dhe shumëpalësh) edhe në fushën e politikës

makroprudenciale, në veçanti me vendet joanëtare në BE, pasi siç e dini BQE-ja është shumë aktive në BE. Sigurisht, Nisma e Vjenës është një prej këtyre forumeve. Ju keni informacion të dorës së parë nga vendet joanëtare të BE-së dhe e keni përqendruar informacionin mbi zhvillimet dhe aktivitetet në rajon.



Personalisht mendoj se dhe në fushën e stabilitetit financiar dhe të politikës makroprudenciale do të ketë hapësira për përmirësime. Për shembull, në departamentin tim në Bankën Kombëtare të Austrisë, synojmë që në të ardhmen të kemi dialog dypalësh me vendet pritëse që të mund të diskutojmë masat tona dhe ndikimin për shembull të politikës makroprudenciale.

BQE-ja ka të drejtë të marrë masa të tjera shtesë (më të shtrënguara), por përgjegjësia kryesore për stabilitetin financiar (përfshirë fushën e politikës makroprudenciale) ngelet në duart e shteteve anëtare. Pse e theksoj kaq shumë këtë çështje? Aktivitetet mbikëqyrëse makroprudenciale të zhvilluara nga OeNB në bashkëpunim me Autoritetin Austriak të Tregut Financiar (FMA), dhe Bordin e Stabilitetit të Tregut Financiar Austriak (FMSB), përfshirë përfaqësues nga Ministria Federale e Financave, kanë zbutur rreziqet sistemike në Austri. Mbizotërimi i kredive në valutë kërkonte vëmendje të veçantë. Ju e dini, bankat austriake ishin ofruesit e kredive në valutë dhe ne nuk duhet të jemi shumë krenarë për këtë produkt, sepse është e qartë se ky është një produkt i cili kontribuon në paqëndrueshmëri financiare dhe mund të krijojë probleme, veçanërisht në situata krizash. Autoritetet austriake vendosën të ndalojnë plotësisht dhënien e huave në valutë për huamarrësit e pambrojtur në Austri.

Në vazhdën e krizës së vitit 2008 kemi pasur diskutime intensive me grupet e interesit, sepse natyrisht, ata e konsideruan atë si një produkt "super". Gjithashtu, kolegët e mi nga Raiffeisen Bank do të pajtohen me mua, pasi unë mendoj se ishte një vendim me të vërtetë i mirë ndalimi i saj, dhe heqja dorë nga dhënia e kredive në valutë në vendet e EQLJL-së, duke përjashtuar dhënien e kredive në monedhën euro. Teprica e vëllimeve u zvogëlua ndjeshëm nga bankat. Do ta rekomandoja me të vërtetë kufizimin/ndalimin e kredive në valutë për huamarrësit e pambrojtur. E di se situata në Shqipëri është e favorshme në këtë drejtim. Masa e dytë e rëndësishme ishte një rekomandim në fushën e qëndrueshmërisë së modeleve të biznesit të vendeve të EQLJL-së të filialeve të bankave austriake. Qëllimi nuk ishte zvogëlimi i ofertës për kredi, por synohej një financim më lokal, i qëndrueshëm dhe afatgjatë i filialeve të bankave austriake. Banka qendrore e Austrisë dhe FMA-ja kanë kërkuar në mënyrë aktive dialogun me Komisionin Evropian, bankat qendrore dhe autoritetet mbikëqyrëse në vendet e EQLJL-së për shembull gjatë zhvillimit të së ashtuquajturës paketë të qëndrueshmërisë. Përmes komunikimit aktiv, ne mund të adresojmë shqetësimet e disa autoriteteve se kredia për kërkesë të qëndrueshme të fondeve lokale për filialet austriake në EQLJL mund të ketë efekte prociklike mbi ofertën e kredisë, duke çuar në një krizë kredie ose shlyerje. Rezultatet e monitorimit tregojnë se nuk ka efekte negative mbi ofertën e kredisë në vendet e EQLJL-së. Sigurisht, kapitalizimi është shtylla e dytë më e rëndësishme e paketës. Momentalisht, ne po adresojmë qëndrueshmërinë e standardeve të huadhënies për pasuritë e paluajtshme në Austri.

Ekziston një mirëkuptim midis agjencive ndërkombëtare të vlerësimit (p.sh. Moody's) se masat makroprudenciale të marra kanë kontribuar në forcimin e sektorit bankar në Austri dhe në vendet e EQLJL-së.

Duke qenë mbikëqyrës, natyrisht, prirem të shoh më tepër rreziqe nga sa mund të shohin bankat, por së bashku mendoj se mundëm të kontribuonim në stabilitetin financiar, jo vetëm në vendin e origjinës, por edhe në vendet pritëse, duke pasur parasysh sistemin bankar evropian. Tashmë bankat në vendin e origjinës janë më mirë të kapitalizuara dhe më të forta, por e njëjta gjë vlen dhe për bankat në vendet pritëse. Si pasojë, sistemet bankare priren të jenë më efektive dhe më efikase.

Për ta përmbledhur fjalën time, së pari, stabiliteti financiar është me të vërtetë një interes i përbashkët i vendit të origjinës dhe vendeve pritëse. Së dyti, e gjithë çështja e politikës makroprudenciale ia vlen vërtet dhe ka nevojë për përmirësim sa i përket bashkëpunimit, si atij dypalësh edhe atij shumëpalësh. Dhe bashkëpunimi i ngushtë në kohë të këqija duhet të bazohet vërtet në bashkëpunim të ngushtë në kohë më të të mira.

Shumë faleminderit!

MIQËSI ME PËRFITIME NË EPOKËN MODERNE TË BANKAVE: SFIDAT, RREZIQET DHE IMPLIKIMET E POLITIKËS

*Ioannis ASIMAKOPOULOS**

Është një kënaqësi e madhe për mua të jem sot këtu dhe falënderoj Bankën e Shqipërisë dhe Shkollën Ekonomike dhe Shkencave Politike të Londrës (LSE) për organizimin e kësaj konference. Në prezantimin tim, dëshiroj të ndaj disa mendime mbi ndërlidhjen midis bankave, ndërmjetësuesve financiarë jobanka dhe kompanive FinTech, duke vlerësuar rreziqet dhe përfitimet që mund të ketë ky ndërveprim, dhe duke ofruar një drejtim të politikave nga një këndvështrim i një banke qendrore.

Kjo dekadë që në vigjilje të krizës, ka shkaktuar ndryshime strukturore të rëndësishme në banka dhe në përgjithësi në sektorin financiar. Bankat kanë rivlerësuar modelet e tyre të veprimtarisë (domethënë strukturën e bilancit, kostot, qëllimin e aktiviteteve, praktikat e administrimit të rrezikut, praninë gjeografike); financimi i borxhit të korporatave është zhvendosur tek tregjet e kapitalit, ndërsa aktivet globale të sigurimit, fondet e pensionit dhe ndërmjetësuesit e tjerë financiarë janë rritur relativisht fuqishëm. Për më tepër, progresi i shpejtë në teknologji ka mbështetur një digjitalizim më të thellë të shërbimeve bankare duke iu ofruar bankave një mundësi për të përmirësuar përvojën e tyre me klientët. Nga ana tjetër, inovacioni

* *Ioannis ASIMAKOPOULOS, Ekonomist i Lartë, Drejtor i bankingut dhe Tregjeve të Kapitalit, Departamenti i Kërkimeve, Banka e Greqisë.*

teknologjik në shërbimet financiare dhe adoptimi i tij nga kompanitë FinTech përbën një kërcënim konkurrues për disa banka.

Para se të diskutojmë tendencat e reja, më lejoni të bëj disa komente të shkurtra për gjendjen aktuale të sistemit bankar evropian, meqenëse zhvillimet në rajonin tonë nuk janë të izoluara nga tendencat e përgjithshme evropiane. Mesatarisht, bankat evropiane tregojnë një përmirësim të dukshëm për sa i përket qëndrueshmërisë (raporte të forta të kapitalit dhe përmirësim të cilësisë së aktiveve), por fitim të dobët.

Raportet e kapitalit, mesatarisht, mbeten mjaft nën minimumin rregullator, ndërsa lidhur me cilësinë e aktiveve, raporti i kredive me probleme mbetet në një tendencë rënëse prej shumë vitesh, duke qëndruar poshtë 3%, megjithëse ende kemi raste të vendeve ku raporti është dyshifror. Në vlera absolute, kreditë me probleme në tregun evropian, bazuar në të dhënat e Autoritetit Bankar Evropian (EBA), janë rreth 660 miliardë euro.

Fitimi mbetet i kontrolluar për bankat evropiane. Është e dukshme që në shumë raste kthimi nga kapitali (RoE) është nën koston e kapitalit. Në vitin 2018, një e treta e sektorit bankar në Eurozonë, kishte një kthim nga kapitali (RoE) nën 5%, dhe 90% e bankave kishin një RoE poshtë vlerës 10%. Dhe kjo ka ndodhur pavarësisht mjedisit ekonomik pozitiv në të cilin veprojnë prej shumë vitesh tashmë bankat evropiane.



Bankat shqiptare, në bazë të informacioneve që kemi dëgjuar nga folës të tjerë sot, shfaqen mjaft mirë në krahasim me bankat evropiane për sa i përket raportit të mjaftueshmërisë së kapitalit dhe përfitimit. Më shumë punë nevojitet për kreditë me probleme, por reduktimi i tyre i arritur deri më sot është i konsiderueshëm.

Atëherë shtrohet pyetja, se përse bankat evropiane po përpiqen të përmirësojnë përfitimin? Një sërë arsyesh tashmë janë ngritur, sidomos ndikimi nga një mjedis me norma të ulëta interesi dhe problemet me koston efektive, pavarësisht progresit të rëndësishëm gjatë viteve të fundit (domethënë ulja e numrit të degëve, personelit dhe kostove të stafit).

Problemi me fitimin e ulët pasqyrohet në çmimin e tregut të kapitalit në bankat e BE-së. Çmimi i aksioneve të bankave evropiane nuk po mban të njëjtin ritëm me letrat e tjera me vlerë. Gjithashtu, edhe çmimi ndaj vlerave kontabël të bankave evropiane nuk është rikuperuar nga kriza globale.

Për sa i përket sektorit financiar jobankar, më mirë i njohur në të kaluarën si "bankingu hije", është kthyer në një aktor të rëndësishëm në treg, me një madhësi prej rreth 200 trilionë dollarësh. Sigurisht, rëndësia e financimit jobankar ndryshon sipas juridiksioneve dhe varet nga shkalla e zhvillimit financiar në vende të ndryshme. Ajo ka tendencë të jetë më e rëndësishme në vendet ku zhvillimi financiar është më i përparuar, megjithatë shohim raste që dhe në vende më të vogla, veprimtaria po rritet në mënyrë të konsiderueshme.

Në Evropë, sektori financiar jobankar ka rritur rëndësinë e tij në financimin e korporatave jofinanciare. Shifrat e fundit tregojnë se jobankat përbëjnë gati 30% të kredive të korporatave jofinanciare (NFC), një përqindje dy herë më e lartë krahasuar me 10 vite më parë.



Për më tepër, jobankat ofrojnë një financim të qëndrueshëm të flukseve neto për NFC-të nëpërmjet blerjes së letrave me vlerë të borxhit. 10 vite para krizës në Eurozonë, NFC-të merrnin vetëm 10% të kredisë së tyre, duke emetuar letra me vlerë të borxhit, sot kjo shifër është më shumë se 50%. Gjithashtu, në disa juridiksione, si në Holandë, sektori financiar jobankë është kthyer në një burim shumë të rëndësishëm financimi për individët.

Rritja e ndërmjetësimit financiar në dekadën e kaluar gjithashtu është ndikuar nga zhvillimet në teknologji, ku FinTech është lojtari i ri në fushë. Sipas një kërkimi të vogël dje në Google, duke përdorur termin FinTech më dha një rezultat prej 93 milionë gjetjesh.

Në fund të vitit 2018, investimi global në FinTech ishte rreth 112 miliardë dollarë krahasuar me vetëm 50 miliardë dollarë në vitin 2017. Kryesojnë Azia dhe Shtetet e Bashkuara, të ndjekura nga Britania e Bashkuar, ndërsa Evropa qëndron pas.

Në veprimtarinë e një FinTech të lidhur me industrinë bankare, kredia FinTech, shohim një kërkesë të rritur, pasi gjatë krizës, kredidhënësit tradicionalë u tërhoqën plotësisht nga segmentet e tregut, ose vendosën të mos iu shërbejnë segmenteve të caktuara të tregut, të tilla si kreditë për mikro biznesin. Në këto rrethana, kompanitë e kredisë FinTech gjetën mundësinë për ta kapërcyer. A do të thotë kjo që bankat duhet t'i frikësohen kredisë FinTech?

Është e sigurt që bankat dhe kompanitë e kredisë FinTech kanë një tërësi të ndryshme avantazhesh konkurruese dhe ndërveprimi i tyre ka përfitime dhe rreziqe. Për shembull, partneriteti i suksesshëm midis bankave dhe platformave FinTech mund të krijojë mundësi për të përmirësuar analizën e rrezikut, të ofrojë shërbim më të mirë për segmente të veçanta të tregut (domethënë segmente të vogla me kredi), ose të ndihmojë bankat të kapërcejnë disa nga sfidat aktuale në sistemet IT. Nga ana tjetër, ka zëra që paralajmërojnë për mundësinë e diskriminimit financiar në rritje, standarde më të dobëta të kredidhënies, rrezik kibernetik, ndikim në transmetimin e politikës monetare dhe probleme me mbrojtjen e klientit. Megjithatë, në përgjithësi, besoj se bankat dhe kompanitë e kredisë FinTech, ndonëse fillojnë nga një bazë e ndryshme, mund të gjejnë një rrugë për të bashkëpunuar, duke ofruar më shumë zgjedhje për klientët dhe duke përmirësuar efektivitetin e bankave.

Në një kontekst më të përgjithshëm, a është i dëmshëm ndërveprimi i bankave, jobankave dhe kompanive FinTech? Sipas këndvështrimit kinez për rrezikun, siç edhe mund të shihet në faqen e internetit të profesor Damodarans, rreziku përkthehet në kërcënim dhe mundësi. Një sistem financiar i balancuar me kanale të shumëfishta ndërmjetësimi financiar ka gjasë të ofrojë konkurrencë më të shëndetshme dhe rezistencë më të mirë ndaj goditjeve. Gjithashtu, ndërmjetësuesit jobankë mund ta përshtatin shërbimin e tyre me nevoja specifike. Për shembull, ato mund t'u shërbejnë klientëve që janë ose mjaft të vegjël për të qenë fitimprurës për bankat, ose të mëdhenj në madhësi, por pa pasur kolateral të mjaftueshëm për t'u shërbyer nga bankat. Nga këndvështrimi i kursimtarëve, instrumentet e investimeve kolektive, të tilla si fondet e përbashkëta ose fondet e pensionit, mund të ofrojnë një gamë të gjerë opsionesh me profile të ndryshme të kthimit të rrezikut.

Lidhja në rritje e ndërmjetësimit jobankë dhe adoptimi në rritje i teknologjisë mund të krijojë gjithsesi prekshmëri të reja potenciale. Në kërkim të *yield*-eve më të larta, jobankat kanë akumuluar më shumë rreziqe në portofolat e tyre të investimit. Për shembull, më shumë se gjysma e obligacioneve të mbajtura në fondet e investimit në Eurozonë janë me renditje të cilësisë të investimit BBB ose më ulët. Gjithashtu, ne nuk duhet të nënvlerësojmë faktin se jobankat mund të kontribuojnë gjithashtu në rrezikun sistemik nëpërmjet lidhjeve me sistemin bankar. Në përgjithësi, deri tani, asnjë rrezik ndaj stabilitetit financiar nuk vjen si rezultat e veprimtarive në sektorin financiar jobankë apo dhe i përvetësimit të teknologjisë. Megjithatë, siç shihet edhe në raste të tjera në të kaluarën, rreziqet mund të krijohen shumë shpejt. Si rrjedhim, ekosistemi bashkëkohor financiar ka nevojë për monitorim të kujdesshëm dhe inovacioni duhet të instrumentalizohet në një mjedis të kontrolluar. Në lidhje me këtë, kutia e rërës ose nyjet e inovacionit nëpërmjet të cilave autoritetet mund të lundrojnë në kompanitë FinTech mund të jenë të dobishme.

Për të ofruar një shembull, Banka e Greqisë ka prezantuar nyjën e saj të inovacionit FinTech nëpërmjet të cilës monitoron zhvillimin inovativ në sektorin financiar dhe ofron udhëzime jodetyruese për kompanitë.

Duke parë para, në një mjedis të tillë konkurrues dhe kërkues, bankat duhet të përshtasin modelet e tyre të veprimtarisë dhe autoritetet duhet të përvetësojnë politika që mund të ruajnë stabilitetin financiar. Për modelet e veprimtarisë së bankave, strategjia e preferuar do të varet nga pika e fillesës së secilës bankë dhe mjedisi ku vepron. Disa banka mund të nxiten të përqendrohen në segmentin e pagesave me vlerë të vogël; banka të tjera mund të përpiqen të trajtojnë presionet e fitimit duke investuar në teknologji me qëllim që të përmirësojnë efektivitetin e kostove. Nga një këndvështrim i stabilitetit financiar, një sfidë e rëndësishme është që të sigurohet se përshtatja e bankave me një mjedis të ri funksionues nuk shoqërohet me marrje të rrezikut të tepërt. Për shkak të sfidës së fitimit, bankat mund të tundohen të marrin përsipër rreziqe më të mëdha. Kjo thekson nevojën për monitorim nga afër të ndërveprimit midis ndryshimeve të modelit të veprimtarisë, marrjes së rrezikut nga banka dhe rrezikut sistemik.

Në përgjigjet e politikave ndaj rreziqeve që vijnë nga sektori financiar jobankë, autoritetet kompetente duhet të mbeten vigjilente dhe të vlerësojnë vazhdimisht se si goditjet që vijnë nga një pjesë e sistemit financiar mund të transmetohen te komponentë të tjerë. Në lidhje me këtë, sektori financiar jobankë ka nevojë të ketë standarde prudenciale të qëndrueshme. Gjithashtu, na duhet një shtrirje e

tërësisë së instrumenteve makroprudenciale (domethënë testim makroprudencial të stresit, apo zhvillimi i instrumenteve stres-test për jobankat) ndaj sektorit financiar jobankë me qëllim që t'u ofrohen autoriteteve mënyrat për të adresuar rreziqet në nivel sistemi.



Për sa i përket FinTech, rregullorja nuk duhet të jetë tejet e rreptë deri në pikën sa të parandalojë krijimin dhe zhvillimin e teknologjive të reja. Nga ana tjetër, do të ishte mjaft e dobët, për të qenë të sigurt se investitorët dhe përdoruesit janë të mbrojtur si duhet. Përveç rregullores, bankierët dhe në përgjithësi pjesëmarrësit e tregut nuk duhet të angazhohen në mënyra komplekse për të bërë gjëra, pasi shumë herë në të shkuarën kemi qenë dëshmitarë të burimeve të konsiderueshme të rrezikut nga veprime të tilla. Përveç kësaj, ne duhet të sigurojmë një nivel fushë-loje për bankat dhe kompanitë FinTech në mënyrë që bankat të mos jenë në një situatë dizavantazhi konkurrues. Sigurisht, dimensioni global i inovacionit teknologjik kërkon koordinim dhe bashkëpunim ndërkombëtar në fushat e mbikëqyrjes dhe rregullit.

Së fundi, ndryshimet në panoramën financiare duhen parë me kujdes, por gjithashtu dhe si mundësi për të përmirësuar mënyrat sipas të cilave ne kryejmë veprimtarinë tonë. Bankat duhet të vazhdojnë të ofrojnë shërbime të vlerave dhe cilësore për klientët e tyre, ndërsa mbikëqyrësit duhet të vazhdojnë të ruajnë stabilitetin financiar. Elementi thelbësor dhe më i rëndësishëm është se zhvillimi i burimeve alternative të financimit i mbështetur nga inovacioni teknologjik forcon konkurrencën e tregjeve financiare, ofron shërbime të cilat institucionet financiare tradicionale i kryejnë me më pak efektivitet

ose aspak, dhe zgjerojnë gamën e përdoruesve të këtyre shërbimeve. Kjo nuk nënkupton se bankat do të zëvendësohen në pjesën e tyre më të madhe të funksioneve. Konkurruesit bankarë do të gjejnë gjithmonë rrugë më efektive për të bërë gjëra, gjithsesi bankat që do t'u përshtaten ndryshimeve dhe do t'i bëjnë gjërat e vjetra në një mënyrë të re. Sektori bankar do të vazhdojë të luajë një rol thelbësor në ofrimin e shërbimeve të kredisë dhe të pagesave në ekonomi.

Bashkëpunimi dhe konkurrenca e shëndetshme e bankave me subjektet e tjera financiare do t'i shërbejnë përfshirjes financiare të popullatës dhe zhvillimit të ndërmjetësimit financiar. Kjo është veçanërisht e rëndësishme për Shqipërinë që regjistron një përqindje të lartë dyshifrore pa një llogari bankare dhe më pak efektive për ekonominë, tipin e flukseve hyrëse të dërgesave të emigrantëve.

Ndërmjetësimi financiar do të mbështetet gjithashtu, në qoftë se popullsia, veçanërisht ajo e moshës së re, edukohet më mirë, dhe mendoj se veçanërisht Banka e Shqipërisë po bën një punë të mirë në këtë drejtim.

Thënë këtë, më lejoni të përfundoj duke huazuar një shprehje të marrë nga një prej fjalëve të Zëvendëseguvernatores së Parë, profesor Minxhozi, e cila ka thënë: "Tepër i ri për të folur me lekë të vjetër". Kështu që, po ne kemi nevojë për edukim për të rinjtë dhe edukimi kontribuon pozitivisht në jetesën e shoqërive.

Faleminderit për kohën tuaj!

ROLI I FINANCËS JOBANKARE, HIGH-TECH DHE FIN-TECH NË BANKINGUN TREGTAR KONVENCIONAL

*Peter BOTOUCHAROV**

Mirëdita të gjithëve!

Faleminderit për ftesën. Para së gjithash, faleminderit Bankës së Shqipërisë, të gjithë kolegëve, Piroska-s, të cilët më ftuan në këtë aktivitet dhe jam shumë i lumtur që po flas para jush.

Kam qenë në Shqipëri vetëm një herë. Ishte viti 2012 dhe që atëherë ka pasur shumë ndryshime pozitive në ekonomi.

Në fakt, isha shumë i lumtur dje kur pashë që do të flisnim për rikonceptimin e përmasës, strukturës, pronësisë dhe politikave në bankingun tregtar - për t'ju dhënë juve këndvështrimin e një institucioni financiar jobankë. Duke ndjekur prezantimin e Guvernatorit dhe prezantimet e folësve të tjerë mbi globalizimin, mbi sfidat, unë do të doja t'ju jepja një ide mbi çfarë institucionet financiare jobanka bëjnë dhe si ne mund të ndihmojmë ose asistojmë zhvillimin e sektorit bankar.

Dua të ndalem në tre ose katër çështje.

Çështja e parë është përshkrimi i kontekstit, përcaktimi i institucioneve financiare jobanka. Çfarë do të thotë të jesh një institucion financiar

* *Peter BOTOUCHAROV, Zëvendëspresident, Global Fixed Income, T. Rowe Price International Ltd.*

jobankë në sferën globale? Po flas për administratorët e aktiveve; nuk po flas për kompanitë e sigurimit. Mund t'i ndajmë administratorët e aktiveve në tri grupe të mëdha.

Grupi i parë, janë investitorët e parasë reale. Mund t'i quajmë administratorë të fondeve të pensionit ose administratorë të kursimeve globale.

Grupi i dytë janë fondet e kthimit total. Nuk do të flas shumë për ta. Në masë të madhe ata nuk janë të përfshirë në ekonomitë tona më të vogla. Unë për vete jam bullgar dhe kam punuar në Bankën Qendrore të Bullgarisë. Vendet tona në fakt janë mjaft të qëndrueshme; nuk ka luhatshmëri, ku ky tip investitorësh të përfshihen.

Grupi i tretë janë investitorët e kapitalit aksioner. Për ta do të them disa fjalë thjesht për të treguar çfarë bëjnë në sektorin bankar.

Kjo është struktura e këtij lloji investitorësh, operatorë në tregun financiar dhe ka një sërë tendencash që po ndodhin në industri, por për këtë diskutim të veçantë duhet të përmenden dy tendenca të rëndësishme. E para, vazhdojmë të shohim një rritje të rëndësishme të aktiveve nën administrim. Kjo ndoshta sepse bankat qendrore kanë politika monetare lehtësuese; bota ka një sasi të madhe kursimesh. Tendenca e dytë është që përveç rritjes, shohim gjithashtu një përqendrim të aktiveve.

Sa për t'ju dhënë një ide të përmasave të investimeve të aktiveve nën administrim që priten: nga viti 2005 deri në vitin 2018, 400 administratorët më të mëdhenj të aktiveve në botë kanë rritur aktivet nga 50 trilionë dollarë në 70 trilionë dollarë. Po flasim për rreth 70 trilionë dollarë në katërqind kompanitë më të mëdha në botë, prej të cilëve 20% është përqendruar në dhjetë të parat. Atëherë, kush janë dhjetë të parat? Emrat e tyre i njihni. Kemi BlackRock, ata kanë rreth 6 trilionë, Vanguard, State Street, dhe këto janë kompani që administrojnë aktive pasive me sasi gjigande investimesh.

T. Rowe Price, që unë përfaqësoj, është një kompani e madhe, por prapë nuk është ndërmjet dhjetë administratorëve të aktiveve më të mëdhenj, sepse kemi 1,1 trilionë dollarë.

Kjo është tendenca e parë: rritje dhe përqendrim të aktiveve. Tani për ta sjellë në nivelin e kontekstit të sistemeve bankare të Evropës Qendrore dhe Lindore dhe Shqipërisë, ka sfida dhe mundësi. Mundësitë janë që meqenëse paraja është e përqendruar në administratorët më të mëdhenj të aktiveve, në fakt nuk mund të investojmë në periudhën afatshkurtër. Ne nuk mund të investojmë në një bankë, korporatë apo obligacione të shtetit për një muaj ose një vit. Është me të vërtetë një investim afatgjatë, veçanërisht në kapitalin aksioner. Një nga kolegët tanë në panelin e mëparshëm përmendi rëndësinë e kapitalit aksioner. Në fakt, ne investojmë në Shqipëri si investitorë me të ardhura fikse, por është edhe më mirë kur vijnë investitorët e kapitalit aksioner, pjesa e kompanisë time që investon në kapitalin aksioner. Disa nga kolegët këtu nga Ukraina, nga vende të tjera, janë plotësisht të vetëdijshëm sa i rëndësishëm është investimi në kapitalin aksioner.

Sfida është që tregjet janë tepër të vogla. Prandaj, megjithëse keni këta investitorë afatgjatë, tregu është tepër i vogël dhe unë do të adresoj disa nga problemet këtu. Pra, kjo është pika numër një.

Thjesht do t'i përmend pikat vijuese. Atëherë, unë përfaqësoj një investitor afatgjatë të madh të parasë reale. Në një këndvështrim, kjo është shumë mirë për vendet, korporatat dhe bankat. Në një tjetër këndvështrim, modeli ynë i biznesit nuk na lejon - atëherë, zonja Zëvendësguvernatore më pyeti se cilat janë rregulloret që ne ndjekim, në çfarë rregullimi jemi. Si shumë bankierë qendrorë këtu e dinë, kompanitë tona janë nën rregullimin e brendshëm, në rastin tonë ne jemi një kompani amerikane, pra ne jemi të rregulluar nga Komisioni i Titujve dhe Këmbimit në SHBA. Në Londër jemi të rregulluar nga Autoriteti i Shërbimeve Financiare. Në Evropë jemi të rregulluar nën ESMA. Pra, natyrisht jemi të rregulluar sepse ne jemi përgjegjës për fondet e pensioneve, për paratë e pensionistëve të ardhshëm. Natyrisht, kur ne vijmë në një vend më të vogël, si Bullgaria, Shqipëria ose Ukraina, çdo vend, duhet në një farë mase të rregullohemi ose nga rregullatori bankar qendror ose nga një rregullator bankar joqendror si për shembull një rregullator i shërbimeve financiare, por në përgjithësi këto kompani janë të rregulluara ngushtësisht. Për më tepër, ne kemi rregullim të brendshëm dhe praktika të administrimit të rrezikut. Po ju jap një numër dhe ky është që ne nuk mund të

investojmë në një aktiv, në Eurobondin e Shqipërisë ose në Bankën OTP, më tepër se 10% të fluksit të lirë aktual, ose të përmasës totale të aktivit. Pra, nëse Shqipëria ka, siç dhe e keni, një Eurobond me 500 milionë, ne në fakt nuk mund të blejmë më tepër se 50 milionë dhe kjo është një praktikë prudenciale e brendshme e rrezikut. Prandaj, kjo thjesht kufizon sa shumë ne mund të investojmë. Sa më i vogël është tregu, aq më e vështirë bëhet sepse aktivet janë më të vogla.

Atëherë, po kaloj në pikën e dytë, që është mbi kapitalin aksioner privat. Nuk kam për të folur për fondet e kthimit total. Ato janë më pak të rëndësishme për vendet tona. Kompanitë e kapitalit aksioner privat janë shumë më të vogla dhe më të rëndësishme për tregjet tona, më aktive dhe kanë aftësinë të investojnë në banka e të mbështesin sistemin bankar vendas. Kjo është pse një nga rekomandimet si ish-bankier qendror dhe investitor aktual është që ne duhet të jemi fleksibël në qasjen tonë me llojet e ndryshme të investitorëve. Pra, do t'ju përshkruaj strukturën - fondet e kapitalit aksioner privat investojnë në banka tregtare konvencionale, në banka rajonale ose lokale. Ka dy-tre shembuj që dua t'ju jap dhe jam i sigurt që i njihni më mirë se unë. Një është Addiko Bank, një bankë austriake, ka një bankë çeke e quajtur Moneta, dhe ka një aktor mjaft të ri në treg që quhet Robinhood, një kompani amerikane. Të gjitha këto lloj bankash të reja, këta hyrës të rinj bazohen mbi modele digjitale të reja. Natyrisht, siç mund ta imagjinoni, objektivi i tyre është pjesa më fitimprurëse e tregut të kreditimit. Ato nuk kreditojnë qeveritë ose kompanitë e mëdha: ato kanë si objektiv NVM-të dhe kredinë për individët.

Addiko është një shembull i mirë. Është një lojtar rajonal, nuk jam i sigurt nëse janë në Shqipëri, por janë nga ana tjetër e zonës në Kroaci, Bosnje e me radhë. Çfarë po ndodh? Addiko vetë u shkëput, besoj, nga Hypo Group Alpe Adria, dhe u ble 80% me kapital aksioner privat dhe 20% nga BERZH-i. Këta njerëz kanë një model të ri: specializim në kreditim me kthim të lartë, një bilanc më të thjeshtë, strukturë digjitale inovative. Mund të presim që ky tip investitori, ky tip aktorësh të rinj në treg, do të vazhdojë të hyjë dhe të përdorë përparësitë e botës së re, e teknologjive të reja. Moneta në Republikën Çeke është e ngjashme, ka një bankë të ngjashme në Rusi, që prishësi kryesor është tipi i *high tech* dhe FinTech si RobinHood në SHBA, i

cili për tani është një administrator aktivesh, por shumë shpejt do të fillojë dhe aktivitet bankar.

Ju si banka qendrore dhe banka tregtare duhet të mësoheni me këtë biznes. Tani, cili është roli i T. Rowe Price ose i institucioneve financiare jobankare të ngjashme? Meqenëse ne në fakt nuk kemi aftësinë të blejmë një bankë të plotë, por vetëm 10% të saj, roli ynë është normalisht të investojmë në këta aktorë hyrës të rinj, këta prishës - por në kuptimin pozitiv, nuk po them prishës në kuptimin negativ - ose të investojmë në një grup bankar. Për shembull, jam i sigurt që kemi investuar në *Hi-Fi*, kemi investuar në OTP, për të përfituar ekspozim në gjithë industrinë në Shqipëri ose në tërë rajonin. Pra, në një farë mënyre, kur punoni me kompani si e jona ose kompani të ngjashme, keni një investitor afatgjatë që nuk është një aksioner aktiv, por furnizon financim afatgjatë të kapitalit aksioner dhe unë besoj që këndvështrimi i çdo qeverie është që të mirëpresë këtë tip investitori afatgjatë. Nëse mendojmë se vlejnë, le të themi, Advent, që është me kapital aksioner privat dhe ka blerë në Addiko Bank, ne gjithashtu investojmë te ta, prandaj mund shkojmë në të dyja drejtimet.

Këto janë tre pikat që doja të përmendja.

Rregullimi është pika e fundit. E përshkrova më lart si ne jemi të rregulluar dhe natyrisht ka dhe rekomandime që do të doja të bëja. E para, ne duhet t'i përshtatemi kësaj bote të re digjitale, këtyre prishësve të rinj ose duke folur direkt me ta, në një farë mënyre duke i mbikëqyrur ata ose duke mbikëqyrur ne si ofrues final të likuiditetit, dhe duke aplikuar një qasje të diferencuar.

Më lejoni të ndaloj këtu. Unë besoj që këto lloj institucionesh financiare jobankë dhe kompanish ofrojnë mbështetje për industri bankare konvencionale dhe që investitorët afatgjatë e hyrësit e rinj krijojnë një ambient pozitiv për sektorin bankar në ekonomitë tona.

Faleminderit!

TENDENCAT E REJA TË BANKINGUT. ÇFARË REZERVOHET PËR SHQIPËRINË?

*Heinz WIEDNER**

Shumë faleminderit! Gjithashtu dua të falënderoj organizuesit e kësaj konference dhe Guvernatorin e Bankës Qendrore në Shqipëri për ftesën që më bënë.

Radha e fjalës sime qëndron midis jush dhe kohës së drekës. Mendoj se sikurse unë, ndiheni të uritur, kështu që do të përpiqem të flas shkurt. Në të njëjtën kohë do të përpiqem t'ju mbaj të interesuar.

Ka shumë gjëra që do të trajtoj të cilat janë prekur më parë, kështu që nuk ka asnjë surprizë. Do të diskutoj për tendencat e bankingut që ndikojnë bankat globalisht në rajon, por dhe pjesën më të madhe të tyre në Shqipëri, sot ose në periudhën afatshkurtër dhe disa prej tyre ndoshta në një periudhë më afatgjatë dhe unë do t'i referohem asaj periudhe.

* *Heinz WIEDNER, Nënkryetar i Bordit Mbikëqyrës, Banka Raiffeisen Shqipëri.*

Më lejoni të filloj me një temë, e cila është përmendur tashmë shumë herë. Bankat duhet të përshtaten me mjedisin me norma të ulëta interesi.



Kjo tingëllon shumë e thjeshtë, por nuk është dhe aq. Kam parë shumë plane të veprimtarisë së bankave, të cilat parashikonin që në vitet 2013-14-15, se sot, normat e interesit do të kishin nisur të rriten përsëri dhe ka modele se si ju do të mbronit dhe ruanit të ardhurat nga interesi nëpërmjet transformimit efektiv të maturimit. Por kjo funksionoi vetëm për një periudhë të përkohshme. Sot kjo kohë ka kaluar.

Praktikisht bankat duhet të jetojnë me perspektivën e normave të interesit zero ose pranë zeros në shumë vende për periudhën e parashikueshme. Mendoj se kjo është përmendur më parë, por bankat me të vërtetë duhet të ndryshojnë modelet e veprimtarisë për t'u përshtatur.

Në fund, marzhet e interesit, sigurisht në nivel zero, nuk mund të jenë të njëjta me nivelin 5%, për shembull. Kjo është shumë e qartë dhe e dukshme, dhe ndërsa nuk duket tepër dramatike në grafik, siç e thashë, kjo ka një ndikim të madh në banka.

Një nga reagimet e bankave duhet të jetë përmirësimi i produktivitetit dhe efektivitetit: të ulë bazën e kostos. Kjo mund të shihet, nga njëra anë, në reduktimin e stafit. Reduktimi i stafit në banka në Evropë në mënyrë proporcionale tashmë ka qenë shumë i lartë. Unë parashikoj se kjo do të vazhdojë ndoshta dhe me një ritëm më të shpejtë për pesë vitet e ardhshme me qëllim që me të vërtetë të nxisë efektivitetin pasi dhe digjitalizimi gjithashtu luan rolin e tij dhe ka ndikimin e tij në botën e bankingut.

Gjithashtu dhe degët po reduktohen. Ju mund të shihni që dhe në Evropën Qendrore dhe Lindore, nivelet e degëve janë rritur deri në 2013-2014, më pas filluan të ulen përsëri.

Kjo po ndodh. Shoh gjithashtu se kjo ndodhi dhe këtu, pasi funksionet online të pagesave po pranohen gjithnjë e më shumë nga popullsia. Domethënë le të përballemi me këtë. Ju shihni në shumë vende, degë që kanë vetëm 30% të trafikut të klientëve që kanë pasur më parë. Ky është një zhvillim ndaj të cilit bankat duhet të reagojnë dhe si rrjedhim numri i degëve do të vazhdojë të ulet. Ato nuk do të zhduken, pasi mendoj se në sistemin bankar tradicional ju keni nevojë për bankat. Por, është e qartë se do të ketë më shumë përqendrim dhe një numër të reduktuar të degëve.

Digjitalizimi është faktori tjetër i madh që ka luajtur një rol të konsiderueshëm këtu, revolucion, pothuajse do ta quaja unë, por do t'ju tregoj këtu se ende jemi në fillim.

Kjo mund të tingëllojë disi e çuditshme, sepse të gjithë sot jeni mësuar me aplikacionet në telefonat *smart*, etj., ku mund të bëni pagesa, madje dhe hapje llogarie, por për sa i përket nivelit të digjitalizimit, bankat ende ndodhen pas industrive të tjera. Kjo prek të gjitha fushat: në produkte dhe shërbime, *back office, mid office* madje dhe administrimin e rrezikut. Sot bankat po shohin mundësinë për të përdorur inteligjencën artificiale për të rritur sistemin e tyre të pikëzimit kështu që sistemi - nëpërmjet të dhënave të reja ushqehet në mënyrë konstante - mund të rregullojë automatikisht përqasjen ndaj rrezikut. Aktualisht duhet të shohim sa efektive është kjo, por mendoj se teknologjia gjithashtu mund të ndihmojë shumë në administrimin e rrezikut. Kështu që, do të ndikohen të gjitha aspektet e bankingut në mënyrë të konsiderueshme.

Ne folëm për FinTech. Fintechs janë të rëndësishëm. Ato sjellin inovacion, por ju duhet të shihni përtej vetëm "modës" që sjellin Fintechs. Shumë do të dështojnë dhe do të zhduken.

Do të thoja se ndoshta dy nga 10 FinTechs janë me të vërtetë vlerë e shtuar, ndërsa ka dhe një numër të madh të tyre që ofrojnë instrumente të reja apo lloje të tjera zgjidhjesh, të cilat me të vërtetë nuk kontribuojnë aq shumë. Është në dorë të bankës të vendosë me cilin FinTech të bashkëpunojë dhe ku të investojë dhe ku të shpenzojë paratë me qëllim që të arrijë nivelin e digjitalizimit që i nevojitet.

Në horizont ka banka të teknologjisë, të cilat gjithashtu venë në presion bankat. Nuk e di nëse keni dëgjuar, por disa prej tyre, ose ndoshta të gjitha, tashmë kanë disa milionë klientë dhe janë mjaft

aktive. Po përmend dy: N26 dhe Revoult. Ato janë banka që tashmë kanë miliona klientë të ndryshëm. Ato veprojnë në shtete, duke nisur nga Austria, në Shtetet e Bashkuara, Mbretëria e Bashkuar dhe në zona të tjera. Ato nuk janë Fin Tech. Ato janë banka, por që bazohen vetëm në shërbimet online, dhe nuk janë të kufizuara nga kostoja infrastrukturore e bankave tradicionale. Kjo do të thotë se ato nuk kanë bërthamën e vjetër të sistemit bankar. Bankat e mëdha kanë sisteme bankare që lidhen me 30 madje 40 vite më parë. Për të ndryshuar këtë nuk është një sipërmarrje e lehtë dhe ka një kosto që lidhet me të. Këto banka teknologjike në këtë kuptim po nisin punë nga një pikë dhe ne do të na duhet të shohim se sa të suksesshme janë. Por ju siguroj se ato po veprojnë me kosto më efektive sesa bankat tradicionale. Ne do të na duhet të shohim sa të suksesshme do të jenë ato, pasi po fillojnë me një ofertë të standardizuar. Ato sigurisht ende nuk mund të ofrojnë të gjitha produktet, por ofrojnë produktet që mund të jenë të standardizuara, që mund të digjitalizohen në një mënyrë relativisht të lehtë. Kështu që, mendoj se duhet të kemi kujdes për to pasi janë një kërcënim konkurrence ndaj bankave tradicionale.

Diçka tjetër që luan rol dhe që harrova ta përmendja më parë kur folëm për reduktimin e stafit dhe të degëve, ka diçka interesante, që janë ATM-të, të cilët janë rritur në numër deri në vitin 2016, dhe më pas edhe ato filluan të ulen, përfshirë edhe në rajon.

Arsyeja nuk është efektiviteti i kostos. Arsyeja është se njerëzit po përdorin metoda pagese që janë jashtë pjesës së parasë fizike, dhe sa më shumë të mësohen me atë aq më shumë nuk do të shkojnë dhe nuk do të kenë nevojë për ATM-të, të mos flasim për degët. Kështu

që, me të vërtetë shohim gjithashtu që po ndodh një reduktim i ATM-ve.

Ju mund të shihni se, vëllimet globale të pagesave elektronike po rriten me numra dyshifrorë dhe po rriten më shpejt se më parë. Sot rritja është 12-13%. Rritja më e lartë në vitin 2018 ka qenë në Rusi. Gjë që është interesante. Nuk e di saktësisht përse, por rritja në pagesa elektronike ka qenë 50% në Rusi. Kështu që, ato sigurisht duhet t'i kenë vënë mjaft theks kësaj pjese.

Gjithashtu mund të shihni këtu një lidhje midis vendeve që kanë një nivel të lartë të pagesave elektronike për frymë me nivele shumë të ulëta të treguesit të korrupsionit. Kjo nuk duket të jetë shumë surprizuese, por vendet me vëllime më të larta të pagesave elektronike kanë korrupsion më të ulët, dhe kështu që ka një interes për të rritur pagesat elektronike, dhe me rregullore, megjithëse paraja fizike nuk do të zhduket. Jam i bindur se do ta shohim atë për shumë dekada të ardhshme.

Ajo çfarë dua të them është se bankave iu duhet jo vetëm të bëhen më efektive, dhe jo vetëm të përqafojnë teknologjinë, por gjithashtu

duhet të ofrojnë shërbime me vlerë të shtuar për klientët e tyre. Jam i bindur se bankat vetëm do të fitojnë lojën nëse janë më shumë të orientuara nga klientët dhe sigurojnë një lloj lidhjeje me klientët e tyre, sigurojnë shërbime këshillimore, dhe ofrojnë shërbime të tjera të vlerës së shtuar që bankat teknologjike në thelb, nëpërmjet ofertës së tyre onlinë, nuk mund ta bëjnë.

Kështu që, kjo do t'i ndihmojë bankat tradicionale. Nuk do të jetë e vetmja zgjidhje, por së bashku me përmirësimet e produktivitetit dhe digjitalizimin kjo është një domosdoshmëri, nëse bankat tradicionale universale dëshirojnë të vazhdojnë të kenë sukses.

Kjo u përmend edhe më parë. Është e logjikshme që bankat që janë sot me nivel shumë më të lartë kapitalizimi dhe me shtesa më të larta të likuiditetit janë më të sigurta se më parë. Kështu që, është gjithashtu e logjikshme se kthimet nga kapitali janë më të ulëta sesa kanë qenë para krizës.

Kjo nuk është e vetmja arsye për vlerësimet e ulëta. Ka shumë arsye të tjera për këtë, por këtu mund të tregoj se bankat tregtojnë në

tregun e aksioneve poshtë vlerës së regjistruar dhe është industria më e keqe, nëse shihni aktualisht të gjitha industritë. Kjo është diçka që bankat do të duhet të shohin se si mund t'ia dalin, sepse në mënyrë të qartë analistët po hulumtojnë për fitimet në të ardhmen, dhe për momentin ka shumë re mbi fitimet e ardhshme dhe ata nuk janë të sigurt se bankat do të mund t'i shpërndajnë ato.

Kam një fjalë të fundit për kriptomonedhat sepse mendoj se nuk do të ndodhin shpejt këtu.

Por nuk mendoj se Bitcoin - e cila është monedhë spekulative - do të ketë me të vërtetë një efekt më të madh. Libra, u përmend më parë, mendoj se është diçka për të cilën tashmë rregullatorët dhe vendet janë më të ftohtë, kështu që nuk është e qartë se sa e suksesshme do të jetë. Sipas këndvështrimit tim, kriptomonedhat do të kenë vetëm një shans për të qenë të suksesshme në qoftë se rregullatorët dhe njëkohësisht qeveritë e vendeve do të shohin se ato mund të kontrollojnë flukset e parasë, pasi ky është një faktor tejet i rëndësishëm për një ekonomi që të kontrollojë flukset e parasë dhe me kriptomonedhat është e vështirë. Kështu që, mendoj se do të ketë zhvillime të kriptomonedhave, të cilat rregullatorët dhe bankat e rezervës gjithashtu do t'i mbështesin, dhe më pas mund të ketë një ndikim më të madh, por pikërisht tani, për vitet e ardhshme, nuk e shoh këtë.

Për ta përmbledhur, do të thoja se bankat duhet ta përqafojnë këtë ndryshim që po ndodh. Është më shumë si një revolucion se sa evolucion. Jam i bindur se pesë vitet e ardhshme do të sjellin ndryshime të rëndësishme në industrinë bankare, dhe kështu që nëse ato nuk e bëjnë mirë atë e shoh më shumë si një mundësi se sa një kërcënim. Mendoj se ato do t'ia dalin. Nëse jo, atëherë e ardhmja do të jetë e vështirë.

Faleminderit!

PANELI I GUVERNATORËVE:

SEKTORI FINANCIAR PËR RRITJE DHE STABILITET

Paneli i Guvernatorëve tradicionalisht adreson çështjet kryesore për të ardhmen e shërbimeve bankare dhe financiare. Cilat janë tendencat më premtuese dhe ku qëndrojnë rreziqet e ardhshme? Cilat janë implikimet e mundshme në drejtim të stabilitetit makroekonomik dhe rreziqeve, dhe pasiguritë kryesore për bankierët qendrorë dhe rregullatorët, jo vetëm në kontekstin e përsëritjes së "luftërave të monedhës"? Diskutimi përqendrohet në zgjedhjet e politikave dhe rregullatorëve, si dhe incentivat për të rigjeneruar ndërmjetësimin financiar në Shqipëri, në rajonin e Evropës Juglindore dhe më gjerë.

Moderatore: Piroska NAGY-MOHACSI, Drejtore e Programit, LSE Instituti për Çështje Globale

Panelistët (në rend alfabetik):
Erik BERGLOF, Drejtor, LSE Instituti për Çështje Globale
Mario BLEJER, LSE dhe IDB; ish-Guvernator i Bankës Qendrore të Argjentinës
Ardo HANSSON, Ish-Guvernator, Banka e Estonisë
Želimira RASPUDIĆ, Zëvendësguvernatore, Banka Qendrore e Bosnje dhe Hercegovinës
Gent SEJKO, Guvernator, Banka e Shqipërisë
Dmytro SOLOGUB, Zëvendësguvernator, Banka Kombëtare e Ukrainës

PANELI I GUVERNATORËVE

RAUNDI: I

Moderatore Piroska Nagy-Mohacsi: Mirë se u rikthyet në sesionin e radhës së pasdites! Mendoj se sesioni i paradites ishte i gjatë, por shumë produktiv. Tani kemi "qershinë mbi tortë", që është sesioni i fundit i Konferencës Vjetore të Bankës së Shqipërisë, Paneli tradicional i Guvernatorëve. Para se të vazhdojmë, më lejoni të falënderoj personalisht Guvernatorin Sejko, stafin e Bankës së Shqipërisë për bashkëpunimin e shkëlqyer, i cili mundësoi të mbahet për të dytën herë radhazi kjo Konferencë e përbashkët midis Bankës së Shqipërisë dhe LSE-së.

Zoti Guvernator, nëse më lejon, dua të përmend me emra tri njerëz të stafit tuaj, të cilët nga ana e Bankës së Shqipërisë luajtën rol thelbësor në organizimin dhe realizimin e kësaj Konference: Altin Tanku, Drejtor i Departamentit të Kërkimeve në Bankën e Shqipërisë; Donald Duraj, Shef i Kabinetit të Guvernatorit dhe Henri Herri, Shef i Zyrës së Protokollit, i cili ka qenë "truri" i logjistikës për këtë organizim. Faleminderit secilit prej jush!

Ne kemi pasur diskutime fenomenale gjatë gjithë paradites. Shumë prej jush e dinë se dje pati një panel të nivelit të lartë paraprijës të sesioneve të sotme, mbi: "Tendencat globale dhe evropiane që

ndikojnë kontekstin e zhvillimeve në Evropën Juglindore". Paneli i përbërë nga: Erik Berglof, LSE/IGA; Nadeem Ilahi, FMN; dhe Vassilis Monastiriotis, Drejtor i Kërkimeve në LSE për Evropën Jug-Lindore, që diskutuan mbi tendencat dhe zhvillimet në kontekstin global dhe rajonal. Kështu që, paneli i Guvernatorëve, me të vërtetë mund të mbështetet në diskutimet e sesionit të paradites, por dhe në ato të nivelit të lartë që u zhvilluan dje.

Më lejoni zoti Guvernator të vë në dukje disa nga çështjet e përgatitura, të cilat mund të diskutohen në këtë panel.

Një çështje është ajo e vënë në dukje nga Heinz Wiedner, Raiffeisen Bank, i cili e quajti "Revolucion" që po ndodh në sektorin financiar, dhe veçanërisht në sektorët bankarë, globalisht, por veçanërisht në këtë rajon". Nuk është thjesht një revolucion, por më shumë një ndryshim fondamental në pronësi: bankat e pozicionuara në BE po reduktojnë pak peshat e tyre në treg, ndërsa bankat jo të BE-së dhe ato vendase po fitojnë peshë në treg.

Në të njëjtën kohë, ne shohim këto ndryshime të mëdha përkundrejt një panorame të përmirësimit të madh në fondamentet ekonomike dhe e veprimtarisë së sektorit bankar. Michael Wuerz, nga Banka Kombëtare e Austrisë si dhe folës të tjerë, përmendën se është përmirësuar ndjeshëm rezistenca e sektorit bankar. Pra kemi revolucion në strukturë, në të njëjtën kohë rezistenca e përgjithshme e sistemit është përmirësuar. Kjo është një histori mjaft domethënëse.

Këto transformime të mëdha janë administruar shumë mirë. Kështu që, ndërsa na duhet të identifikojmë problemet dhe sfidat e së ardhmes, është e rëndësishme që të jemi të vetëdijshëm se kemi një sistem shumë më rezistent, me fondamente shumë më të mira, me mjaftueshmëri kapitali shumë më të mirë, likuiditet më të mirë dhe me bilance shumë të shëndetshme. Kjo nuk është një listë e vogël me përmirësime, pas gjithë asaj që ka kaluar ky rajon që në nisje të krizës financiare globale.

Pika e dytë e rëndësishme ishte ndikimi i normave të ulëta ose negative të interesit dhe si bankat mund të veprojnë në këtë situatë. Ne dëgjuam Marianne Nessen nga Riksbank, se mund të jemi të

sigurt se normat e ulëta ose negative janë këtu për të qëndruar. Pra, është mirë të përgatitemi për t'iu përshtatur atyre.

Një pikë tjetër e rëndësishme ishte se normat negative mund të detyrojnë bankat që të operojë me kosto efektive. Ky adoptim kërkon shumë përmirësime, veçanërisht në një kohë kur konkurrenca nga institucionet jobanka, industritë FinTech, është shumë e rëndësishme. Dëgjuam shumë për digjitalizimin. Është diçka që ndoshta paneli do të dojë ta diskutojë. Përfaqësuesit nga Banka Intesa Sanpaolo, Paola Angeletti dhe Silvio Pedrazzi, si dhe përfaqësuesit nga Raiffeisen ofruan siguri në lidhje me këtë pikë. Nga ana e politikës, Ioannis Asimakopoulos nga Banka e Greqisë dhe Davide Stroppa nga ABE vunë në dukje se bankat me të vërtetë janë duke u përgatitur për këtë revolucion digjital.

Dëgjuam nga Ralph de Haas, BERZh, se pesë banka të huaja kanë qenë me të vërtetë transformuese në financimin e kalimit nga sistemi komunist në atë ku jemi sot, vende demokratike në EQJL. Ndërsa kanë luajtur rol shumë të rëndësishëm në këtë transformim, këto banka janë më pak të pajisura për atë çfarë me të vërtetë nevojitet sot: financim të inovacionit, që është i nevojshëm për të përshpejtuar rritjen ekonomike dhe për të shmangur grackën e të ardhurave të mesme. Kjo kërkon marrjen përsipër të një rreziku të konsiderueshëm dhe gjithashtu do të ishte interesante të dëgjonim nga paneli se çfarë mendojnë për implikimet e mundshme të politikës.

Gjithashtu, dje dëgjuam Nadeem Ilahi nga FMN dhe sot Milan Deskar-Skrbic nga Banka Kombëtare e Kroacisë se ky rajon është në "krahët" e Eurozonës. Është me të vërtetë ajo çfarë BIS e quan - dhe e dëgjuam edhe vitin e kaluar- se ky rajon është me të vërtetë një Eurozonë hije. Kështu që, në këtë rajon ka një "miniqark financiar" nga zona euro; ajo çfarë më të vërtetë ka rëndësi janë politikat e BQE-së.

Në fund dëgjuam edhe për rolin e financave jobankë. Peter Botoucharov foli rreth përfshirjes së mundshme të administruesve të aktiveve në transformimin e këtij sektori. Mund të ngrihen disa pikëpyetje rreth asaj se çfarë do të thotë për stabilitetin financiar kur,

për shembull, administruesit e aktiveve duan të dalin jashtë sektorit bankar për arsye fitimi.

Një pikë tjetër shumë e rëndësishme që paneli mund të dojë të diskutojë është roli i Eurozonës dhe vetë perceptimi se po ndryshon. Erik dhe Vasilis, të dy nga LSE, vunë dje në dukje se i gjithë koncepti i sovranitetit të Evropës po maturohet dhe kjo ndikon, ashtu si me të drejtë vuri në dukje Vasilis, atë se çfarë lloj "loje anëtarësimi" ka për vendet joanëtare të BE-së në këtë rajon.

Për të diskutuar të gjitha këto çështje dhe të tjera shumë të rëndësishme, kemi një panel të shkëlqyer. Së pari më lejoni të prezantohem. Unë quhem Piroska. Punoj si Drejtore Programi, LSE, Instituti për Çështjet Globale. Në këtë panel kemi Guvernatorin Sejko, i cili nuk ka nevojë për prezantim. Por më lejoni të përmend diçka që del nga biografia juaj, z. Guvernator: përvoja juaj e gjatë në sektorin privat. Ju sillni në shërbim të publikut aftësitë dhe përvojën që keni marrë në bankat Raiffeisen, Societe Generale, si dhe përvojën e auditimit tek Deloitte & Touche, para se të shërbeni në sektorin publik.

Erik Berglof është Drejtor i IGA, gjithashtu dekan i Laboratorit të Politikës Globale, i krijuar kohët e fundit në LSE.

Zonja Želimira Raspudić, Zëvendësguvernatore e Bankës Qendrore të Bosnje-Hercegovinës. Zonja Raspudić ushtron detyrën e Zëvendësguvernatores që prej korrikut 2017. Ajo ka një përvojë të gjatë me bankat tregtare, për shembull UniCredit, për dekada ka mbajtur pozicione të ndryshme dhe gjithashtu ka punuar dhe jashtë vendit.

Në krahun tim të majtë është zoti Dmytro Sologub, Zëvendësguvernator i Bankës Kombëtare të Ukrainës. Zoti Sologub ushtron detyrën e Zëvendësguvernatorit që prej marsit 2015, dhe në këtë pozicion ai është përgjegjës për politikën makroprudenciale në një vend, i cili ka kaluar një ndryshim revolucionar në vitet e kaluara. Gjithashtu, ka një përvojë në bankat tregtare si Raiffeisen, si dhe ka mbajtur disa pozicione publike.

Paneli ynë ka në përbërjen e tij gjithashtu ish-guvernatorë të njohur. Pak më larg në të majtën time është Ardo Hansson, i cili deri disa muaj më parë ka qenë Guvernator i Bankës së Estonisë për një periudhë të konsiderueshme. Kur u emërua në këtë pozicion në mes të vitit 2011, rajoni i Baltikut dhe vendi i tij po përballeshin me sfida të jashtëzakonshme në prag të krizës globale financiare. Por vendi qëndroi në Eurozonë, duke ia dalë të përballonte një rregullim shumë të vështirë.

I fundit, por jo më pak i rëndësishëm, është ish-Guvernatori i Bankës Qendrore të Argjentinës, Mario Blejer. Ai është në bordin e drejtorëve të IRSA, e cila është një kompani e madhe në Argjentinë dhe Izrael. Gjithashtu, është profesor i jashtëm pranë LSE-së. Përveç se Guvernator i Bankës Qendrore të Argjentinës, Mario gjithashtu ka qenë Drejtor i Përgjithshëm në Bankën e Anglisë dhe ka dhënë mësim në shumë universitete në botë. Në përfundim të këtij prezantimi të panelistëve, më lejoni të nis diskutimin.

Ndoshta raundi i parë do të ofrojë një mundësi të lirshme për të përshkruar sfidat madhore që ju keni hasur gjatë këtyre viteve.

Fillojmë me ju, Guvernatori Sejko, dhe më pas me radhë me të gjithë panelistët.

Guvernatori Sejko: Shumë faleminderit Piroska! Një përmbledhje mjaft e mirë. Do të përpiqem t'i përmbledh shkurt komentet e mia hyrëse, pasi mendoj që paneli do t'i trajtojë çështjet në më shumë detaje gjatë diskutimeve të tij. Ristrukturimi i sektorit bankar ka qenë në fokus të politikave të Bankës së Shqipërisë, dhe në lidhje me këtë kemi mbuluar të gjitha çështjet e diskutuara nga kolegët në panelin e ditës së djeshme dhe në sesionin e mëngjesit të sotëm. Ndërkohë, kemi administruar sfida të tjera tradicionale për bankat qendrore me të cilat jemi hasur gjatë kësaj periudhe. Disa prej këtyre çështjeve të rëndësishme që lidhen me zhvillimin e sistemit bankar dhe tregut financiar, i diskutuam në konferencën e vitit të kaluar. Banka e Shqipërisë ka bërë shumë progres dhe kanë ndodhur shumë ndryshime. Një nga qëllimet tona ka qenë konsolidimi i sistemit bankar. Disa banka evropiane që ushtrojnë veprimtarinë e tyre në Shqipëri, si Société Générale, banka me kapital grek dhe banka të tjera, kanë

përvetësuar një strategji daljeje nga sistemi, për shkak të kritereve të shtrënguara që lidhen me rrezikun nga bankat e tyre mëmë dhe politikat e BQE-së. Këto strategji janë njoftuar vitin e kaluar, dhe në periudhën kohore prej një viti, që nga konferenca e kaluar, disa banka vendosën të largohen. Kështu që, nga këndvështrimi i mbikëqyrjes, sfida jonë ishte të mbikëqyrnim ristrukturimin e sistemit bankar dhe ristrukturimin e bankave, ndërsa ruhej stabiliteti i sistemit si një i tërë dhe pa shkaktuar pasoja negative për ekonominë, klientët e tyre, si dhe për politikën tonë monetare dhe atë të stabilitetit financiar. Sot, që procesi konsiderohet i përfunduar, kemi 12 banka, në vend të 16 që kishim më parë. Ky proces konsolidimi u arrit nëpërmjet shkrirjeve dhe përthithjeve, të cilat kanë sjellë emra të rinj në sistemin bankar shqiptar. Me strukturën aktuale, sistemi ynë bankar do të jetë më i përqendruar, në një pozicion më të mirë për të kredituar ekonominë dhe për të përballuar sfidat e stabilitetit dhe zhvillimit të tregut financiar. Do të ofrojë një përmbushje më të mirë të nevojave aktuale të ekonomisë shqiptare, zhvillimin e tregut financiar dhe do të rrisë efektivitetin e politikës monetare të Bankës së Shqipërisë.

Banka e Shqipërisë ishte e mirëpërgatitur për këtë proces dhe ka punuar ngushtë me sistemin bankar dhe grupet e bankave mëmë gjatë gjithë procesit. Ky proces konsolidimi ishte diçka që ne mezi e prisnim. Gjithsesi, sfida është të ruajmë cilësinë e pronësisë aksionere në sektorin bankar. Aksionerët e mëparshëm patën shumë përvojë, por gjatë vitit të kaluar, që kur adoptuan strategjinë e daljes nga sistemi, ata nuk ishin aspak proaktivë. Si rezultat, këto banka, nuk po kreditonin ekonominë dhe në të njëjtën kohë, burimet dhe drejtimi u përkeqësuan disi. Kështu që, është një hap pozitiv që këto banka ndryshuan strukturën aksionere, ndonëse ajo solli një sfidë për Bankën e Shqipërisë. Procesi kërkoi mbikëqyrje më të shpejtë dhe më të fokusuar, si dhe monitorim të këtyre bankave gjatë dhe pas ndryshimeve të pronësisë.

Ndërsa ende jemi në fazë të hershme, ne me kënaqësi shohim disa zhvillime dhe rezultate pozitive. Së pari, ka një rritje pozitive të kreditimit, kryesisht në lekë mbështetur nga politika jonë monetare lehtësuese me norma bazë të interesit në nivelin më të ulët historik. Për më shumë, rritja e kreditimit ka qenë e pranishme në një gamë të gjerë sektorësh. Vitin e kaluar, rritja e kredisë ishte më së

shumti e përqendruar në segmentet e shitjes me pakicë dhe në atë të individëve. Sot, shohim rritje të kredive për sektorin e biznesit, kryesisht për ndërmarrjet e vogla dhe të mesme, dhe në një shkallë të konsiderueshme për korporatat e mëdha. Pra, është një sinjal i mirë për sa i përket kreditimit të ekonomisë. Lidhur me këtë, kjo përfaqëson edhe një përmirësim të efektivitetit të mekanizmit të transmetimit të politikës monetare, dhe ndërkohë jemi të kënaqur të vëmë në dukje se kemi mundur të administrojmë rreziqet e lidhura me stabilitetin financiar dhe ta ruajmë atë gjatë gjithë këtij procesi.

Më duhet të pohoj se nuk ishte një proces i lehtë, pasi, ndonjëherë politika monetare dhe ajo e stabilitetit financiar shkojnë në drejtime të kundërta. Ka pasur momente në të kaluarën kur ky kombinim ka qenë shumë stresues, veçanërisht gjatë krizës greke. Ne punuam në bashkëpunim të ngushtë me FMN-në, dhe përfitoj nga ky rast që të falënderoj gjithashtu mikun tim Mario Blejer që na ndihmoi shumë me këshillat e tij gjatë kësaj periudhe. Kështu që, ne kapërcyem me sukses një situatë shumë të vështirë në lidhje me stresin financiar për sektorët bankarë dhe financiarë.

Gjatë procesit të konsolidimit, mjaftueshmëria e kapitalit dhe likuiditeti në sistemin bankar dhe në të gjithë parametrat e shëndetit financiar të të gjitha bankave ishin në gjendje shumë të mirë. Raportet e kapitalit dhe të likuiditetit kanë qenë në mënyrë të vazhdueshme mbi kufirin e kërkuar dhe vazhdojnë të jenë në nivele të mira. Duke ju kursyer detaje të panevojshme, kjo ishte një përmbledhje lidhur me konsolidimin bankar dhe ndryshimet në sistemin bankar në Shqipëri. Sot ndihemi më të sigurt për të ardhmen.

Ne kemi pasur sfida të tjera, me të cilat vazhdojmë të përballemi. Një nga çështjet më urgjente me të cilën po merremi është mbiçmimi i kursit të këmbimit gjatë tri viteve të shkuara, veçanërisht vitin e fundit, ku kursi i këmbimit u mbiçmua në mënyrë të konsiderueshme. Mbiçmimi është ndalur dhe sot, kursi i këmbimit është i qëndrueshëm, në kurriz të turbulencave të kufizuara në tregjet e brendshme financiare dhe duke reflektuar zhvillime në normën e rritjes ekonomike dhe në fondamente të tjera. PBB-ja jonë është mbi 10 miliardë euro dhe rritja ekonomike është e fuqishme. Ka pasur flukse hyrëse të konsiderueshme të IHD-ve në rreth 1 miliard

euro çdo vit. Pjesa më e madhe e IHD-ve vijnë nga Eurozona. Eksportet e shërbimeve, veçanërisht turizmi, kanë bërë përparim të mirë gjatë viteve të fundit. Përveç numrit të rritur të vizitorëve të huaj, shqiptarët që jetojnë jashtë vendit vizitojnë vendin ose për pushime apo për të parë familjet e tyre, gjatë muajve të verës apo në dimër - kryesisht për Krishtlindje - duke sjellë më shumë dërgesa monetare (remitanca). Dërgesat e emigrantëve kanë qenë gjithmonë një kontribuues i konsiderueshëm në ekonominë e Shqipërisë dhe kohët e fundit kemi parë rritje të tyre, për shkak të një vale të re emigrimi në Eurozonë. Ashtu si të ardhurat nga turizmi, pjesa më e madhe e dërgesave të emigrantëve janë në monedhën euro. Së bashku, të gjitha këto aktivitete rrisin ofertën për euro në ekonominë tonë, dhe si pasojë rriten presionet për mbiçmim të lekut.

Ka pasur një debat të gjatë për burimet formale dhe joformale të flukseve hyrëse në monedhë të huaj. Mund të tregohet se mbiçmimi i lekut mund të jetë gjithashtu rezultat i monedhës euro që futet në ekonomi nëpërmjet kanaleve informale. Ne sigurisht mund të matim vetëm monedhën vendase në qarkullim. Analizat empirike sugjerojnë se mbiçmimi ishte në linjë me goditjen e vërejtur në ofertën e euros në tregun formal, nga burime formale të identifikuara në sektorin financiar dhe në atë të ekonomisë reale.

Për shkak të gjithë këtij presioni nga monedha euro, kursi i këmbimit u mbiçmua, duke penguar konkurrencën dhe ndikuar negativisht eksportet. Me të vërtetë, pati ankesa edhe nga eksportuesit rreth mbiçmimit që gërreu avantazhin e tyre konkurrues. Por, ata nuk ia dolën të shihnin të gjithë panoramën. Ne jemi një vend me deficit tregtar të jashtëm. Ne importojmë më shumë sesa eksportojmë. Është e vërtetë se eksportuesit po ankoheshin për humbjet. Megjithatë, nga ana tjetër, shumë biznese të cilat i kanë të ardhurat e tyre në monedhën vendase, po fitonin nga kjo histori. Për shkak të karakteristikave të ekonomisë shqiptare, gjatë këtij episodi të veçantë të mbiçmimit, fitimet neto nga aktorët e ekonomisë janë mbizotëruese.

Megjithatë, pavarësisht këtyre shqetësimeve mikro, detyra jonë, si bankë qendrore e vendit, është t'i shërbejmë objektivit tonë kryesor dhe ta administrojmë ekonominë si një e tërë, se sa të administrojmë kursin e këmbimit nga grupe të veçanta interesi.

Shqipëria ka një regjim të lirë të luhatshëm të kursit të këmbimit, pra është e kuptueshme se ky regjim është aty për të amortizuar më mirë goditjet nga jashtë dhe nga brenda. Megjithatë, në kohë të caktuara dhe në kushte specifike, goditjet e mëdha të mbiçmimit apo nënçmimit të kursit të këmbimit kanë disa pasoja. Në këtë rast, pasoja më e madhe ishte mbi inflacionin. Mbiçmimi i kursit të këmbimit kishte një efekt negativ në inflacion, duke vënë në rrezik masat e politikës monetare të Bankës së Shqipërisë. Inflacioni ishte mjaft poshtë objektivit tonë prej 3% dhe u bë shqetësimi ynë kryesor.

Në këto rrethana, Këshilli Mbikëqyrës miratoi një program për të ndërhyrë në treg. Ne tërhoqëm likuiditetin e tepërt në euro nga tregu dhe u përpoqëm të stabilizonim goditjen e ofertës në tregun valutor. Ne ia dolëm ta kontrollonim atë në një shkallë të caktuar dhe të arrinim një ekuilibër të kursit të këmbimit valutor. Pra, ishe një sfidë e madhe me të cilën u përballëm. Ne do të vijojmë ta monitorojmë kursin, por në këto momente nuk ka luhatje të konsiderueshme.

Një problem tjetër i rëndësishëm me të cilin po hasemi është niveli i lartë i euroizimit të ekonomisë sonë. Ekonomia jonë është mjaft e euroizuar, jo vetëm në sektorin financiar, por edhe në atë real. Raporti i euroizimit është pothuajse 50 me 50, dhe është kthyer në shqetësim për stabilitetin makroekonomik dhe financiar për arsyet e mëposhtme:

Së pari, 1/4 e portofolit të kredisë në Shqipëri është e pambrojtur. Kjo do të thotë se portofoli i kredisë në monedhë të huaj përbën një rrezik të konsiderueshëm për stabilitetin financiar në rast nënçmimi të monedhës sonë kombëtare. Individët do të përballen me vështirësi në rritje për të paguar kreditë e tyre pasi ekspozimi është në monedhën euro, por të ardhurat janë në monedhë kombëtare. Potencialisht, ky është një rrezik ekspozimi shumë serioz për të ardhmen.

Së dyti, niveli i lartë i euroizimit ul eficiencën e mekanizmit të transmetimit të politikës monetare. Përderisa 50% e huave dhe depozitave janë në monedhën kombëtare, transmetimi i politikës sonë monetare është i kufizuar.

Për të trajtuar këto shqetësime, Banka e Shqipërisë ka nënshkruar një Memorandum Mirëkuptimi me Qeverinë dhe Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare. Sipas këtij Memorandumi, të trija institucionet kanë rënë dakord të zhvillojnë dhe zbatojnë një strategji deeuroizimi për ekonominë. Për bankën qendrore, kjo strategji përdor rezervën e detyrueshme dhe instrumente të tjera operacionale monetare për ta bërë monedhën kombëtare më tërheqëse për investime dhe kursime në krahasim me monedhat e huaja. Në të njëjtën kohë, Banka e Shqipërisë po punon për edukimin financiar dhe transparencën, në mënyrë që publiku të kuptojë se çfarë është rreziku i këmbimit valutor.

Përpjekjet tona për deeuroizimin në kuadër të stabilitetit financiar dhe qëndrimit lehtësues të politikës monetare kanë dhënë efektet e tyre shumë të mira.

Së pari, vetëm disa vite më parë, pothuajse 80% e stokut të tepricës së kredive ishte në monedhë të huaj, kryesisht në euro. Sot kjo shifër ka rënë në rreth 50%. Kjo është falë diferencës së reduktuar të normës së interesit midis lekut dhe euros. Njerëzit po marrin më shumë hua në lekë, pasi norma e interesit për këtë hua është shumë më e ulët, pra e tillë është diferenca e normave të interesit.

Nga ana e saj, Qeveria ka ndërmarrë masat e veta për të parandaluar përdorimin e panevojshme të euros si mjet i transaksioneve të këmbimit në tregje të caktuara. Shumë lëndë të para kuotohen dhe këmbehen në euro. Përse duhet të kuotohen në euro? Ne shohim se të gjitha vendet në rajon dhe kudo përdorin monedhën kombëtare si instrument këmbimi. Rezidentët dhe të huajt nuk mund të blejnë mallra dhe shërbime në euro, por ata duhet të shkojnë në një bankë apo zyrë këmbimi valutor dhe ta këmbejnë atë në monedhën vendase.

Sigurisht, deeuroizimi është një proces që do të kërkojë kohë. Është i matshëm, por nuk arrihet lehtësisht. Do të kërkojë kohë sepse disponueshmëria dhe përdorimi i euros është futur thellë në jetën tonë ekonomike, por ne do të jemi këmbëngulës dhe do ta kryejmë këtë proces hap pas hapi.

Një tjetër sfidë e rëndësishme për sektorin bankar dhe financiar është futja e Fintech dhe inovacionit financiar, si dhe përvetësimi

i tij nga industria financiare. Ka pasur shumë iniciativa në Shqipëri për zbatimin e teknologjive të reja në financë, duke filluar së pari me bankat tregtare. Ka shumë iniciativa në treg që kanë për qëllim të ofrojnë shërbime inovative për ose në bashkëpunim me sektorin bankar. Megjithatë, ky proces është pak i fragmentuar, bankë me bankë, dhe nuk ka pasur progres shumë domethënës.

Krahasuar me disa vite më parë, ka pasur shumë progres në këtë fushë sepse njerëzit po përdorin bankingun nëpërmjet telefonisë celulare për të aksesuar llogaritë e tyre bankare, për të kryer pagesa dhe transferta të fondeve nëpërmjet bankingut online apo telefonisë celulare. Megjithatë, këto shërbime nuk përdoren gjerësisht nga publiku i gjerë në pagesat e tyre të përditshme. Ne po punojmë në këtë drejtim. Modernizimi i sistemit të pagesave është një nga objektivat kryesorë të bankës qendrore, mbështetur nga Komiteti Kombëtar i Sistemit të Pagesave që kryesohet nga banka qendrore. Në këtë drejtim, Komiteti ka miratuar Strategjinë Kombëtare për Tregun e Pagesave me Vlerë të Vogël në Shqipëri, i cili ka për qëllim të forcojë përfshirjen financiare dhe përdorimin e pagesave elektronike. Një hap i rëndësishëm drejt arritjes së objektivave të kësaj strategjie është hartimi i ligjit "Për shërbimet e pagesave", i cili përafron Direktivën e dytë "Për shërbimet e pagesave" në kuadrin ligjor dhe rregullator të Shqipërisë. Për këtë qëllim, ne po bëjmë ndryshime të këtij ligji (siç e përmenda më parë në fjalën time).

Qëllimi i këtij ligji është të forcojë rolin dhe veprimin e shërbimeve financiare jobankë në tregun e shërbimit të pagesave për të rritur konkurrencën dhe forcuar inovacionin. Mund të ketë shumë rreziqe nga këto shërbime financiare jobankë, por ato janë shumë tërheqëse dhe kanë kontribute mjaft pozitive për industrinë bankare dhe sektorin financiar, duke reduktuar kostot, përmirësuar arritshmërinë e tyre për zonat rurale dhe duke përmirësuar formalizimin e ekonomisë.

Në këtë kontekst të zbatimit të shërbimeve bankare dhe financiare dhe digjitalizimit, ne hasim një tjetër sfidë të rëndësishme, nivelin e ulët të kulturës financiare dhe të përfshirjes financiare. Vrojtimet e Bankës së Shqipërisë dhe të institucioneve të tjera partnere, tregojnë se ne, jo vetëm në Shqipëri, por të gjitha vendet në rajon, kanë një

nivel të ulët të kulturës financiare dhe të përfshirjes financiare. Të dy problemet qëndrojnë në zemër të politikave të stabilitetit financiar, të së ardhmes ekonomike dhe të konvergjencës ekonomike. Kufizimet në të dyja fushat e edukimit financiar dhe të përfshirjes financiare, kanë ndërlikime të konsiderueshme, jo vetëm për efektivitetin e politikës monetare dhe stabilitetit financiar, por së pari dhe mbi të gjitha ato janë pengesa për të ardhmen e individëve, zhvillimin ekonomik dhe konvergjencën ekonomike. E fundit, por jo më pak e rëndësishme, për zhvillimin e vetë sektorit financiar. Për shkak të këtyre problemeve, shumë familje, ndërmarrje të vogla dhe të mesme nuk munden të punojnë me institucionet bankare dhe financiare dhe të përfitojnë nga ndërmjetësimi financiar sepse: ose nuk dinë se si; ose ato nuk janë të vetëdijshme për mundësitë. Në raste të tjera, ato janë parë si jo të afta të arrijnë tek bankat, apo institucionet bankare dhe financiare dhe produktet e tyre janë përtej mundësive të bizneseve të vogla apo familjeve për t'i arritur, dhe nuk përputhen me nevojat e tyre. Këto kufizime pengojnë aftësinë e tyre të investojnë apo zgjerojnë veprimtarinë e tyre dhe reduktojnë efektivitetin financiar dhe ekonomik. Ne po përpiqemi shumë në këtë proces. Ne dëshirojmë të rrisim kulturën financiare dhe aksesin financiar të njerëzve në sektorin bankar, dhe kjo vjen nëpërmjet edukimit financiar. Banka qendrore në bashkëpunim me Ministrinë e Arsimit dhe aktorë të tjerë në treg janë angazhuar në shumë programe të edukimit financiar. Megjithatë, ky gjithashtu është një proces shumë i vështirë.

Digjitalizimi, gjithashtu, luan një rol kyç në këtë proces. Edukimi financiar; ofrimi i produkteve dhe shërbimeve bankare nëpërmjet instrumenteve tradicionale apo platformave të reja digjitale; ndihma e bankave për të pasur një bazë më të gjerë klientësh dhe të mbulojnë zonat që nuk janë të mbuluara nga shërbimi bankar, janë objektiva mjaft të mirë. Këto objektiva përmbushen më mirë kur zhvillohen njëkohësisht dhe në koordinim si pjesë e Strategjisë Kombëtare të edukimit financiar dhe të përfshirjes financiare. Pavarësisht të gjithë shembujve pozitivë të ndryshimeve bankare që u diskutuan nga Heinz Wiedner dhe kolegë të tjerë, kjo strategji shkon përtej prezantimit të produkteve të reja dhe inovative. Shumë prej bankave po optimizojnë veprimtarinë e tyre në këtë drejtim. Ato po ndryshojnë dhe përshtatin modelet e veprimtarisë së tyre për

revolucionin digjital dhe ekonominë digjitale; modele, produkte dhe shërbime të reja janë zhvilluar në mjedisin e bankingut digjital dhe platformave të bankingut nëpërmjet telefonisë celulare. Kjo tendencë ka hapur një kapitull të ri për produktet dhe shërbimet financiare e bankare. Të gjithë po punojnë në këtë drejtim. Edhe Shqipëria duhet të punojë në këtë drejtim. Megjithatë, ky proces duhet të zhvillohet brenda një infrastrukture të mirëpërcaktuar ligjore, institucionale dhe të besueshme. Për më tepër, ai ka nevojë për një bashkëpunim dhe koordinim të mirë midis aktorëve: banka qendrore, ministritë, institucionet publike dhe kompanitë private. Nga këndvështrimi rregullator, ne po bëjmë shumë përpjekje për të përgatitur bazat me qëllim që të parandalojmë rreziqet, së pari dy rreziqe kryesore: 1. rrezikun kibernetik; 2. rrezikun e pastrimit të parave. Së bashku duhet të bëjmë më shumë për edukimin financiar, jo vetëm të prezantojmë publikun dhe biznesin me këto produkte të reja dhe inovative, si dhe përfitimet prej tyre, por gjithashtu t'i edukojmë dhe t'i mbrojmë ata nga rreziqet e mundshme që lidhen me këto produkte. Këto janë çështje që marrin më shumë rëndësi në vende si tonat, pasi ne jemi në kalimin drejt procesit të integrimit evropian.

Këto janë disa nga sfidat tona.

Moderatore Piroska Nagy-Mohacsi: Shumë faleminderit zoti Guvernator për këtë analizë gjithëpërfshirëse. Jam e sigurt se disa prej kolegëve tuaj janë përballur me probleme të ngjashme, por ndoshta me disa ndryshime. Më lejoni të pyes zonjën Zëvendësguvernatore Raspudić. A keni në Bosnje Hercegovinë, sfida të ngjashme me ato të Shqipërisë?

Zëvëndesguvernatore Želimira Raspudić: Shumë faleminderit! Së pari, dua të falënderoj organizatorët, Bankën e Shqipërisë dhe Shkollën Ekonomike dhe Shkencave Politike të Londrës për ftesën dhe për këtë konferencë të shkëlqyer, në të cilën kam mësuar shumë. Dua të paraqes disa informacione për Bankën Qendrore të Bosnje dhe Hercegovinës. Siç e dini, Bosnje dhe Hercegovina kaloi një përvojë lufte shumë të rëndë dhe banka qendrore u krijua vetëm pas Marrëveshjes së Paqes të Dayton-it. Ligji për bankën qendrore specifikon bordin e monedhës si regjim të këmbimit valutor si më të përshtatshmin për një vend me ekonomi dhe politikë të dobët.

Bordi i monedhës thjesht do të thotë emetim të kartëmonedhave dhe monedhave, dhe ofrimin e shërbimit të këmbimit të monedhës vendase në monedhë të huaj, në rastin tonë në euro, me një normë fikse të këmbimit valutor.

Bordi i monedhës ka funksionuar mjaft mirë në lidhje me regjimin e këmbimit valutor, pasi ai kontribuoi në stabilitetin e ekonomisë së përgjithshme, dhe jam e sigurt se ne do ta mbajmë këtë regjim derisa Bordi të miratojë euron si monedhë zyrtare.

Disa fjalë për politikën tonë monetare. Ajo gjithashtu është shumë e thjeshtë. Instrumenti i vetëm i politikës monetare është rezerva e detyruar. Kjo do të thotë se bankave tregtare iu kërkohet të mbajnë 10% të totalit të detyrimeve në llogarinë e rezervës së detyruar në bankën qendrore. Kjo është diçka që i detyron bankat të kenë likuiditet të mjaftueshëm, dhe njëkohësisht është një instrument me anë të të cilit ne mund të kontrollojmë aktivitetin kredidhënës.

Për ekonominë e përgjithshme të Bosnje dhe Hercegovinës, regjimi i bordit të monedhës tregon se është një zgjidhje e mirë dhe ka një ndikim me të vërtetë pozitiv në stabilitetin e çmimeve. Norma e interesit gjithashtu bazohet në normat e interesit në euro. Pra nuk ka luhatje të mëdha.

Ndërkohë, duke folur për sektorin bankar, Banka Qendrore e Bosnje dhe Hercegovinës nuk ka një rol rregullatori, por ne kemi një rol shumë aktiv koordinues midis agjencive bankare. Agjencitë bankare aktualisht janë rregullatorë bankarë, dhe sigurisht ato bazohen në Direktivat e BE-së dhe në parimet bazë. Pra, banka qendrore është e autorizuar të koordinojë veprimtaritë e tyre, dhe sigurisht, ajo luan një rol shumë aktiv në këtë drejtim.

Më lejoni ta ilustroj këtë që sapo thashë me një informacion për sektorin bankar, i cili është dhe pjesa më e shëndoshë e ekonomisë sonë. Bankat kanë fitim të konsiderueshëm, tregues me të vërtetë shumë të mirë të likuiditetit - 29.7% të totalit të aktiveve janë aktive likuide - dhe kapitalizimi është shumë i mirë; kapitali rregullator ndaj ekspozimit total të rrezikut është 17.5%, dhe jemi shumë të kënaqur që treguesi i kredive me probleme është në rënie graduale. Të dhënat

më të fundit tregojnë se ky tregues është 8.77%. Pra, mund të themi se ia kemi dalë të administrojmë relativisht në mënyrë të suksesshme kreditë me probleme.

Sot, aktiviteti kreditues është disi më i ngadaltë nga sa pritej. Por, ky është rezultat i situatës së përgjithshme ekonomike, mungesës së projekteve të konsiderueshme të investimit, papunësisë, etj.

Rreth 90% e bankave zotërohen nga grupe bankare të huaja dhe duket se është me të vërtetë diçka e mirë. Pesëmbëdhjetë vite më parë, për shembull, ne kishim rreth 40 banka. Pas proceseve të bashkimit dhe të përthithjeve, sot kemi 23 banka, 90% e të cilave janë me pronësi të huaj. Ne patëm një përvojë shumë të mirë me grupet bankare të huaja. Së fundmi, në bankën qendrore, kemi përfunduar një projekt për modernizimin e sistemit të pagesave, në lidhje me disa standarde që na mundësojnë të përfshijnë për shembull standardet SEPA. Ne ndryshuam platformën. Banka qendrore ka pasur sukses në mbështetjen dhe nxitjen e aspekteve të zhvillimit teknologjik të tregjeve financiare, duke mbështetur zgjidhjet e avancuara në sistemin e pagesave dhe duke i hapur ato për t'u zhvilluar. Qëllimi ka qenë të përmirësohet cilësia e shërbimeve të automatizuara, disponueshmëria e shërbimeve të sistemit të pagesave duke përdorur teknologjitë e reja. Banka qendrore ka punuar për standardizimin me BE-në, për rubrikat që kanë të bëjnë me pagesat ekstra duke futur standardet SEPA dhe duke vendosur zgjidhje teknike për klerimin e transaksioneve, përpunimin e një numri të madh pagesash nëpërmjet një numri të madh shlyerjesh e të tjera me radhë. Zgjidhja teknike vë theksin në sigurinë dhe disponueshmërinë e lartë të sistemit, ruajtjen inovative dhe të dhënat e hapura inovative.

Për sa i përket institucioneve financiare jobanka në Bosnje-Hercegovinë, ato nuk janë shumë të zhvilluara, por ne do të merremi shumë shpejt dhe me këtë çështje. Mendimi ynë është që të nisim të përgatitemi duke ndjekur direktivat e BE-së në këtë fushë. Sistemi ynë financiar bazohet tek bankat me një peshë shumë të lartë të aktiveve bankare në sektorin financiar, midis 84-90%. Në Bosnje-Hercegovinë, ashtu si dhe në vendet e tjera të EJL-së, reduktimi i numrit të degëve nuk është aq i dukshëm si në Evropën Qendrore dhe Evropën Veriore. Megjithëse klientët bankarë në Bosnje-

Hercegovinë padyshim ka më shumë të ngjarë të përdorin degët në krahasim me ata të bankave në Evropën Perëndimore dhe Veriore. Bankat në Bosnje-Hercegovinë duhet veçanërisht të marrin parasysh balancën midis numrit të degëve dhe kanaleve digjitale të shërbimeve financiare.

Në të ardhmen, industria bankare dhe financiare e Bosnje dhe Hercegovinës do të përballet me disa sfida që lidhen me fondet e investimit dhe konkurrencën nga institucionet financiare jobanka dhe procesi i asociimit në BE. Ne do të kemi pasoja nga adoptimi i kuadrit ligjor në lidhje me Direktivën e Shërbimit të Pagesave PSD 2, dhe gjithashtu ndiejmë efektin e ofruesve FinTech për aksesin financiar në operacionet e pagesave. Kështu që, bashkëpunimi i ngushtë midis FinTech dhe bankave do të jetë pjesa më e mirë për një rritje afatgjatë, duke pasur parasysh avantazhet e të dyjave. Shumë faleminderit! Kjo ishte gjithçka lidhur me Bosnje dhe Hercegovinën.

Moderatore Piroska Nagy-Mohacsi: Shumë faleminderit zonja Zëvendësguvernatore! Të kalojmë tek një vend që ka qenë gjithnjë pjesë e lajmeve, për një arsye apo tjetër, prej nga vjen dhe Zëvendësguvernatori Sologub, Ukraina. Ky vend ka kaluar një transformim fenomenal, me shumë sfida, që në fund të 2014-ës. Zoti zëvendësguvernator Sologub, cilat janë sfidat kryesore që ju shihni në vendin tuaj? Cilat kanë qenë arritjet dhe sfidat më të mëdha?

Zëvendësguvernatori Dmytro Sologub: Faleminderit Piroska! Së pari, bankingu qendror nuk ka qenë kurrë shqetësues në Ukrainë. Por, si kudo në botë, edhe në Ukrainë, bankingu qendror është një punë shumë interesante, një punë sfiduese. Dëshiroj të flas për sfidat që banka qendrore po has sot dhe si mund të zgjidhen ato, dhe të vë në dukje përvojën tonë. Në Ukrainë, ka shumë gjëra ideosinkretike, nga ana tjetër, është një ekonomi e vogël e hapur. Kështu që, sfidat që ne kemi si bankë qendrore janë shumë të ngjashme me ato që kanë kolegët tanë në vende të tjera.

Sot, pati një diskutim të mirë për shumë çështje, me të cilat përballen aktualisht bankat qendrore. Të jesh i suksesshëm për një bankë qendrore do të thotë të jesh proaktiv dhe largpamës, pasi është e rëndësishme të shohësh se çfarë ndryshimesh do të vijnë. Nuk është

e lehtë. Gjithashtu, duhet të vendosësh nëse ndryshimet janë të përkohshme apo të përhershme. Atë çfarë ne e quajmë "Një botë e guximshme", unë do ta quaja "Një normalitet të ri". Duhet të dallojmë se cilat gjëra janë normaliteti i ri real dhe cilat janë - të themi - normalitet i ri mashtrim.

Teknologjia në sektorin financiar përfundimisht është një normalitet i ri. Nuk ka asnjë mënyrë që ne të kthehemi pas lidhur me këtë fakt. Është mjaft e qartë. Dhe ne, bankierët qendrorë, duhet të jemi të ndërgjegjshëm për këtë. Lidhur me këtë, nuk do të zgjatem shumë pasi është diskutuar tashmë. Rëndësia në rritje e institucioneve financiare të reja - BigTech, FinTEch, monedha digjitale. Por, gjithashtu ka një aspekt të rëndësishëm të digjitalizimit, që janë digjitalizimi i praktikave mbikëqyrëse dhe politikës monetare. Sepse, përveç BigTech dhe FinTech, gjithashtu janë Reg Tech dhe SupTech, që do të thotë përmirësim dhe digjitalizim i praktikave mbikëqyrëse. Ne jetojmë në shekullin e 21 dhe për të kryer rolin mbikëqyrës bazuar në raportet në format PDF dhe Exel, duket se nuk nevojitet më. Ajo që dua të them është se, shumë gjëra mund të bëhen në kohë reale, kur ju shihni regjistrat, kur shikoni të dhënat e shumta të transaksioneve në kohë reale, e të tjera me radhë. Por, ka shumë probleme: privatësia e të dhënave; çështje që lidhen me sigurinë kibernetike, etj. Por për mua, është një normalitet i ri. Nuk ka asnjë mënyrë që ne të kthehemi pas lidhur me këtë fakt. Kush mund të analizojë dokumentet në format PDF në shekullin e 21? Kështu që kjo është një pjesë e rëndësishme.

Duke ecur më tej, për rajonin tonë, kemi parë një model në ndryshim të bankingut ndërkombëtar (gjë që u diskutua sot). Me të vërtetë, ka pasur një transformim thelbësor. Bankat ndërkombëtare kanë qenë shumë agresive këtu, para krizës financiare globale. Por, më pas u bënë shumë përpjekje, përfshirë dhe nga njerëz të pranishëm sot këtu, të cilët u përpoqën të kishin një sistem të rregullt që funksionoi në kulmin e krizës financiare globale. Për një zgjidhje më afatgjatë, sot shohim atë çfarë u theksua nga z. Wiedner në prezantimin e tij, grupet bankare në botë sot, veçanërisht në Evropë, zakonisht tregtojnë në tregun e aksioneve poshtë vlerës kontabël, çka është shumë depresive. Kështu që, bankat po kërkojnë modelin optimal, i cili përfundimisht nuk parashikon zgjerim ndërkombëtar

të rëndësishëm. Ndonjëherë, ajo parashikon tërheqje, ndonjëherë parashikon shkallë më të vogël penetrimi të veprimtarisë, duke u përpjekur të digjitalizohet, ashtu si treguan dhe kolegë nga banka të tjera. Ky është një faktor i rëndësishëm, i cili do të qëndrojë këtu (besoj). Sinqerisht, nuk mund të shikoj se si grupet bankare globale do të kthehen pas në regjimin ofensiv në tregjet e huaja.

Ne folëm për mjedis me norma të ulëta interesi. Në këtë fazë, është e vështirë të kuptosh sa do të zgjasë. Duket se arsyeja që qëndron pas kësaj është shumë strukturore. Kështu që, ky faktor është këtu për të qëndruar.

Tre faktorë të tjerë që dua të përmend janë:

Faktori i parë: ndryshimet thelbësore në modelin global të tregtisë dhe flukseve financiare. Ajo çfarë është interesante është se ne kemi parë vitet e fundit deglobalizimin e flukseve tregtare. Disa e quajnë atë rajonalizim, ndërsa të tjerë deglobalizim. Në fakt nuk ka të bëjë vetëm me flukset tregtare, por ka të bëjë dhe me Investimet e Huaja Direkte. Për shembull, në Ukrainë ne kemi folur shumë për nevojën që ka vendi që të tërheqë investime të huaja në atë shkallë që Polonia, Republika Çeke dhe Hungaria kanë tërhequr 15 vite më parë, kur u futën në Bashkimin Evropian, rreth 6-8% të PBB-së në vit. Por duket se kjo nuk është e lehtë. Kjo nuk ndodh për arsye të situatës së brendshme në Ukrainë, por sepse bota ka ndryshuar. Sot ju nuk shihni korporata globale që të jenë mjaft të fuqishme dhe të investojnë shuma të konsiderueshme. Me të vërtetë, ka pasur mjaft tërheqje në lidhje me panoramën e Investimeve të Huaja Direkte.

Nga ana tjetër, është interesant fakti se, aktualisht ka një integrim financiar global në rritje. Këtë vit, në Simpoziumin Jackson Hole Economic, i gjithë diskutimi ishte rreth përhapjes globale të politikës monetare të SHBA-ve në vendet në zhvillim, roli në rritje i dollarit amerikan, si ndikon ai tregjet në zhvillim. Me të vërtetë, nga kjo anë, duket se kemi globalizim. Çdo gjë duket të jetë kaq e lidhur për sa i përket politikës monetare.

Turbulencat gjeografike janë një faktor tjetër. Ndërsa flisja me kolegë që vijnë nga vende me ekonomi të zhvilluar, thashë se janë bankat

qendrore të tregjeve në zhvillim që gjithmonë përballen me pasiguri: në ekonomi; panoramën politike, etj. Në ekonomitë e zhvilluara motoja kryesore ishte: Në rregull, ne kemi ekonominë tonë, ne gjithashtu kemi modele makroekonomike të mira, të cilat herë funksionojnë më mirë dhe herë më keq. Por, ne mund t'i rregullojmë ato dhe po funksionojnë. Por, sot nëse shohim kolegët tanë në SHBA, ka probleme që nuk janë të lehta për t'u përcaktuar dhe për t'i integruar në modelet makroekonomike. Jay Powell, në fjalën e tij në Jackson Hole Symposium, në një farë mënyrë tha hapur: "Politika e tregtisë përcaktohet nga Kongresi. Ne nuk kemi të bëjmë fare me të". Banka qendrore e SHBA-ve ndikohet shumë prej tij. Kjo është arsyeja përse tensionet gjeopolitike janë shumë të rëndësishme.

E fundit është populizmi në rritje dhe presioni politik mbi bankat qendrore. Pra, shumë faktorë. Disa prej tyre përfundimisht do të jenë të pranishëm, disa, veçanërisht i fundit, shpresoj që të jetë krejt i përkohshëm. Gjithsesi, ajo çfarë bëni është se - unë mendoj që disa elemente të përgjigjes së politikës të bankave qendrore – qëndrojnë të njëjta në shkallë të lartë: zbatim i politikave makroprudenciale. Nuk mendoj se këta faktorë nuk mund të justifikojnë se duhet të jeni sot më pak të kujdesshëm me politikën tuaj monetare, se ju duhet të vazhdoni të shtypni para dhe t'i shpërndani ato me helikopter. Ukraina pati para me helikopter dhe përfundoi shumë keq.

E njëjta gjë me politikën fiskale. Në ekonomitë e zhvilluara, ka vende me hapësirë fiskale dhe ndoshta ato duhet t'i përdorin ato. Por, në ekonomitë në zhvillim, nëse shihni rreth e rrotull, kujdesi fiskal ka qenë i shkëlqyeshëm vitet e fundit dhe ne kemi parë shumë përmirësime në borxhin publik, raportet e PBB-së, bilancet qeveritare, etj. Ukraina është një nga shembujt në këtë drejtim. Ne kemi pasur një episod të ristrukturimit të borxhit publik në vitin 2015, borxhi i jashtëm. Në atë kohë raporti i borxhit publik ndaj PBB-së ishte mbi 80%. Sot është i ulët, 50%. Nuk është vetëm për shkak të ristrukturimit, sepse vendi e kaloi këtë problem, por është gjithashtu për shkak të ndjekjes së politikave të kujdesshme fiskale dhe monetare.

Faktori i dytë i rëndësishëm janë politikat makroprudenciale. Kjo ka qenë një tendencë e lartë në 20 vitet e fundit, por është aty për

të qëndruar. Bankat qendrore po punojnë shumë për të kombinuar politikat makroprudenciale dhe monetare. Kemi parë shumë diskutime akademike dhe diskutime të politikës, pra është bërë një instrument i rëndësishëm i politikëbërjes së bankës qendrore.

Faktori i tretë janë politikat mikroprudenciale. Mosmarrëveshjet që bankat duhet t'i rregullojnë në mënyrë të kujdesshme dhe gjithëpërfshirëse, Bazel III, lufta kundër pastrimit të parave, etj.

Këto çështje janë dhe në agjendë.

Cilat janë elementet e reja të tërësisë së instrumenteve të bankingut qendror? Të flasim rreth teknologjive financiare. Sot shohim në Ukrainë, rolin në rritje të kompanive financiare jobankë. Është e rëndësishme të sigurojmë atë që e quajmë "banking të hapur" sepse, në fund të ditës, sistemi financiar duhet të sigurojë ndërmjetësim efektiv, kanalizim të kursimeve në investime. Dhe kjo duhet të jetë jo vetëm nga bankat. Nëse shohim sot, shërbimet financiare po përmirësohen, dhe ne shohim digjitalizim. Është gjithmonë banka qendrore që duhet të ketë një sistem ku ka një konkurrencë mjaft të drejtë. Kjo është njëra anë. Ana tjetër është rregulli, sepse si bankë qendrore ju duhet të nxisni përfshirjen financiare, për të cilën jam dakord me Guvernatorin Sejko. Sot, rajoni ka një problem të madh, për shkak të ekonomisë joformale, kulturës financiare, etj. Nga ana tjetër, rregulli është i rëndësishëm. Sot, në Ukrainë jemi në proces ndryshimi të kuadrit tonë mbikëqyrës. Ne kemi pasur tre rregullatorë të sektorit financiar. Kështu që, ne si bankë qendrore, jemi rregullatorë të sistemit bankar. Por, gjithashtu ne ishim rregullator i komisionit të letrave me vlerë dhe i institucioneve financiare jobanka, përgjegjës për të rregulluar kompanitë e sigurimeve, unionet e kreditit dhe institucione të tjera financiare jobanka. Sot, ky rregullator është shpërbërë, dhe përgjegjësia e mbikëqyrjes së kompanive financiare jobankë i është ngarkuar shumë bankës qendrore. Nga njëra anë, mendoj, se kjo do të thotë akoma më shumë punë për mua dhe kolegët e mi, nga ana tjetër mendoj, se është e rëndësishme në këtë botë të re me shumë ndërlidhje midis bankave, kompanive financiare jobanka. Tregjet në zhvillim kanë shumë probleme me institucionet. Mendoj se është më mirë të kemi më pak rregullatorë institucionalë, por më të fuqishëm, se sa të kemi një sistem të shpërndarë dhe të decentralizuar të rregullatorëve financiarë.

Ndërsa, çështja ofron akses të hapur ndaj shërbimeve financiare të bankave dhe jobankave për klientët, duke pasur mbikëqyrje të përshtatshme, sigurimi i mbikëqyrjes së duhur është tejet i rëndësishëm. Domethënë, është e drejtë të prezantohen praktika të reja mbikëqyrëse, - siç dhe e përmenda - duke përdorur Big data, RegTech, SupTech, etj.

Lidhur me politikën monetare. Çfarë shihni sot është se njerëzit flasin shumë. Shihni raportin e fundit vjetor të BIS, i cili flet për rritjen e ndërhyrjes tuaj në tregun valutor. Domethënë shumë vende po zbatojnë shënjestrimin e inflacionit. Shënjestrimi i pastër i inflacionit nisi kur ju shënjestroni vetëm inflacionin dhe asgjë tjetër. Kjo mund të funksionojë për ekonomitë e zhvilluara, të cilat e kanë prezantuar të parat atë, sepse tregjet financiare ishin të maturuara. Kur shënjestrimi i inflacionit filloi të përhapej në tregjet në zhvillim, dhe sot ne kemi akoma më shumë integrim financiar, është mjaft e qartë se nevojitet një nivel i caktuar i administrimit të kursit të këmbimit. Ne jemi përballur me të tashmë, pasi na u desh të prezantonim pesë vite më parë shënjestrimin e inflacionit, kur humbëm të gjitha rezervat dhe duhej të ndryshonim regjimin e politikës monetare. Ne braktisëm kursin fiks të këmbimit, i cili ishte aty prej 20 vitesh. Por, që nga fillimi nuk kishte asnjë alternativë për ne, përveç se shënjestrimit të inflacionit që të përdornim ndërhyrjet në këmbimet valutore. Ne po i përdorim ato në mënyrë shumë transparente. Në faqen tonë të internetit ka një strategji për ndërhyrjet në këmbimet valutore, ku në mënyrë eksplicite themi: se kemi ndërhyrë në treg vetëm për të zbutur luajtjet dhe për të plotësuar rezervën valutore. Ne nuk japim udhëzime numerike për nivelet e kursit të këmbimit dhe luhatshmërinë. Përpiqemi të përdorim një parim të ambiguitetit konstruktiv dhe ne sigurisht në mënyrë mjaft të hapur themi se nuk po luajmë kundër fondamenteve. Në qoftë se shihni kursin e këmbimit fondamentalisht jo të balancuar, ne do të përpiqemi të shkojmë në nivel fondamentalisht të justifikuar. Por, roli i ndërhyrjeve valutore, i cili është theksuar në raportin e BIS, me të vërtetë është i rëndësishëm.

Pika e fundit, që do të përmendja është përballja me problemin e populizmit dhe presionit politik ndaj bankës qendrore. Aktualisht janë komunikimi dhe transparenca. Bankat qendrore e bënë

kapërcimin e madh nga të qenurit institucione shumë të mbyllura 40 vite më parë. Zoti Greenspan ka thënë: "Në qoftë se them diçka që ju e kuptoni plotësisht do të thotë se ndoshta kam bërë një gabim". Sot, ato janë plotësisht të hapura. Komunikimi shihet në mënyrë të konsiderueshme si instrument i politikës monetare. Përpiqemi të jemi në krye për këtë. Kohët e fundit, kemi qenë shumë agresivë lidhur me këtë dhe jam shumë i kënaqur që përpjekjet tona janë të njohura, pasi Banka Kombëtare e Ukrainës është konsideruar si banka qendrore më transparente në botë. Dhe ne me të vërtetë po i kushtojmë shumë vëmendje transparencës, duke përdorur dhe mjete të reja si media digjitale. Për shembull, Guvernatori ka llogari në platformën Twiter, në Facebook, Instagram, etj. Këtë vit, ne u renditëm banka e tetë qendrore në botë, e cila publikon projeksionin e normës së interesit. Për këtë, ne kemi zhvilluar një diskutim prej gjashtë muajsh në bankë, gjithashtu diskutuam gjerësisht me kolegët tanë në banka të tjera qendrore, FMN-në, etj. Nuk ka qenë një zgjedhje e lehtë. Por, deri më sot ka shkuar mirë. Sot, shoh që është një instrument i rëndësishëm komunikimi.

Moderatore Nagy-Mohacsi: A është publikimi i këtij projeksioni një lloj orientimi nga e ardhmja?

Zëvendësguvernatori Sologub: Është si një grafik (*fan chart*) që përmban seri me të dhëna kohore. Ne publikojmë parashikimin se ku do të jenë normat tona të interesit në 18 muajt e ardhshëm. Por përsëri, ajo çfarë përpiqemi të theksojmë është fakti që nuk është një angazhim, por është një parashikim. Nuk është se po kështilloj bankat qendrore që të bëjnë dhe ato këtë gjë. Në ekonomitë e zhvilluara, ku tregjet janë mjaft të edukuara dhe ku i kushtojnë shumë vëmendje çdo fjale të guvernatorit të bankës qendrore, mund të jetë një instrument diferencues. Në tregjet në zhvillim, ku njerëzit dhe tregjet financiare nuk janë aq të sofistikuara, dhe jo aq të edukuar në lidhje me atë se çfarë bën banka qendrore, ju i ofroni atyre ato projeksione të normave të interesit si pjesë informacioni shtesë për politikën monetare. Mendoj se mund të funksionojë.

Moderatore Nagy-Mohacsi: Shumë faleminderit! Mendoj se disa prej elementeve, në veçanti, komunikimit dhe transparencës, mund t'i rikthehemi përsëri pak më vonë. Mund të vazhdojmë me Ardo

Hansson, ish-Guvernator i Bankës Qendrore të Estonisë. Ju, gjithashtu keni mbajtur një pozicion sfidues. E njëjta pyetje shtrohet edhe për ju. Sigurisht, mund të jepni dhe mendimet tuaja mbi çështjet e ngritura nga guvernatorët.

Ish-Guvernatori Ardo Hansson: Së pari, falënderoj organizatorët që më ftuan në këtë Konferencë!

Kam qenë këtu 15 vite më parë dhe shoh një ndryshim të madh. Pra, është bukur të kthehesh përsëri.

Ne jemi në Eurozonë, dhe si bankierë qendrorë na duhet të kryejmë dy role: Duhet të flasim si për çështje të Eurozonës dhe për ato vendore. Mendoj se, për pjesën më të madhe të kësaj audience, problemet e Eurozonës janë më të rëndësishme.

Pika fillestare mendoj se është viti 2017. Ai ka qenë një vit fenomenal. Nuk e di si ka qenë këtu, por mendoj se nuk e kuptuam në kohë se sa vit i mbarë ishte në botë: tregtia lulëzonte; Kina po ecte mirë; të gjithë po ushqenin njëri-tjetrin. Po zhvillohej një cikël virtual dhe në vendin tonë patëm një normë rritjeje të PBB-së 4.5% atë vit, dhe rezultate të mira edhe në Eurozonë. Gjithçka ishte mbi normën potenciale të rritjes. Atë vit, gjërat u zhvilluan shumë shpejt, nga të mësuarit me një situatë ku hendeku i prodhimit ishte negativ, në një pikë ku pjesa më e madhe e vendeve patën një hendek pozitiv të prodhimit, që do të thoshte se po operonin mbi potencial. Le të hamendësojmë se kemi arritur një pikë e cila është mbi potencial. Atëherë, duke ecur para, ne duhet të hamendësojmë se do të duhet të ecim pas, në atë situatë të punëve, që do të thotë ndoshta, normat e rritjes që ecin para do të janë pak të ulëta. Mendoj se matjet e rritjes potenciale të PBB-së janë rreth 1.5%. Mund të mos konsiderohet si rezultat i mirë, por për arsye strukturore kjo është një lloj norme e rritjes potenciale. Për shembull BQE-ja, parashikon një normë rritjeje potenciale të prodhimit në vitet e ardhshme prej 1.1, 1.2 ose 1.5. Nuk është dhe aq keq. Mendoj se një pjesë e mirë e kësaj pritej. Ka pasur një ndryshim në sjellje, në botë dhe gjithashtu në Evropë gjysmën e dytë të vitit të kaluar. Rezultatet kanë qenë sistematikisht më të këqija se parashikimi. Sinqerisht, mendoj se lidhet me tre fjalë, të cilat janë: populizmi, gjeopolitika dhe lufta tregtare.

Nëse shohim katër ekonomitë më të mëdha në Evropë: Mbretëria e Bashkuar ka problemin e saj të Brexit; Gjermania ka probleme strukturore në industrinë e makinave dhe gjithashtu atë të ekspozimit ndaj industrisë globale të përpunimit. Nëse kemi luftë tregtare, ato veçanërisht ndikojnë Gjermaninë. Në Francë, industria përpunuese po ecën mjaft mirë, por ajo e shërbimeve është goditur shumë. Kur ka demonstrata çdo javë, njerëzit nuk mund të shkojnë në dyqane, dhe në fund të ditës duhet të ketë një lloj ndikimi. Më pas kemi politikën makroekonomike të Italisë.

Kështu që, në qoftë se keni të gjithë këtë lloj politike apo populizmi të keq drejtuar, në fund të ditës duhet paguar një çmim për këtë. Mendoj se pjesë e asaj që po shohim është një rezultat i gjithë populizmit dhe i politikave jo të mira (duhura).

Deri rreth një vit më parë, ne ecëm përgjatë një rruge të këndshme daljeje, pasi kishim arritur mbi normat e prodhimit potencial, inflacioni kish nisur të rritej. Kështu që dukej se ishim në rrugën e daljes. Gjithë kjo zbutje erdhi - e cila mendoj se çoi në të rimenduarin fondamental - jo vetëm në Evropë, por gjithashtu edhe në vende të tjera.

Megjithatë, nëse shohim zhvillimet në tregun e punës, shohim se gota është më shumë gjysmë e mbushur sesa bosh. Mendoj se reagimi i politikës ka qenë relativisht në asimetri me problemin, por kjo mund të debatohet.

Në frontin mbikëqyrës evropian, ka disa sfida. Një është problemi i kredive me probleme, që është diskutuar, dhe i dyti ka të bëjë me problemin e bilancit, është rishikimi i modeleve të brendshme të bankave. Ka një dëshirë për të shqyrtuar cilësinë e këtyre modeleve, për të parë nëse kapitali raportohet në mënyrë të saktë. Mendoj se është një angazhim në të gjithë Eurozonën. Atëherë çështja tjetër është shqyrtimi i modeleve të aktivitetit të bankave, për të parë se mund të ulen kostot.

Çështja e tretë, mendoj se është rreziku kibernetik. Bankat po bëhen gjithnjë e më shumë teknologjike. Mendoj se disa nga bankat më të mëdha, nëse numëroni personelin, mund të shihni se ndoshta,

gjysma e tyre janë specialistë të TI-së. Kështu bankat, po kthehen më shumë në ndërmarrje të TI-së, për më mirë apo për më keq. Mbikëqyrësit që analizonin kapitalin, që hulumtonin problemet në mbikëqyrjen e tregut, tani duhet të merren edhe me këtë problem të tretë, që është rreziku operacional i lidhur me qëndrueshmërinë kibernetike.

Lidhur me ekonominë estoneze, çekuilibri ynë më i madh makroekonomik është se tregu ynë i punës po rritet me shpejtësi. 12 vite më parë, të gjitha disbalancat ishin në sektorin financiar, flluska masive të pronës. Sot, shohim gjithë këtë konvergjencë në tregun e punës. Sigurisht, kjo duhet të jetë e mirë për punëtorët, votuesit, etj. Rritja e pagës ka qenë mesatarisht rreth 7% për vit gjatë 6 viteve të kaluara. Mendoj se është tipar i përbashkët i pjesës më të madhe të vendeve lindore të reja që janë anëtare të BE-së, ku shohim rritje gati dyshifrore të pagave. Bankierët qendrorë, sigurisht shqetësohen për këtë, pasi ju analizoni koston e punës dhe keni frikë se konkurrenca mund të bjerë gradualisht. Është një sfidë mjaft e madhe, dhe një bankë qendrore nuk mund të bëjë shumë për këtë gjë, por ajo ndërlikon administrimin makroekonomik.

Bankat e huaja të mëdha, po tërhiqen nga tregu, dhe ky është një fakt i qartë. Pjesë e kësaj vjen nga fakti se ajo çfarë pamë 12 vite të shkuara ishte tepricë absolute, bollëk tërësisht jashtë kontrollit. Për të ilustruar mendimin tim, 12 vite më parë, ne do të kishim pasur një raport hua ndaj depozitës prej 1.7: 1, pasi këto banka mbështeteshin në financimin nga bankat mëmë dhe ne patëm këtë rritje masive të kredisë. Me të vërtetë, zgjoheni më pas dhe shihni se kemi shkuar mjaft larg. Të zbresësh nga 1.7 në 1.0 ku jemi aktualisht, lidhet shumë me rënien e vëllimeve. Vëllimet e kredisë u rritën mjaft dhe bankave iu desh të tërhiqeshin për të gjetur një normale të re. Mendoj se kjo lë vend për bankat vendase, ato të vogla. Bankat e mëdha duan të bëhen të lira, në modelet e tyre të veprimtarisë, kështu që ato ofrojnë produkte shumë të standardizuara. Ato lenë një hapësirë të konsiderueshme aktiviteti për bankat e vogla, pasi ato janë më të zhdërvjellëta, mund të ofrojnë zgjidhje të përshtatura me situatën; ato mund të ulen me klientët të cilët, për shembull "Nord bank", i braktisi kur u largua. Disa prej bankave të vogla janë në formë të mirë.

E dyta është çështja, për të cilën folëm dhe në mëngjes, administratorët e aktiveve, të cilët kanë filluar të luajnë një rol më të madh.

Kur zotëruesit e bankave donin të tërhiqeshin, ata me xhepa më të mëdhenj dhe që kërkonin vend tjetër ku të vendosnin paratë e tyre, janë administratorët e fondeve. Ne kemi pasur një rast kur dy banka nordike i bashkuan bankat bashkë dhe ia shitën ato Blackston. Kështu, ky fenomen i ri, i ngjashëm me të pasurin një lloj fondesh të mbrojtura si zotëruesit.

E fundit, një zhvillim i ri i cili nisi në disa vende nordike, janë supermarketet që po marrin një rol më të madh sesa ai i një agjenti të thjeshtë të shitjeve me pakicë, duke u kthyer në banka në rajon e me radhë. Kështu, supermarketet po kthehen në pika ku mund të marrësh shërbime postare, të marrësh shërbimet bankare bazë dhe ku mund të blesh ushqime. Ky është një zhvillim shumë inkurajues, një lloj kostoje e ulët, produkte të thjeshta që mund të blihen. Lidhur me përfshirjen financiare, është një tendencë që duket se po bëhet mjaft popullore dhe madje dhe me përfitim. Ky është këndvështrimi im, dhe mendoj se do ndaloj këtu.

Moderatore Piroska Nagy-Mohacsi: Shkëlqyeshëm! Shumë faleminderit! Do të vazhdojmë me Mario Blejer, i cili ka qenë dhe Guvernator i Bankës së Argjentinës dhe i Bankës së Anglisë. Ndoshta, Mario mund të flisni gjithashtu dhe për çështjen e transparencës.

Ish-guvernatori Mario Blejer: Shumë faleminderit! Dua të falënderoj Guvernatorin Sejko për ftesën. Është gjithmonë kënaqësi të vish në Tiranë. Kam kujtime shumë të mira këtu, që kur Shqipëria nisi reformat e saj. Është shumë e rëndësishme për mua të kthehem këtu dhe të shoh se si po zhvillohen gjërat.

Dua të bëj disa komente të përgjithshme se ku qëndron me të vërtetë teoria e bankingut qendror, e cila është pjesë e teorisë monetare.

Mendoj se me të vërtetë jemi në konfuzion. Do të përpiqem të shtroj disa pika në mënyrën si unë i shoh, dhe si përshtaten ekonomitë në zhvillim në këtë kuadër.

Ne jemi në konfuzion sepse, më parë kishim disa siguri. Mendoj në fakt se kemi pasur disa siguri. Ne kishim një siguri mjaft të qartë: ne e "dinim" se normat e interesit nuk mund të jenë negative. Sot, është e mundur që normat e interesit të jenë negative. Ne e "dinim" se paraja e tepërt nuk çonte në inflacion. Sot problemi qëndron në faktin se si do t'ia arrijmë të prodhojmë inflacion me më shumë para. Paraja nuk duket se krijon inflacion, të paktën ende jo, apo ne nuk jemi duke e matur saktë atë çfarë masim. Ne pamë se pasuria rritej me të ardhura nominale; pamë se në qoftë se ulim normat e interesit, atëherë do të kishte më shumë kërkesë për kredi, por në fakt ka më pak. Pra, mendoj se kemi shumë pyetje që nuk dimë si t'u përgjigjemi.

Në të njëjtën kohë, ne mund të besojmë se dimë si të përgjigjemi. Kjo është mënyra si e thellojmë konfuzionin.

Mendoj se janë një tërësi parametrash. Ky konfuzion nuk është i kufizuar vetëm në çështje të politikës monetare në bankingun qendror, por ka gjithashtu konfuzion lidhur me çështjen e strukturës së politikës monetare. Si i përcaktojmë ne institucionet është gjithashtu çështje për diskutimin aktual.

Rreth problemit për të njohur ose jo faktin që bankat qendrore janë institucione politike, ato janë pjesë e instrumentit politik që ka qeveria. Kjo mund të mos jetë korrekte, por mbetet një fakt. Sepse është një njollë që bankat qendrore bëhen objekt i presionit politik. Ka disa lloj "hilesh" që duhen shmangur. Por fakti është se bankat qendrore janë objekt i një presioni të konsiderueshëm politik.

Gjithashtu, ka konfuzion për mënyrën e funksionimit të bankës qendrore. Mendoj se është shumë e qartë që instrumentet që ka banka qendrore janë të veçanta, të ndryshme nga ato të Qeverisë. Por pyetja që shtrohet është: si duhen përdorur ato apo si të maksimizohet efekti i politikës monetare?

Një fushë ku unë kam vërejtur gjithashtu shumë konfuzion janë produktet e informacionit. Çfarë informacioni duhet publikuar dhe kur? Me fjalë të tjera, sa transparente duhet të jetë banka qendrore dhe sa transparente duhet të jenë politikat e bankës qendrore?

Ka qenë një kohë kur ne nuk kishim një diskutim për transparencën në bankën qendrore, pasi teoria monetare i përgjigjej asaj në mënyrën e duhur. Ajo thoshte: nëse nuk surprizoni tregun, atëherë ne nuk kemi asnjë efekt. Politika monetare ka efekt vetëm në qoftë se ajo surprizon. Lucas, një akademik radikal nga Chicago, që fitoi çmimin Nobel për këtë teori, ka thënë se: "Vetëm goditjet monetare që surprizojnë tregun, që nuk vijnë nga një politikë transparente, që nuk vijnë nga një politikë e pastër, janë ato të cilat me të vërtetë surprizojnë tregun". Por kjo ka ndodhur. Shumë njerëz e ndoqën atë teori: pak transparencë për surprizim maksimal të tregut. Është e qartë se kjo pikëpamje ka ndryshuar. Natyra e një pjese të madhe të teorisë që ekzistonte më parë, për shembull kurba Philips, lidhja negative midis inflacionit dhe prodhimit. Ideja është që, në qoftë se keni pritshmëri racionale, në qoftë se keni njohje të plotë të asaj se çfarë po ndodh, nuk ka asnjë mënyrë për dakordësi. Ju vetëm mund të keni një dakordësi të përkohshme midis politikës monetare dhe rritjes ekonomike, në qoftë se veprimet tuaja po surprizojnë tregun.

Pyetja që shtrohet është se cila është zgjedhja optimale që duhet të bëjë një bankë qendrore? Mendoj se një mënyrë për ta analizuar këtë është roli i transparencës, roli i informacionit për bankën qendrore, çfarë përpiqen bankat qendrore të bëjnë dhe çfarë jo. Mund ta shohim këtë në një model të përgjithshëm.

Bankat qendrore përpiqen ta maksimizojnë këtë funksion, në përgjithësi nëpërmjet: efektivitetit të politikës monetare; dhe stabilitetit dinamik të tregut financiar. Këto janë dy objektivat e bankës qendrore.

Çfarë është efektiviteti? Efektiviteti është aftësia për të prodhuar një rezultat të qëndrueshëm me koston më të ulët të mundshme dhe me shpejtësinë më të lartë të realizueshme. Pra, keni një përkufizim të qartë se çfarë bankat qendrore bëjnë; dhe e dyta është stabiliteti dinamik i tregut financiar. Përse duhet të flasin bankat qendrore për stabilitet dinamik? Sepse, stabiliteti i tregut financiar - të cilin mund ta arrini duke vendosur rregullore dhe të përfitoni situatën që keni - është stabiliteti i simetrisë, në të cilin ju nuk lëvizni. Ju duhet të keni stabilitet që bën të mundur apo ofron incentiva për investime dhe për rritje ekonomike.

Nëse i keni këto të dyja bashkë, atëherë ju maksimizoni objektivat: efektivitetin dhe stabilitetin dinamik të tregut financiar.

Megjithatë, bankat qendrore janë subjekt i kufizimeve. Ka kufizime buxhetore; gjithashtu ka paragjykime për objektivat e politikës sonë. Bankës qendrore i kërkohet, ose ndryshe vihet në presion, që të përmbushë objektiva të caktuara politike. Ato janë më së shumti ekonomike, por që i caktohen bankës qendrore nga qeveria. Qeveria ka disa objektiva dhe banka qendrore duhet të guxojë të luajë një pjesë të saj në një mënyrë specifike.

Sistemi politik kufizon shkallën e objektivave që banka qendrore ndjek për veten e saj. Por do të thotë të japësh një çmim për këtë. Çfarë po jep banka qendrore për këtë? Së pari, një instrument. Ato janë instrumente monetare, ato janë monopol në emetimin e parasë, por monopoli në një masë të konsiderueshme ndahet me bankën. Por, gjëja më e rëndësishme është që, banka qendrore ka aftësinë të zhvillojë një instrument, të cilin jo të gjitha institucionet mund ta kenë. Dhe ky instrument është besueshmëria. Është kërkesë që të zhvillosh besueshmëri sepse ai është aset i një banke qendrore. Jo kapitali për të cilin flasin njerëzit: kapitali i bankës qendrore. Mendoj se një bankë qendrore ka nevojë për besueshmëri. Me qëllim që të arrijmë rezultatet për efektivitetin dhe stabilitetin duke përdorur instrumentet që ka banka qendrore, ato duhet të kenë besueshmëri dhe gjithashtu të kenë pavarësi. Pavarësia e bën bankën qendrore më të besueshme, sepse edhe nën presionin politik, dhe kur janë të pranishme të gjitha llojet e kufizimeve, ato kanë nevojë për pavarësi me qëllim që të mund të arrijnë besueshmëri dhe të transmetojnë objektivat që ka banka qendrore.

Me qëllim që të kihet besueshmëri, dhe veçanërisht pavarësi, ajo çfarë kërkohet është transparenca. Kështu që, transparenca, së bashku me idenë për pavarësi dhe me sistemin e shënjestrimit të inflacionit u bë e përgjithshme. Sa transparente mund të jetë një bankë qendrore?

Transparenca mund të reduktojë shkallën e arritjes së objektivit. Transparenca nuk mund të arrijë një gjurmim, fuqi në tregun e parasë apo në tregun financiar, në qoftë se gjëja e vetme që bën është të largojë efektin surprizë. Pra, nga njëra anë ka një problem. Nga ana

tjetër, kemi transparencën, por nuk kemi pavarësi dhe besueshmëri. Pra transparenca ka efekt të dyfishtë. Si ka thënë dhe Alan Greenspan: "Në qoftë se ju duhet të zgjidhni midis murmuritjes dhe të thënit të së vërtetës, atëherë, zgjidhni murmuritjen". Ai mendonte se çdo gjë çon në ekzagjerim të transparencës, deri diku do të pengojë objektivat e bankës qendrore. Sepse, ai thoshte, ekziston një mungesë simetrie në këtë rast. Sektori privat, nuk ndan objektivat dhe strategjitë me bankën qendrore, por bankës qendrore i duhet të ndajë objektivat me sektorin privat. Kjo është një tepri e transparencës. Është thënë se Fed-i ka ndryshuar tërësisht, në vend të të pasurit të një problemi të mungesës së transparencës; ata u përpoqën të bënin tregun të besonte se Fed-i dinte gjithçka. Kështu, në një moment kur mbledhja përfundon, minutat e mbledhjes, mijëra copa të dhënash shpërndahen nëpër shtete. Kjo rrit konfuzionin. Pra kemi këtë efekt të dyfishtë. Si e mbyllim këtë sistem të veçantë? Mund të kemi hamendësime të shumta, por diçka është shumë e qartë.

Me qëllim që të përmbushim këtë objektiv, ju keni nevojë që të keni besueshmëri, sepse besueshmëria rrit efektivitetin. Për të pasur besueshmëri keni nevojë për transparencë, e cila gjithashtu ndikon efektivitetin e bankës qendrore. Pra, ju duhet të synoni për një nivel optimal të transparencës. Por ky nivel i transparencës është kompromis midis transparencës dhe besueshmërisë. Por çfarë është në fund të ditës besueshmëria? Besueshmëria është besimi i njerëzve se ju do ta kryeni atë që keni premtuar të bëni, jo sepse është më e mira, por sepse ju premtuat ta bëni. Kështu që, bankat qendrore, pa pasur nevojë për një nivel të tepërt transparence, do të jenë më mirë.

Mësimi në të cilin dua të vë theksin është se problemet për të cilat ne nuk kemi pse të jemi kaq të shqetësuar është se besueshmëria e bankës qendrore ndërtohet mbi disa elemente, të cilat nuk kanë të bëjnë vetëm me transparencën e veprimtarisë.

Nëse analizojmë objektivin e një banke qendrore, për të maksimizuar efektivitetin dhe stabilitetin dinamik nëpërmjet rregulloreve dhe nëpërmjet politikës monetare, unë kam mendimin se ajo çfarë ju duhet është pavarësia. Ju duhet të përpiqeni të gjeni një rrugë në të cilën nuk jeni nën presion për të adoptuar instrumentet tuaja ndaj kufizimeve të imponuara.

Mendoj se do të ishte një ide e shkëlqyer të privatizohen bankat qendrore. Në qoftë se privatizohet banka qendrore, atëherë e bëni të qartë se keni aktive në sektorin bankar, nuk do t'ju duhet të keni transparencë të tepërt, dhe do t'ju duhet të plotësoni vetëm detyrimet. Do të jeni në pozicionin që t'i rezistoni ndoshta më mirë presionit politik, dhe niveli i transparencës, publikimi i të dhënave do të jenë të njëjtë, optimalë për tregun sepse do të jetë si sektori privat.

Kështu që, arrij në përfundimin - në moshën time - që bankat qendrore të privatizohen. Ishte një fushatë standarde për privatizimin e bankës qendrore. Pyetja që lind është, nëse kjo do të përmirësojë eficiencën rregullatore? Unë mendoj se në një farë kuptimi, tregjet në zhvillim nuk duhet të ndjekin modelin e vendeve më të zhvilluara. Për shembull, shënjestrimi i inflacionit, shihni sa shumë gabime janë bërë, dhe në këtë skenë strukturore, mendoj se ka shumë probleme. Pra, le të shohim se cili do të jetë vendi i parë që do të privatizojë një bankë qendrore?

Moderatore Piroska Nagy-Mohacsi: Faleminderit Mario! Sot, këtu në Tiranë, Shqipëri, ju keni folur për një revolucion. Një ide revolucionare për t'u kthyer pas në bankingun qendror, nga të qenurit institucion publik, për t'u privatizuar. Disa mendime provokative nga Mario mbi efektivitetin e transparencës nën dritën e teorisë së politikës monetare.

Kthehemi tek Erik Berglof, të cilin, duhet ta prezantoj më gjatë. Unë përmenda lidhjen tuaj me LSE-në, por sigurisht ju jeni shumë i njohur, veçanërisht për rolin tuaj si Këshilltar i Presidentit dhe Kryeekonomist i Bankës Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim. Atje ju keni punuar për nëntë vite dhe kryet një revolucion në rolin që ekonomistët luajnë në institucionet publike, duke ndihmuar në analiza, dhe gjithashtu, duke informuar për vendimet e veprimtarisë bazuar në evidenca solide. Erik, nëse jeni dhe ju dakord, kemi dëgjuar shumë për bankingun qendror në këtë panel, natyrisht nga guvernatorët aktualë dhe ish-guvernatorët, por në punën tuaj të kohëve të fundit, keni marrë pjesë në dy përpjekje globale shumë interesante për të forcuar institucionet dhe bashkëpunimet shumëpalëshe. Njëri ishte "Grupi i Njerëzve të Shquar të G20", të cilët ofruan dhe raportin e tyre një vit më parë. Por më pas, gjithashtu

keni qenë anëtar i një grupi pune rajonal "Grupi Evropian i Nivelit të Lartë të Njerëzve të Urtë" kryesuar nga Thomas Wieser. Ju sapo keni publikuar Raportin, i cili me të vërtetë shkon në thelb të asaj - për aq sa unë e kam kuptuar - se si e mendon Evropa veten e saj, si i identifikon me të vërtetë zhvillimet; dhe identiteti evropian në fushën e politikave të huaja dhe të zhvillimit. A mund të na flisni pak për çështjet kyçe, përveçse komenteve që ju keni? Dje, ju folët për një grup të vogël të nivelit të lartë. A mund të ndani gjithashtu disa ide rreth asaj se ku na çon saktësisht identiteti evropian, në lidhje me zhvillimin e një politike të re zhvillimi?

Erik Berglof, Drejtor, Instituti LSE për Çështje Globale: Faleminderit Piroska! Kemi pasur një panel të gjatë me diskutime dhe unë kam fatin të jem i fundit që të ofroj mendimet e mia në këtë raund. Pra, mund të komentoj mbi këtë pikë, por mendoj se lidhur me atë se çfarë ishin këto dy grupe apo komisione, është folur tashmë sot. Më herët, na u bë një kërkesë, një pyetje e pafajshme se "Ju keni globalisht gjithë këtë likuiditet dhe ne nuk shohim aspak që me të vërtetë të vijë në vendet në zhvillim". Sigurisht mund të bëni pyetjen: "Pse ndodh kjo?" Për mendimin tim kjo është pyetja fondamentale dhe qëndron pikërisht në fokus të punës së "Grupit të Njerëzve të Shquar". Ne ngritëm pyetjen "Si ta ndërtojmë sistemin, një sistem financiar global, i cili e bën kapitalin të shkojë nga vendet e pasura me kapital në vendet e varfra me kapital?". Si e arritëm ne këtë rol transformues të kapitalit? Folëm sot rreth investimeve të huaja direkte të synuara, në prodhim dhe shërbime. Sigurisht, bankingu është pjesë e tyre dhe si e arrijmë ne që kjo të funksionojë; si ia arrijmë që këto flukse të kthehen? Sepse, po në mënyrë të qartë ishim të shokuar në periudhën që çoi në krizën financiare globale, por gjithashtu ishim të shokuar kur iu përgjigjëm krizës financiare globale.

Duket, së paku, dua të jetoj me shpresën se mund të gjejmë një rrugë përsëri për ta bërë kapitalin që të rrjedhë, dhe përsëri të gjejmë një rrugë për të lëvruar paratë e sektorit privat në sektorët në zhvillim. Të dy këto ushtrime kishin të bënin shumë me atë si arrihet që arkitektura financiare të funksionojë më mirë, si në nivel global dhe në atë evropian. Kjo kërkon masa në shtetet pritëse. Ka të bëjë me reduktimin e rrezikut; - puna që bën banka qendrore është pjesë e kësaj - me klimën e investimeve; "Zbatimin e ligjit"; si dhe me

ndërtimin e tregjeve financiare vendore që mund të jenë gjithashtu partnerë të kapitalit global që futet. Sigurisht, një investitor global apo një investitor ndërkombëtar ka më shumë të ngjarë që të vijë nëse ka partnerë vendorë që mund të kenë vënë piketa në atë investim.

Shumë prej këtij likuiditeti, globalisht është kapital institucional. Dhe është ai kapital institucional që duket i vështirë të zhvendoset në mjedise më me rrezik. Ndoshta ky rrezik do të ishte më i madh nëse do të kishte, për shembull, më shumë investitorë institucionalë vendorë që mund të ndikojnë apo të bëjnë presion në mjedisin vendor për të siguruar që ato investime janë bërë ose janë ndjekur në mënyrën e duhur. Pra, ka masa që mund të merren në vendin pritës, dhe sigurisht ka masa që mund të merren në vendet e origjinës, ku ky kapital institucional është i bollshëm.

Ne pamë në krizën financiare globale se shumë nga ajo çfarë ndodhi në lidhje me reduktimin dhe shpërndarjen, veçanërisht në Eurozonë, u drejtua nga presioni mbi bankat mëmë nga autoritetet e vendeve të origjinës, bankat qendrore dhe rregullatorë të tjerë, dhe në një shkallë të caktuar, nga autoritetet e Eurozonës. Gjithashtu, mendoj se sot ka rregulla për investitorët institucionalë vendorë që potencialisht të vijnë në mjedise më me rrezik si dhe në ekonomitë në tranzicion dhe në zhvillim. Për këtë arsye, ka rregulla që e bëjnë këtë të vështirë. Ndoshta ne përsëri do të na duhet të analizojmë rregullat dhe të shohim nëse përshtaten me qëllimin. Një punë e dallueshme të cilën ne e pamë në këtë komision global, tregon se ka një mbivlerësim sistematik të rrezikshmërisë në investimet infrastrukturore në vendet në zhvillim. Kështu që, ndoshta ka disa dallime që mund të përpiqemi t'i trajtojmë. Përsëri, po përpiqem të mendoj për diçka që ne mund të gjejmë në nivel global, por në qoftë se ne nuk mund ta gjejmë atë në nivel evropian, atëherë kemi një të ardhme edhe shumë më pak premtuese. Duhet të ketë mënyra, dhe sigurisht ka vende që kanë pasur treg të kapitalit të fragmentuar. Shtetet e Bashkuara kishin tregje të fragmentuara të kapitalit, dhe ende kanë tregje të fragmentuara të kapitalit. Por, disa ia kanë dalë të kenë një kuadër rregullator i cili u lejon atyre të kryejnë transferta ndërmjet shteteve ose ndërmjet palëve të ndryshme të sistemit financiar.

Ne duhet ta krijojmë këtë në nivel evropian. Mendoj, se çelësi për këtë është me të vërtetë në nivel evropian. Në qoftë se autoritetet e

vendeve të origjinës do të jenë të gatshme të kujdesen për disa nga shqetësimet dhe ambiciet e tyre për të kontrolluar këto kompani apo banka, mendoj se do të ishte zhvillim pozitiv.

Gjithashtu, në prezantimet e sotme dëgjuam dhe për modelet e bankingut, të cilat sot, udhëhiqen shumë nga logjika e grupit. Logjika e grupit, mendoj se është mirë, për aq kohë sa përfshin edhe transferim kapitali. Mendoj se na duhen masa në nivel vendi origjine, në nivel BE-je, dhe brenda këtyre institucioneve financiare. Ajo çfarë pamë në këtë krizë ishte ky lloj investimi financiar që bënë bankat evropiane. Ato ishin më tepër investime të huaja direkte sesa flukse normale të kapitalit ose flukse tradicionale të borxhit. Ato ishin shumë më tepër rezistente ndaj presioneve, ndërsa tregjet e obligacioneve u zhdukën menjëherë, kredidhënia sindikale u zhduk menjëherë. Sigurisht ajo i ndihmoi ato të kishin këto ushtrime koordinimi që u ndërmorën gjatë krizës.

Jam shpresëplotë se mund të krijojmë një lloj strukture në nivel BE-je që do t'i lejojë këto flukse, të paktën hapen pak, dhe kjo mund të integrohet me modelin e ri të veprimtarisë së këtyre bankave. Shpresa më e madhe për mua është se atje ka një revolucion të tërë të ri dhe ne pamë elemente të tij në diskutimet e sotme, në atë si bankat dhe sistemi financiar po veprojnë në përgjithësi. Po flisnim pak në drekë sot që ajo çfarë unë kam parë në transformimin e sistemit financiar kinez është me të vërtetë mbresëlënëse. Ajo ka ndryshuar tërësisht mënyrën - të paktën kështu mendoj unë - e zhvillimit financiar. Sot, mund të shihni një kombinim të sistemeve të pagesave jo me para fizike dhe të atyre të vogla online, ju mund të arrini në zona shumë të largëta, dhe në të tjera të cilat mund të mos përfshiheshin kurrë në sistemin financiar.

Kjo mua më jep shumë shpresë, jo vetëm për këtë pjesë të botës. Mendoj se sfida e vërtetë e Evropës Qendrore, por gjithashtu dhe për Evropën Juglindore, është se ky dallim midis zonave rurale dhe zonave urbane përbën me të vërtetë një problem social fondamental. Mendoj se ne mund të marrim disa prej flukseve transformuese të kapitalit me këtë kapacitet transformues, që mund të jetë me të vërtetë një ndryshim real, në shumë vende të Evropës Lindore dhe Evropës Juglindore. Faleminderit!

Moderator Piroska Nagy-Mohacsi: Shkëlqyeshëm! Faleminderit!

PANELI I GUVERNATORËVE: RAUNDI II

Moderator Piroska Nagy-Mohacsi: Ky panel ka zbuluar shumë çështje të reja. Ne së bashku kemi ngritur çështje që lidhen me sfidat e mbiçmimit të kursit të këmbimit, lidhur me të gjithë botën e re të rregullave të lojës për ndërhyrjet në kursin e këmbimit, duke u bërë pjesë e tërësisë së re të instrumenteve. Po flasim për "luftërat e monedhave" dhe ndikimin në tregjet në zhvillim. Për shkak të këtyre politikave, shtrirja e luftës tregtare në një luftë të re monedhe në fushën e bankingut qendror. Ne diskutuam për instrumentet e reja të politikës së bankës qendrore, për shembull parashikimi i normës së interesit përmes një "fan chart", që është gjetje shumë origjinale. Dëgjuam për fondamentet e reja të teorisë së bankës qendrore, për transparencën, kapitalin e bankës qendrore, dhe çfarë do të ndodhë, dhe një propozim që ndoshta banka qendrore duhet të privatizohet.

Ka një fushë, që mendoj se nuk e kemi prekur, dhe ajo është monedha digjitale e bankës qendrore. Ne tashmë kemi diskutuar, në veçanti, përfaqësuesit e bankave tregtare përmendën monedhën kibernetike. I dimë argumentet pro dhe kundër, dimë gjithashtu se çfarë mendojnë rregullatorët për të. Ka pasur shumë mendime dhe disa veprime në banka qendrore për atë që këto të fundit të zhvendosen në këtë hapësirë dhe çështje që kanë të bëjnë me monedhën e bankës qendrore, përveç parasë fizike. Dëshiroj të pyes penalistët dhe kolegen nga Banka Qendrore e Suedisë, të na thonë se çfarë mendojnë për këtë çështje, mendimin e bankës qendrore dhe cilat janë argumentet pro dhe kundër në prezantimin e monedhave digjitale të bankave qendrore, jo vetëm në shitjet me shumicë, por dhe në ato me pakicë. Cilat janë disavantazhet? Cili është qëndrimi i politikëbërësve aktualë, ose cili është sugjerimi juaj për politikëbërësit? Guvernatori Sejko, me lejen tuaj, dëshiroj të pyes Marianne Nessén, e cila vjen nga Banka Qendrore e Suedisë, një bankë qendrore që është pionere e kësaj industrie. Marianne, ju lutem disa fjali se ku është i pozicionuar mendimi lidhur me këtë çështje.

Marianne Nessén, Këshilltare e Lartë e Bordit Ekzekutiv, Sveriges Riksbank: Aktualisht Riksbank po hulumton për e-krona. Ne jemi

në fillim të këtij udhëtimi. Ende nuk ka një vendim për të shpallur e-krona, por janë bërë përgatitjet e duhura. Lidhur me këtë, ne po analizojmë argumentet pro dhe ato kundër. Më lejoni shkurtimisht të them pse Riksbank nisi ta bëjë këtë. Kjo nuk është një përgjigje ndaj "bit coin" ndaj një tjetre të ngjashme me të. Është fakti që suedezët kanë ndaluar së përdoruri paranë fizike. Kështu që u ngrit pyetja: "A duhet të ketë akses në Suedi tek paratë e bankës qendrore?" Po ose jo. Dhe një përgjigje për këtë pyetje ishte nisja e projektit e-krona.

Moderator Piroska Nagy-Mohacsi: Shumë faleminderit! Guvernatori Hanson, do të kërkoja komentin tuaj për këtë çështje, pasi zona e Baltikut, ndoshta dhe banka juaj, gjithashtu kanë ecur para në fushën e digjitalizimit. Sigurisht, ju jeni në Eurozonë, por cili është mendimi lidhur me monedhën elektronike në përgjithësi, brenda këtij konteksti.

Ish-Guvernatori Hansson: Ne jemi në Eurozonë, prandaj nëse e bëjmë këtë do ta bëjmë në grup më të madh dhe në mënyrë kolektive. Disa gjëra që dikush mund t'i bëjë, në kuptimin e monedhës digjitale të bankës qendrore, tashmë ekzistojnë në bankingun tregtar. Edhe nëse nuk shkoni gjithmonë tek individi, mund të shkoni përtej bankave qendrore dhe t'i jepni akses në llogaritë e bankës qendrore disa llojeve të tjera të ndërmarrjeve financiare. Është mjaft e lehtë ta zhvendosësh perimetrin; ndoshta aksesi në kompanitë e pagesave mund të jetë i ndryshëm. Mendoj se ka dy arsye: njëra e përmendur nga Marianne, rënia dramatike në përdorimin e parasë fizike në pagesa (mendoj se ky është një fenomen kryesisht nordik). Çështja tjetër është nëse qytetarët kanë të drejtë ndaj një aktivi me rrezik të lirë me të cilin ishin mësuar dhe një regjim të shpëtimit. Tani që keni rikapitalizimin nga brenda, ai krijon pasiguri, dhe nuk keni më shumë para fizike. Mendoj se një arsye se përse duhet të siguroni njerëzit është se, në të njëjtën kohë kishit sigurim të depozitave që shkonte deri në 200 000 euro për frymë. Kështu që, për pjesën më të madhe të njerëzve, që mbanin para në banka tregtare, nëse mendoni se sigurimi i depozitave funksionon, ju jep akses në 100 000 euro para elektronike që është mjaft pranë ndjesisë për të qenë të sigurt. Mendoj se kështu problemi zgjidhet.

Tjetra është kufiri më i ulët zero, ku argumenti që shtrohet është nëse me të vërtetë duhet të zhdukni pjesën e mbetur të parasë fizike,

bankat qendrore mund të shkojnë me të vërtetë në vlera negative të normave të interesit. Kjo është pak e frikshme nëse mund t'i bëni këto me lehtësi. Por, personalisht nuk mendoj se bankat qendrore duhet t'ia bëjnë jetën më të lehtë politikëbërësve. Është mirë të ketë një dysheme të poshtme të cilën nuk mund ta kalojë askush. Kështu pra, jam shumë skeptik. Për shembull Banka Qendrore e Danimarkës rikonsideroi dhe tha: "Kjo nuk ka kuptim fare. Ne heqim dorë nga ideja e monedhës elektronike të bankës qendrore". Këto janë çështje të luftës kundër pastrimit të parave, çështje që lidhen me tërheqje të parave nga banka për tek banka qendrore. Kjo është se si mund të keni një tërheqje të parave nga bankat, që nuk është e mundur me paranë fizike.

Një përgjigje e duhur, mendoj se mund të jetë vlerësimi më i lartë i natyrës publike të parasë fizike në qarkullim. Ne deri diku e konsiderojmë atë si të dalë mode, por në të njëjtën fushë, kur kemi rrezik kibernetik, të pasurit e një teknologjie plotësisht analoge, në një shkallë deri diku të rëndësishme, është një gjë shumë e mirë. Mund të jeni në situatën ku norma private e kthimit për të kaluar në digjitale është më e lartë se norma sociale e kthimit, dhe ndoshta një gjë, që ne si bankierë qendrorë mund të bëjmë, nëse mendojmë se ka vlerë sociale të qarkullimit të parasë fizike, është të përpiqemi ta mbrojmë atë dhe ta ngadalësojmë këtë lëvizje drejt parasë elektronike. Ju nuk do të punoni kundër teknologjisë, por ndoshta ajo po ecën shumë shpejt në disa vende. Pra, do të isha skeptik për gjithë këtë.

Moderator Piroska Nagy-Mohacsi: Shumë faleminderit! Më lejoni të kërkoj mendimin e pjesës tjetër të panelit. Mario, ju lutem!

Ish-guvernatori Mario Blejer: Në këtë shekull, ideja se mund të ketë para letër jo para metalike, është tërësisht qesharake. Ajo çfarë dua të theksoj është se, në qoftë se kjo teknologji zhvillohet, ajo përfundimisht do të çojë në privatizimin e funksionit të emetimit të monedhës nga bankat qendrore. Kështu, një arsye më shumë për të privatizuar bankat qendrore.

Moderator Piroska Nagy-Mohacsi: Shumë konsistent! Ju lutem, Zëvendësguvernator Sologub:

Zëvendësguvernator Dmytro Sologub: Dua të them se ne kemi pasur një përvojë me monedhën digjitale të bankës qendrore. Çështja u shfaq rreth katër vite më parë. Së pari, ne kemi folur shumë me kolegët tanë të Bankës Qendrore të Suedisë, Guvernatorin Ingves; së dyti, gjithë ky publicitet në rritje për bitcoin. Ne në bankë vendosëm të zhvillonim një projekt pilot, të emetonim monedhën digjitale të bankës qendrore. E quajtëm atë "e-hryvnia", e ngjashme me "e-krona", bazuar në DTL *(Distrubuted Ledger Technology)* dhe pamë si mund të funksiononte. Ky ishte thjesht një eksperiment, në disa portofola elektronikë dhe disa shërbime që mund të përdoreshin. Aktualisht raportohen si të disponueshëm në faqen tonë të internetit. Mund ta shihni aty. Është një raport shumë i detajuar. Gjithashtu, ka një rishikim të praktikave të tjera. Përfundimi, mendoj se është shumë i ngjashëm me atë çfarë tha Ardo për bankën qendrore. Nuk funksionoi gjatë. Nuk ka asgjë e cila me të vërtetë të mund të jetë apo të mund të ofrojë një vlerë të shtuar, për momentin. Mendoj se është e rëndësishme të themi "për momentin", pasi ju duhet t'i përdorni të gjitha këto burime në krijimin e monedhës digjitale të bankës qendrore. Nga ana tjetër, po ndjekim me shumë kujdes atë çfarë po bën banka qendrore e Suedisë, për të parë rezultatin e projektit të monedhës digjitale "e-krona". Le te shohim, ndoshta do të na çojë diku.

Moderator Piroska Nagy-Mohacsi: Shumë faleminderit! Zoti Guvernator, cili është mendimi në Shqipëri për sa i përket monedhës digjitale të bankës qendrore?

Guvernatori Sejko: Ne e kemi diskutuar çështjen e kriptomonedhës në shumë konferenca, veçanërisht në takimet e Klubit të Guvernatorëve. Kemi dëgjuar nga vende të mëdha që përfaqësojnë ekonomi të mëdha të zhvilluara dhe në zhvillim si India, SHBA-të, Rusia dhe shumë shembuj të tjerë, të cilët gjithashtu kanë bërë hapa të mëdhenj në futjen e teknologjive të reja në banking dhe financë. Asnjë bankë qendrore që kam dëgjuar nuk ka pasur besim në progresin e kriptomonedhës. Të gjitha qeveritë apo bankierët qendrorë kanë qenë pak ngurues, dhe duket se kanë qasjen "prit dhe shiko", se sa të avancojnë me adoptimin apo rregullimin e të tilla monedhave. Sigurisht, është shumë e kuptueshme se roli kryesor i bankës qendrore është politika monetare dhe stabiliteti financiar.

Sa të sigurta do të jenë bankat qendrore në aftësinë që të kryejmë misionin tonë në prani të kriptomonedhës? Si do t'i administrojnë bankat qendrore objektivat e politikës monetare dhe të parandalojnë dhe mbrojnë stabilitetin financiar në rast të një përvetësimi të gjerë të kriptomonedhës? Jemi të vetëdijshëm për të gjitha rreziqet e luhatjeve të kriptomonedhës, natyrën e saj për të qenë pre e sulmeve spekulative dhe kibernetike, çështjeve të pastrimit të parave, dhe gjithçka tjetër që mund të përfshihet. Kështu që, në të gjitha aspektet, të gjitha bankat qendrore duhet t'i studiojnë më thellë kriptomonedhat. Të paktën ne, nga këndvështrimi rregullator, duhet të jemi më të qartë lidhur me kriptomonedhën. Pasi ne jemi institucione rregullatore dhe duhet të rregullojmë tregun, dhe me qëllim që të rregullojmë tregun, duhet ta kontrollojmë atë. Kështu që, për Shqipërinë ne kemi vërejtur disa qëllime apo interesa tentativë në formën e kërkesave për operim të ATM-ve për kriptomonedha dhe asgjë më shumë. Mund të ketë ATM të kriptomonedhave në vende të tjera të Ballkanit Perëndimor, por nuk ka ATM të tilla në Shqipëri. Rregullorja jonë bankare në mënyrë të qartë specifikon që për të pasur një ATM ju duhet të keni një licencë për bankë. Megjithatë, vetëm për të menduar apo folur për kriptomonedhën nga një këndvështrim teorik, është e vështirë sepse ende ka shumë të panjohura. Si do të ndjeheshim ne si bankierë qendrorë dhe do të reagonim nëse do të na paraqitej një kërkesë për të aplikuar produktet dhe shërbimet e kriptomonedhës në treg? Mendoj se ka shumë sfida të tjera që po hasim sot, dhe kjo është mjaft e re për Shqipërinë. Pra, përgjigjja ime do të ishte "Le të presim e të shohim".

Moderator Piroska Nagy-Mohacsi: Zonja Zëvendësguvernatore Raspudić, ju lutem, cili është mendimi juaj për monedhën digjitale?

Zëvendësguvernatorja Raspudić: Mendoj se bota digjitale po ndodh shumë shpejt. Fatmirësisht, ne jemi larg idesë së monedhës digjitale të bankës qendrore. Por, teoria na tregon se monedha digjitale aktualisht po studiohet dhe testohet nga disa qeveri dhe banka qendrore me qëllim që të analizohet çdo implikim pozitiv. Ajo kontribuon, për shembull, në përfshirjen financiare, inovacionin teknologjik të rritjes ekonomike dhe rrit efektivitetin e transaksioneve. Por, gjithashtu ka një shqetësim të përgjithshëm rreth rreziqeve të paparashikuar, të tilla si ndikimi i sigurinë kibernetike në stabilitetin financiar, ndoshta

ndikimi në pozicionin e dobët financues të bankës, etj. Kështu që, shpresoj se do të ndodhë në të ardhmen, por jo shumë afër.

Moderator Piroska Nagy-Mohacsi: Faleminderit! Ky mesazh është shumë i qartë. Ka disa përparime teknologjike, por është ende herët si proces. Dëgjuam për implikimet negative; le të zhvendosemi në dy fusha. Njëra prej tyre lidhet me Guvernatorin Mark Carney, Banka Qendrore e Anglisë, i cili në fjalën e mbajtur në Hole Symposium 2019, përmendi: "Bankat qendrore të bashkohen për monedhën digjitale me qëllim kryerjen e pagesave me jashtë", gjë që mund të analizohet; dhe e dyta është pika e ngritur nga Ardo se, në një kuptim nëse individët kanë akses në monedhën digjitale të bankës qendrore, atëherë do t'ju duhet sigurim i depozitave. Dhe kjo do të thotë kosto e lartë e kursimeve dhe largim i rrezikut moral nga sistemi. Shumë faleminderit dhe do të doja t'ua lija vendin pyetjeve, përfshirë dhe atyre që mund të keni pasur nga raundi i dytë i diskutimeve të panelit. Ju lutem jini të lirë t'i ngrini ato.

RAUNDI III: PYETJE DHE PËRGJIGJE/PËRFUNDIME

Pyetje:

Milan DESKAR-ŠKRBIĆ, Këshilltar, Departamenti i Modelimit, Banka Kombëtare Kroate. Shumë faleminderit! Kjo Konferencë ka qenë shumë interesante. Unë kam tri pyetje të shkurtra.

1. Pyetja e parë është për Guvernatorin Sejko. Ju përmendet strategjinë për deeuroizimin ose nëse mund të themi strategjia për lekëzimin. E kuptova se çfarë po bën banka qendrore për pjesën që ajo mbulon në këtë strategji kombëtare, por, çfarë po bën Ministria e Financave dhe Ekonomisë për pjesën e saj? A e kanë ndryshuar ata strategjinë e tyre të administrimit të borxhit publik? A po marrin më shumë hua në monedhën vendase apo nuk kanë ndryshuar asgjë në këtë strategji?
2. Pyetja tjetër është për z. Sologub. Është shumë interesante që keni një parashikim të normës bazë të interesit, si grafiku "fan chart", i cili është transparent, dhe sigurisht unë do ta shoh atë. Pyetja është: a jeni gjithashtu transparentë për sa i përket modelit? A ju bëni të ditur investitorëve se çfarë modeli

përdorni? A ka një rregull të veçantë apo diçka tjetër për këtë?
3. Pyetja e fundit është për të gjithë. A jeni dakord me Paul Volcker, i cili thotë se: "Gjëja e mirë e fundit në inovacion dhe financë ka qenë shpikja e ATM-së"?

Përgjigje

Guvernatori Sejko: Faleminderit shumë për pyetjen! Ne kemi nënshkruar një Memorandum Mirëkuptimi me Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë, por ka disa vështirësi për Ministrinë që të avancojë me projektin e deeurozimit. Së pari, ne kemi diçka të veçantë, të cilën e përmenda. Ka shumë transaksione dhe kontrata që kryhen në monedhën euro. Dhe nuk e kam fjalën vetëm për mallrat e luksit, si: makina, pasuri të paluajtshme, etj., por edhe për shumë shërbime e mallra të tjera që kuotohen në monedhën euro. Nuk është e nevojshme të kuotohen çmimet në euro, në prani të një regjimi të lirë të luhatshëm të kursit të këmbimit. Megjithatë, dyqanet në mënyrë të panevojshme i denominojnë dhe bëjnë njoftimet e tyre në monedhën euro. Kësaj praktike duhet t'i jepet fund. Shitësit, blerësit dhe kontraktorët duhet ta ndalojnë këtë zakon dhe të japin çmime, kontrata dhe të kryejnë transaksione në lekë. Në një këndvështrim bazë, kjo është ajo nga ku duhet ta nisim strategjinë e deeurozimit, pasi është me të vërtetë jo e nevojshme që njerëzit të paguajnë në euro për të blerë mallra dhe shërbime kur duhet paguajnë në lekë.

Për më shumë, Ministria e Financave dhe Ekonomisë dhe Qeveria duhet të marrin masa të tjera lidhur me administrimin e borxhit. Aktualisht, një pjesë e konsiderueshme e borxhit është në euro, dhe shërbimi i borxhit mund të ketë implikime pozitive ose negative në kursin e këmbimit. Qeveria ka nevojë për euro, për qëllime të shërbimit të borxhit, çka do të thotë se qeveria do të ketë një kërkesë të njohur për euro për të përmbushur detyrimet e saj. Nëse qeveria do ta administronte më mirë, ajo do të mbledhë dhe blejë euro drejtpërsëdrejti nga tregu kur leku është i fortë dhe jo në momentin kur pagesa është e detyrueshme. Kjo politikë administrimi mund të ndikojë pozitivisht dhe të zbusë goditjet e tregut valutor dhe luhatjet e kursit të këmbimit të lekut. Kjo çështje është trajtuar shpesh nga Banka e Shqipërisë dhe është diskutuar gjatë takimeve të Grupit Këshillimor të Stabilitetit Financiar, i cili është një forum kombëtar

për diskutimin e Stabilitetit Financiar me pjesëmarrjen e Ministrisë së Ekonomisë dhe Financave, Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare dhe Agjencisë së Sigurimit të Depozitave.

Në përfundim, Banka e Shqipërisë ka ndërmarrë disa veprime, por ato nuk janë të mjaftueshme. Ne duhet të bëjmë më shumë në bashkëpunim me Qeverinë për deeuroizimin, sepse, është e qartë, që krijon pengesa për transmetimin e politikës monetare dhe për stabilitetin financiar nëpërmjet rrezikut të kursit të këmbimit.

Megjithatë, duhet theksuar se politika e deeuroizimit nuk përpiqet ta eliminojë monedhën euro nga tregu. Ende do të ketë shumë transaksione që do të kryhen në euro dhe kontrata të lidhura në euro në treg, por transaksionet e panevojshme nuk ka pse të kryhen në euro. Sigurisht do të donim të kishim një raport 80 me 20 të lekut ndaj euros sesa atë aktual, 50 me 50, në bilancin e sektorit bankar. Kjo duhet pasi politika jonë monetare do të transmetohej me të vërtetë shumë më mirë dhe do të kishte më pak rrezik të kursit të këmbimit për stabilitetin financiar dhe atë të çmimeve. Kjo është shumë e vështirë për t'u arritur me rregullore financiare dhe makroprudenciale kur me të vërtetë kemi euroizim financiar. Pavarësisht përpjekjeve të bankës qendrore, objektivi i deeuroizimit mund të arrihet efektivisht vetëm në bashkëpunim me Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë dhe me Qeverinë. Këtë po përpiqemi të bëjmë, duke planifikuar dhe bashkëpunuar së bashku. Faleminderit!

Zëvendësguvernatori Dmytro Sologub: Faleminderit Milan për pyetjen! Është shumë aktuale. Disa javë më parë po diskutoja me kolegë të mi në BE për hapat e tjerë për të rritur transparencën, pasi jam fans i madh i transparencës, dhe mendoj se duhet të kryhet me faza dhe sipas një sekuence të duhur. Vitin e kaluar ne nisëm të publikonim procesverbalin e diskutimit të komitetit të politikës monetare, ndërsa këtë vit është projeksioni i normës së interesit dhe për hapin tjetër po mendojmë të publikojmë një lloj përmbledhjeje të modelit tonë makroekonomik. Ndoshta mund të jetë më pak interesant për tregun sesa procesverbali apo projeksioni i normës së interesit. Por, është një pikë e rëndësishme e transparencës, kështu që tregu mund të ketë të gjithë informacionin e disponueshëm që përdor banka qendrore për vendimet e politikës monetare.

Ish-guvernatori Mario Blejer: Lidhur me atë çfarë Volcker ka thënë, unë mendoj se një inovacion i madh ishte ATM-ja tek McDonald, ku ne mund të marrim para dhe një hamburger. Mendoj se është një inovacion i vërtetë. Lidhur me natyrën e inovacionit ju keni bërë një hap të madh në një periudhë pa inovacione. Mendoj se inovacionet e mëdha po vijnë sot me monedhat digjitale.

Moderator Piroska Nagy-Mohacsi: Faleminderit! Pyetje të tjera, apo i kemi trajtuar të gjitha çështjet.

PËRFUNDIME

Gent SEJKO, Guvernator, Banka e Shqipërisë
Erik Berglof, Drejtor, LSE Instituti për Çështje Globale

Guvernatori Sejko: Konferenca zgjati pak më shumë nga sa ishte planifikuar, por të gjitha çështjet u diskutuan gjatë dhe realisht qe një Konferencë mjaft frytdhënëse. Do të doja të përmendja shkurtimisht disa nga pikat që mund t'i trajtojmë në vendet tona. Nga Paneli i Guvernatorëve në këtë Konferencë, ne morëm mesazhin se ka disa ndryshime fondamentale lidhur me sektorin bankar, politikat monetare dhe tregjet, jo vetëm në Eurozonë, por dhe në pjesën tjetër të botës, e cila ndikon rajonin tonë. Nga të gjitha prezantimet e mbajtura nga kolegët tanë të sektorit bankar dhe financiar, dëgjuam se secili është i vetëdijshëm për ndryshimet, dhe në këtë kontekst, ata po përvetësojnë modelin, filozofinë dhe strategjinë e veprimtarisë së tyre me këto ndryshime. E njëjta gjë edhe për bankat qendrore dhe rregullatorët, të cilët po përshtaten me ndryshimet sipas zhvillimeve të tregut dhe duke u përpjekur për të rregulluar më mirë dhe parandaluar rreziqet.

Lidhur me FinTech, kjo është një çështje, mjaft aktuale. Ndërkohë, kriptomonedhat, siç dhe e përmendëm, mbeten një skenar "Prit dhe shiko" për ne. Të gjitha bankat qendrore duket se janë në të njëjtën fazë. Situata me norma interesi negative është shumë stresuese për sektorin bankar, dhe stresi është ende i pranishëm. Megjithatë, bankat kanë adaptuar modelet e tyre. Në Shqipëri, nuk e kemi ndierë shumë, por në disa vende, veçanërisht në perëndim, kjo barrë është madje edhe më e rëndë. Këto janë disa nga pikat që ne mund të nxjerrim,

në përgjithësi, nga kjo Konferencë. Ndoshta, Erik mund të shtojë të tjera, në panoramën e përgjithshme të kësaj Konference.

Unë kam përshtypjen, se për të dytën herë së bashku ne patëm diskutime shumë të mira dhe shumë frytdhënëse. Gjithçka u prezantua dhe u diskutua në mënyrë perfekte. Patëm pyetje shumë interesante, dhe dua të falënderoj gjithashtu ata që i bënë këto pyetje. Përfitoj nga rasti të falënderoj përsëri kolegët e LSE-së, Piroska dhe Erik, për bashkëpunimin, koordinimin dhe të gjithë mbështetjen e dhënë. Shumë faleminderit! Shpresoj që ta vazhdojmë bashkëpunimin tonë! Gjithashtu, dua të falënderoj pjesëmarrësit dhe të gjithë folësit për prezantimet, opinionet dhe informacionet e tyre.

E fundit, por jo më pak e rëndësishme, dua të falënderoj stafin organizues të Bankës së Shqipërisë, pasi kjo konferencë që zgjati një ditë e gjysmë, kërkon një organizim prej një viti të tërë. Faleminderit stafit organizues të Bankës së Shqipërisë për të gjitha përpjekjet e bëra për organizimin e kësaj konference!

Erik Berglof: Ka qenë një bashkëpunim mjaft frytdhënës dhe i suksesshëm. Pasi ramë dakord, gjë që e bëmë shumë shpejt, dëshironim të bënim diçka që me të vërtetë të prekte çështje të rëndësishme për Shqipërinë. Mendoj se gjithçka zuri vend butësisht dhe me rezultate të mira. Jam shumë mirënjohës për këtë. Nga ana jonë, Piroska, në veçanti luajti një rol instrumental, prandaj e falenderoj shumë!

Hulumtova atë çfarë ka ndodhur gjatë vitit të kaluar, ndoshta për një periudhë më të gjatë, por ka shumë shenja pozitive lidhur me konsolidimin e sistemit bankar në Shqipëri. Folëm për kreditë me probleme, folëm për banka më të mëdha me kapital vendas dhe gjithashtu për hyrje të reja në sistemin bankar.

Ka gjithashtu disa zhvillime pozitive. E gjithë kjo ka ndodhur brenda kontekstit të anëtarësimit në BE, dhe vetëm së fundi kemi marrë lajme disi shqetësuese për këtë. Mendoj se mbështetja e këtij roli për të gjithë ne për të siguruar hyrjen në BE vazhdon të ecë para, sigurisht Shqipëria ka përgjegjësi për situatën politike, por ata jashtë kanë përgjegjësi për ta bërë të mundur këtë proces për Shqipërinë.

Sigurisht, jo vetëm në Shqipëri, politika është gjithmonë dhe gjithkund e ndërlikuar. Mund t'ju them se nga ana e MB-së, ne jemi plotësisht një territor pa grafik në terma të politikës dhe sigurisht ju mund të shihni dhe vende të tjera. Ne vetëm na duhet të kemi durim dhe qëndrueshmëri. Për ta mbyllur me të njëjtën shënim me të cilin mbylla dhe komentet e mia më herët, mendoj se ka një mundësi që sistemi financiar, sistemi bankar mund të forcohen nga aktorë të tjerë që me të vërtetë mund të luajnë rol duke sjellë një ekonomi dhe një sistem financiar më përfshirës. Dhe kjo gjithashtu do të mundësojë trajtimin e disa shqetësimeve që po sjellin këto qëndrime politike që ne po shohim në shumë vende, jo vetëm në këtë pjesë të botës.

Ky është qëndrimi im optimist për mendimin rreth rolit të sektorit bankar dhe të sistemit financiar.
Faleminderit!

Guvernatori Sejko: Shumë faleminderit gjithsecilit për pjesëmarrjen tuaj në këtë Konferencë!

KOLAZH ME FOTO NGA PUNIMET E KONFERENCËS

nd Opening Speeches
LSE
Gent SEJKO
Governor
Bank of Albania

A BRAVE NEW
WORLD
LSE
Gent SEJKO
11 October 2019
Tirana, Albania

Annual Conference Undertaken
by the Bank of Albania
and the London School of Economics
and Political Science (LSE)
LSE

LSE

A BRAVE NEW
WORLD
LSE

Welcome and Opening Speeches
LSE
H.E.Mr. Ilir META

A BRAVE NEW
WORLD
LSE

LSE

A BRAVE NEW
WORLD
RETHINKING
SIZE, STRUCTURE,
OWNERSHIP, POLICIES
AND INCENTIVES
LSE

Session I
EU and SEE banking systems: cooperation and
common challenges
Davide STROPPA
LSE

A BRAVE NEW
WORLD
THE FUTURE
OF BANKING
LSE

Euro candidate countries - three monetary stories
Bulgarian lev
Croatian kuna
Romanian leu
LSE

Exogeneous macrotrends affect the banking
Need to re-think
traditional model and
distribution strategies
Competitiveness
Digitalisation
Key
LSE

LSE

Session II
The role of non-bank finance, high-tech and fin-tech in conventional commercial banking
Peter BOTOUCHAROV
LSE

A BRAVE NEW WORLD
RETHINKING SIZE, STRUCTURE, OWNERSHIP, POLICIES AND INCENTIVES
THE FUTURE OF BANKING
in Emerging Europe
11 October 2019

LSE

A BRAVE
11 October 2019

LSE

Banks must adopt to low interest rates
Reduction of branches, staff and ATMs
Increasing digitization
Emergence of technology banks
From cash to electronic payments
Emergence of cryptocurrencies
Inside
LSE

AND INCENTIVES
THE FUTURE OF BANKING
in Emerging Europe

LSE
Dmytro SOLOGUB
National Bank of Ukraine

A BRAVE NEW
WORLD
LSE

11 October 20
Tirana,

in Emerg

OF BANKING
in Emerging Europe

WORLD